

NJË VËSHTRIM SOCIAL PSIKOLOGJIK MBI GRATË E FAMILJEVE TË NGUJUARA

ELONA PRROJ

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat Sociale me profil Psikologji, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr Zenel Orhani

Numri i fjalëve: 55.007

Tiranë, Qershor 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Përmes kësaj deklarate pohoj se ky punim është puna ime origjinale. Çdo e dhënë, citim teksti, tabelë ose figurë që është marrë nga ndonjë burim tjetër, është shoqëruar me referencën përkatëse që vërteton burimin e saj. Punimi nuk është prezantuar asnjëherë përpara një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar në asnjë vend tjetër si një i tëri.

ABSTRAKTI

Ky studim prezanton rezultatet e kërkimit me temë “*Një vështrim social psikologjik i grave të familjeve të ngujuara*”. Në qendër të këtij studimi vihet një kategori e veçantë grash, siç janë gratë e familjeve të ngujuara, të përzgjedhura nga zona të ndryshme të veriut Shqipërisë, që vuajnë pasojat e dukurisë së gjakmarrjes edhe sot në kohët moderne. Në studim analizohen cilësia e jetesës së këtyre grave, marrëdhëniet brenda familjes së tyre, analizohet gjendja e tyre shpirtërore, stresi që këto gra përjetojnë nga prania e vazhdueshme e gjakmarrjes, si dhe përpjekjet e tyre për të dalë nga kjo situatë e rëndë dhe e vështirë.

Metodologjia që përdoret për hulumtim në këtë studim është metodologji sasiore dhe cilësore. Si instrumenta bazë janë përdorur pyetësorët dhe intervistat e zhvilluara me 50 gra, të cilat u janë përgjigjur drejtpërsëdrejti pyetjeve të drejtuara nga ana jonë. Përmes këtyre instrumentave janë mbledhur të dhëna mbi gjendjen sociale dhe psikologjike përmes pohimeve, diskutimit të opinioneve të ndryshme dhe qëndrimeve që ato shfaqin. Nga analiza e të dhënave, kemi evidentuar një sërë faktorësh siç janë varfëria, ndikimi i kanunit, padituria dhe mungesa e arsimimit, zhvillimet kaotike të vazhdueshme të shoqërisë shqiptare, sidomos në periudhën e tranzicionit, e të tjera. Të gjitha gjetjet provojnë jetën e vështirë të këtij target grupi të krijuar nga ndikimi i fenomenit të gjakmarrjes, por ato rekomandojnë e sugjerojnë dhe rrugë e mundësi për të dalë prej këtij realiteti.

Fjalët kyçe: ngujim, gra të ngujuara, gjakmarrje, kanun, traumë psikologjike, stres, çrregullimi i stresit post-traumatik (ÇSPT) e të tjera.

ABSTRACT

This study presents the results of the research topic "A Psychological Social Overview at Women of Families in Blood Feud". In the center of this study a special category of women is introduced, such as women of families who are prisoned in the house because of the blood feud, selected from different areas of northern Albania, who suffer the consequences of the blood feud phenomenon even today in modern times. The study analyzes the quality of life of these women, the relationships within their family, analyzes their spiritual conditions, the stress these women experience from the constant presence of blood feuds, and their efforts to get out of this difficult situation.

The methodology used for the research in this study is quantitative and qualitative methodology. As a basic tool, questionnaires and interviews were conducted with 50 women who answered directly to our questions. Through these instruments, data on social and psychological status are collected through allegations, discussion of different opinions and attitudes they present. From data analysis, we have identified a number of factors such as poverty, canon influence, ignorance and lack of education, the ongoing chaotic developments of the Albanian society, especially in the transition period and so on. All the findings prove the hard life of this target group created by the influence of the blood feud phenomenon, but they also recommend and suggest ways of getting out of this reality.

Key words: imprisonment, confined women, blood feuds, canon, psychological trauma, stress, post- traumatic stress disorder (PTSD) and others.

FALENDERIME

Për të bërë të mundur këtë kërkim ishte esenciale dëshira dhe gadishmëria e grave të familjeve të ngujuara për të marrë pjesë në studim dhe për të dhënë me sinqeritet informacionet e kërkuara nga intervistuesi përmes intervistave.

Kështu falenderimi i parë shkon për këto gra që ishin të gatshme jo vetëm për të marrë pjesë në studim, por edhe për të treguar historitë e jetës së tyre, pavarësisht se një pjesë e tyre ishin të mbushura plot emocione, ndjenja dhe kujtime të hidhura. Për disa prej tyre këto histori deri në ato momente kishin mbetur 'të shenjta' për t'u ndarë me të tjerët.

Një falenderim shkon edhe për të gjitha gratë që morrën pjesë në dy fokus grupet në Bathore dhe në Shkodër. E konsideroj të çmuar kohën që ato dhanë për të kontribuar me përgjegjshmëri në bisedat në grup dhe dhëniet e përgjigjeve.

Falenderoj profesor Zenel Orhanin për ndihmesën dhe udhëheqjen e tij dhe 'Universitetin European të Tiranës' për mundësinë e dhënë për të realizuar këtë kërkim të cilin e konsideroj shumë të rëndësishëm.

Falenderoj çdo person që ka kontribuar në mbledhjen dhe grupimin e pyetsorëve dhe çdo ndihmë tjetër të dhënë.

Falenderoj fondacionin 'Jo Gjakmarrjes - Po Jetës' për gadishmërinë për të ofruar gjithçka që kishin në mënyrë që ky studim të bëhej më i lehtë.

Mbi të gjitha falenderoj dy fëmijët e mi Gabrielin dhe Sarën, të cilët kanë sakrifikuar shumë në kohën e gjatë që unë iu perkushtova studimeve të doktoraturës.

Tabela e përmbajtjes

Kapitulli I : Hyrje

1.1. Shtrimi i problemit	1
1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit	3
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat	5
1.4. Rëndësia e studimit	6
1.5. Përkufizimi i koncepteve kryesore	8
1.6. Organizimi i studimit	11

Kapitulli II: Shfletimi i literaturës

2.1. Koncepti mbi gjakmarrjen dhe përmbajtja e saj	15
2.1.1. <i>Vrasja për gjakmarrje</i>	16
2.1.2. <i>Ndryshimi mes gjakmarrjes dhe hakmarrjes</i>	17
2.2. Gjakmarrja në vëmendje të shkencave sociale.....	19
2.2.1. <i>Gjakmarrja dhe rregulli social</i>	20
2.3. Shoqëria shqiptare dhe gjakmarrja.....	23
2.3.1. <i>Gjakmarrja ndër vite</i>	26
2.3.2. <i>Rigjallërimi i fenomenit të gjakmarrjes pas rënies së komunizmit</i>	28
2.3.3. <i>Gruaja në realitetin e gjakmarrjes</i>	35
2.4. Çfarë është çrregullimi i stresit post traumatik.....	38
2.5. Tiparet dalluese të çrregullimit të stresit post traumatik.....	40
2.6. Kush vuan nga çrregullimi i stresit.....	42
2.7. ÇSPT dhe ndryshimet gjinore	43
2.8. ÇSPT dhe Faktorët e riskut.....	46
2.9. ÇSPT dhe shëndeti fizik.....	47

Kapitulli III: Metodologjia

3.1. Qëllimi i studimit dhe objektivat	50
--	----

3.2. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat	52
3.3. Metodologjia e përdorur në studim	54
3.4. Kampioni	56
3.4.1. Përzgjedhja e kampionit	57
3.4.2. Kriteret për përzgjedhjen e kampionit	57
3.5. Instrumentat e përdorur	58
3.5.1. Pyetsori i të dhënave demografike dhe sociale	59
3.5.2. Pyetësi për historinë e traumës	60
3.5.3. Paketa e analizës së të dhënave	60
3.5.4. Intervista matëse e simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik, PSS-I	61
3.6. Çështjet etike	64
3.7. Kufizimet dhe vështirësitë e studimit	66
3.8. Kufizime specifike të këtij kërkimi	68

Kapitulli IV: Analiza empirike e të dhënave parësore

4.1. Mjedi rrethues i të intervistuarave	70
4.2. Disa tregues demografikë të grave të familjeve të ngujuara	72
4.3. Paraqitja e nivelit ekonomik të familjeve të prekura nga gjakmarrja.....	77
4.4. Historia familjare e ngujimit	87
4.5. Pasojat e gjakmarrjes tek gratë dhe fëmijët e tyre.....	92
4.6. Çfarë ka ofruar ndryshimi i vendbanimit dhe pritshmëritë për të ardhmen	107
4.7. Përmbledhje e rezultateve të intervistimit.	113
4.8. Pyetësi Nr. 2 për historinë e traumës	115
4.8.1. Analizë e të dhënave të pyetësorit për historinë e traumës.	115
4.8.2. Ngjarje të lidhura me krimin	116
4.8.3. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma	117
4.8.4. Përmbledhje e rezultateve të pyetësorit për historinë e traumës	120
4.9. Rezultatet e pyetësorit PSS-I	121
4.9.1. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shkallët e PSS-I	123

4.10. Përmbledhja e rezultateve të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik..	139
4.11. Analiza e intervistave të hapura dhe e fokus grupeve	142
4.11.1. <i>Intervistat individuale</i>	142
4.12. Përfundimet dhe analiza e intervistave individuale	153
4.13. Analiza e fokus grupeve	155

Kapitulli V: Diskutimi i gjetjeve

5.1. Gjetje në burimet e literaturës dhe diskutimi i tyre	164
5.2. Gjetje lidhur me aspekte sociale të jetesës së grave të ngujuara	167
5.3. Gjetje lidhur me këndvështrimin psikologjik të grave të ngujuara	173

Kapitulli VI: Konkluzione dhe rekomandime

6.1. Konkluzione të përgjithshme	179
6.2. Rekomandime e sugjerime.....	184
6.3. Sugjerime për kërkime të tjera	187
- Referencat	189
- Shtojcë	198

Lista e Figurave

Figura 1. Mesatarja e ÇSPT totale sipas moshës së pjesmarrseve	126
Figura 2. Mesatarja e Ripërjetimit sipas moshës së pjesmarrëseve.....	126
Figura 3. Mesatarja e Shmangies sipas moshës së pjesmarrëseve	127
Figura 4. Mesatarja e Hiperzgjimit sipas moshës së pjesmarrëseve	127
Figura 5. Mesatarja e Ripërjetimit sipas statusit të pjesmarrëseve.....	128
Figura 6. Mesatarja e Shmangies sipas statusit të pjesmarrëseve	128
Figura 7. Mesatarja e Hiperzgjimit sipas statusit të pjesmarrëseve	129
Figura 8. Mesatarja e ÇSPT totale sipas statusit të pjesmarrëseve	129
Figura 9. Vlerat për shkallët e ÇSPT dhe vlera totale, sipas nivelit të arsimimit	130
Figura 10. Mesatarja e PTSD totale sipas statusit të punësimit	136
Figura 11. Mesatarja e Hiperzgjimit sipas statusit të punësimit	136
Figura 12. Mesatarja e Shmangies sipas statusit të punësimit	137
Figura 13. Mesatarja e Përjetimit sipas statusit të punësimit	137

Lista e Tabelave

Tabela 1. Vrasjet për gjakmarrje	33
Tabela 2. Moshë	72
Tabela 3. Arsimi	73
Tabela 4. Numri i familjarëve	74
Tabela 5. Rrethi nga i cili janë larguar	76
Tabela 6. Anëtarët që gjenerojnë të ardhura	79
Tabela 7. Statusi i punësimit	81
Tabela 8. Të ardhurat që shpenzojnë gratë për veten e tyre.....	85
Tabela 9. Statusi aktual i ngujimit.....	89
Tabela 10. Shkakut i ngujimit	90
Tabela 11. Ndryshimi i gjendjes sociale.....	93
Tabela 12. Përkeqësimi i gjendjes sociale.....	95
Tabela 13. Ndjekja e tv dhe radios.....	96
Tabela 14. Takimi me një grua të famshme	98
Tabela 15. Ndryshimi i marrëdhënieve si pasojë e gjakmarrjes.....	99
Tabela 16. Ngarkesa emocionale në marrëdhënien në çift.....	104
Tabela 17. Përkrahja e fqinjëve.....	105
Tabela 18. Lloji i përkrahjes së fqinjëve.....	106
Tabela 19. Arsyet e frikës nga zhvendosja.....	108
Tabela 20. Instrumentat ligjor për gjakmarrjen	110
Tabela 21. Faktorët që ndikojnë në zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes	121

Tabela 22. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma (1).....	117
Tabela 23. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma(2)	118
Tabela 24. Mesatarja Aritmetike dhe Devijimi Standard për Riperjetim	121
Tabela 25. Mesatarja Aritmetike dhe Devijimi Standard për Shmangien	122
Tabela 26. Mesatarja Aritmetike dhe Devijimi Standard për Hiperzgjimin	123
Tabela 27. Mesatarja Aritmetike dhe Devijimi Standard për Shkallët e PSS-I	123
Tabela 28. Koeficientët e Korrelacionit Ndërmjet Shkallëve	125
Tabela 29. MA dhe DS për Shkallët e PSS-I sipas Numrit të Fëmijëve	131
Tabela 30. Vlerat e ANOVA-s për Shkallët e PSSI dhe PTSD Totale Sipas Numrit të Fëmijëve	132
Tabela 31.Vlerat e MA e DS për Shkallët e PSSI dhe PTSD me Vendin e Punësimit....	133
Tabela 32.Vlerat e T-testit për Punësimin në tre Shkallët e në Vlerën Totale të PTSD...	133
Tabela 33.Vlerat e MA dhe DS për Shkallët e PSSI dhe PTSD Totale Sipas Punësimit..	135

Lista e Grafikëve

Grafiku 1. Statusi Civil.....	74
Grafiku 2. Numri i fëmijëve	75
Grafiku 3. Gjinia e fëmijëve	76
Grafiku 4. Vendbanimi i mëparshëm	77
Grafiku 5. Profesioni	81
Grafiku 6. Sektori i Punësimit.....	82
Grafiku 7. Sasia e të ardhurave (1)	83
Grafiku 8. Sasia e të ardhurave (2)	84
Grafiku 9. Ndryshimi i gjendjes ekonomike	87
Grafiku 10. Vitet në ngujim	88
Grafiku 11. Ngujimi në vendbanimin aktual	89
Grafiku 12. Problemet në të cilat ka ndikuar gjakmarrja.....	93
Grafiku 13. Përmirësimi i gjendjes sociale	94
Grafiku 14. Transmetimet që ndjekin	96
Grafiku 15. Gjendja psiko-emocionale.....	98
Grafiku 16. Ndryshimi i marrëdhënieve me djemtë	100
Grafiku 17. Ndryshimi i marrëdhënieve me vajzat	102
Grafiku 18. Ndryshimi i marrëdhënieve në çift.....	103
Grafiku 19. Marrëdhëniet seksuale	104
Grafiku 20. Vendimi për zhvendosjen.....	107
Grafiku 21. Ndjesia e frikës nga zhvendosja	108

Grafiku 22. Identifikimi nga shteti si familje në Gjakmarrje	109
Grafiku 23. Shpresa për të ardhmen	112
Grafiku 24. Ngjarje të lidhura me krimin.....	116
Grafiku 25. Vlerat për shkallët e ÇSPT dhe ÇSPT totale në lidhje me numrin e fëmijëve	132
Grafiku 26.Vlerat për shkallët e ÇSPT dhe ÇSPT totale sipas sektorit të punës..	134

Lista e Shkurtimeve dhe Shpjegimi i Tyre

PPB - Prodhimi i Përgjithshëm Bruto

SHSHS - Shërbimi Shtetëror i Statistikave

SKZHES - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social

ZNIP - Zaptim, Ndërtim, Infrastrukturë, Planizim

IZHH - Instituti për Zhvillim dhe Habitat

INSTAT - Instituti i Statistikave

ÇSPT - Çrregullimi i stresit post traumatik

THQ - Trauma History Questionary

PSS - Pyetësi i Simptomave të Stresit

MA - Mesatarja Aritmetike

DS - Devijimi Standart

KAPITULLI I

H Y R J E

Problemet me të cilat përballen gratë në Shqipëri po vihen gjithnjë e më tepër në fokus të vëmendjes së studiuesve tanë. Në këtë drejtim, sidomos vitet e fundit, po angazhohet një rreth më i gjerë studiuesish si: sociologë, etnologë, psikologë, historianë, juristë, politologë profesionistë të shëndetit mendor, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse e të tjerë. Të gjitha këto forca synojnë të tërheqin vëmendjen dhe të kontribuojnë sado pak në zgjidhjen apo lehtësimin e problemeve me të cilat gratë shqiptare ndeshen çdo ditë. Por në vështrimin tonë, pjesë e këtij realiteti social janë një kategori e veçantë grash, siç janë **gratë e familjeve të ngujuara**, të cilat na prezantojnë një problem social tepër specifik të realitetit shqiptar, që është disi i heshtur e me ngarkesa të forta psikologjike dhe që ia vlen të hulumtohet e të studiohet konkretisht edhe në nivelin e një punimi doktorature.

1.1. Shtrimi i problemit

Në qendër të studimit tonë vihet pikërisht **problemi i grave të familjeve të ngujuara**, duke e parë këtë problem si në vështrimin social, ashtu dhe në atë psikologjik. Mendojmë se një këndvështrim i tillë mund të jetë më i dobishëm dhe mund sjellë më tepër vlera teorike dhe praktike. Këtë ide e mbështes në këto argumente:

Së pari, prania e ngujimit dhe e gjakmarrjes në realitetin shqiptar na prezanton me një problem social që mbart në vetvete mjaft koncepte e mendësi të ngurta me përmbajtje jo sociale, ku janë të pranishme paragjykime sociale, doke e zakone, të cilat transmetohen ndër

breza dhe që bëjnë të vështirë ekzistencën apo jetesën e kësaj kategorie të familjeve shqiptare. Për më tepër, ky problem nuk është i ri tek ne, por ai ka marrë një pamje disi më të egër e theks të veçantë në vitet e tranzicionit që po kalon shoqëria shqiptare, prandaj mendoj se ia vlen të studiohet për të njohur realisht nga afër gjendjen e kësaj kategorie të grave shqiptare, që vuajnë pasojat e ngujimit të familjes së tyre për shkak të gjakmarrjes. Edhe pse këto gra nuk kërcënohen drejtpërdrejt për jetën e tyre, të jetuarit në një ambient të tillë të vështirë dhe me ngarkesa të forta emocionale, ku në çdo moment dikush mund të vrasë djemtë ose burrin e shtëpisë, ky fakt na nxit për t'a njohur më nga afër këtë realitet social, duke e bërë objekt konkret të kërkimit tonë.

Së dyti, siç u përmend edhe më sipër, problemi i ngujimit shoqërohet me ngarkesa të forta psikologjike, me plot emocione negative, me stres të zgjatur e trauma psikologjike, që kanë pasoja të rënda në shëndetin mendor të subjekteve që jetojnë në një ambient të tillë. Duhet theksuar se gjakmarrja prek drejtpërdrejt burrat, por ngujimi prek në mënyrë të veçantë gratë, pasi ato vuajnë më tepër pasojat e gjakmarrjes. Pra, trajtimi i kësaj teme edhe në vështirimin psikologjik mendoj se do t'a bënte më të plotë njohjen e këtij realiteti dhe, për pasojë, kjo mund të kontribuojë realisht jo vetëm në njohje më të detajuara, por do të ishte më kontribuese edhe në gjetjen e rrugëve e të mënyrave për reduktimin apo në kapërcimin e rasteve me konflikte të tilla sociale, që aktualisht janë të pranishme, edhe pse sot jetojmë në kohë moderne.

Së treti, Të gjitha ndryshimet që pësoi vendi ynë dhe shoqëria shqiptare në fillimet e viteve '90 në përpjekjet për të ndërtuar shtetin ligjor dhe ekonominë e tregut, përpjekjet për zgjerimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, lëvizjet demografike të popullsisë, migrimi i

brendshëm dhe emigracioni jashtë vendit, të gjitha këto, në një farë mënyre, kanë ngjallur shpresa për gratë shqiptare të kësaj kategorie. Për këtë, mendojmë se duhen bërë objekt i studimit veçanërisht gratë e shpërngulura nga vendet e tyre të origjinës, kryesisht nga Veriu dhe Verilindja e Shqipërisë, që janë vendosur së bashku me familjet e tyre në periferi të Tiranës, në zonën e njohur si Bathore, si dhe në periferi të qytetit të Shkodrës. Në një vështrim, kjo e lehtëson disi punën, pasi në këto territore mund të gjendet më lehtësisht një kampion përfaqësues i kategorisë së grave të ngujuara. Pavarësisht nga numuri i tyre, mendojmë se ato formojnë një segment apo nëngrup të kategorisë së grave të ngujuara që bëjnë përpjekje për të mbijetuar, për të shpëtuar nga kthetrat e gjakmarrjes dhe për të bërë një jetë ndryshe.

Së fundi, nuk duhet harruar fakti se për kategorinë e grave të ngujuara periudha e tranzicionit historik që po kalon Shqipëria, krahas rëndimit të problemeve të mbartura e të pazgjidhura nga e kaluara, solli edhe një problematikë tjetër, që ka të bëjë me diskriminimin dhe paragjykimin e kësaj kategorie grash edhe në vendbanimet e reja, me rritjen e rrishtit për trafikimin e saj dhe të fëmijëve, rritjen e analfabetizmit tek fëmijët e tyre e të tjera.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Përmes gjetjeve të këtij studimi synojmë të zgjerojmë rrethin e njohurive tona rreth kësaj teme, duke identifikuar dhe qartësuar problemet sociale e psikologjike që shkakton fenomeni i gjakmarrjes. Për këtë, në punën tonë udhëhiqemi nga parimi se *një shoqëri nuk mund të luftojë dot kundër një fenomeni, nëse më parë nuk e pranon ekzistencën e tij*. Për më tepër, vetëm pas këtij hapi, mund të fillohet të mendohet për zgjidhje konkrete. Para kësaj, le të qartësojmë fillimisht qëllimin kryesor dhe objektivat e punimit tonë.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të studiojë gratë e familjeve të ngujuara nga Veriu i Shqipërisë, të vlerësojë problemet sociale e psikologjike me të cilat ato përballen çdo ditë dhe të sugjerojë rrugë e mënyra për kapërcimin e tyre.

Objektivat

Realizimi i qëllimit të mësipërm do të bëhej i mundur duke realizuar konkretisht objektivat që i kemi venë vetes në fillim të punës sonë dhe këto objektiva janë si më poshtë:

- Të analizohet konkretisht situata sociale dhe psikologjike në familjet e grave të ngujuara, kushtet e jetesës së tyre si dhe marrëdhëniet brenda familjes ku ato jetojnë.
- Të bëhet një vlerësim i detajuar i fenomenit të gjakmarrjes, duke e parë atë historikisht nga zanafilla deri në ditët e sotme, për të evidentuar qartë faktorët që ndikojnë në mbajtjen gjallë të fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.
- Të sigurohet njohja nga afër e subjekteve që vuajnë pasojat e gjakmarrjes, duke kryer vizita në familjet e tyre, duke vëzhguar, biseduar e intervistuar ato.
- Të evidentohen qartë fushat në të cilat ky grup social ka më shumë nevojë për ndihmë, për të sensibilizuar e për të bërë të njohur nevojat e tyre përpara organeve të pushtetit, në shoqëri civile e të tjera.
- Përmes instrumentave që do të përdorim do të shikojmë nëse gjakmarrja e përjetimi i ngjarjeve traumatike ka efekte në shëndetin mendor të këtyre grave dhe si mund të ndihmohen ato.

- Të sigurohen të dhëna përmes instrumenteve matës, nëse këto gra shfaqin simptoma të ÇSPT (Çrregullim i Stresit Post Traumatik) dhe në çfarë niveli janë ato.
- Do të formulohen sugjerime e rekomandime të nevojshme të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në reduktimin apo në zgjidhjen e rasteve të familjeve që janë në hasmëri e gjakmarrje.

Duke qenë se zgjedhja e kësaj teme për punim doktoral nuk ka qenë e rastësishme, por në gjykimin tonë mjaft e rëndësishme, synimi përfundimtar lidhet me pritshmëritë e mia si studiuese që një ditë të mund të flitet për gjakmarrjen si një fenomen i hidhur i së shkuarës së vendit tonë, që është vetëm pjesë e historisë e që nuk do të jetë më e pranishme në të ardhmen e këtij vendi.

1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Në tërësinë e vet, ky studim përpiqet që t'ju japë përgjigje dy pyetjeve kryesore kërkimore prej të cilave do të orientohet e drejtohet edhe hulumtimi ynë. Këto janë:

Pyetja 1. *Si ndikon aktualisht fenomeni i gjakmarrjes në aspektet themelore të jetës sociale të grave të ngujuara?*

Pyetja 2. *Si ndikon aktualisht gjakmarrja në gjendjen psikologjike të grave të ngujuara?*

Hipotezat

Hipoteza 1: Fenomeni i gjakmarrjes ka ndikim të drejtpërdrejtë në shumë aspekte të jetës sociale të grave të ngujuara.

Hipoteza 2: Fenomeni i gjakmarrjes ka impakt negativ afatgjatë në psikologjinë e grave të ngujuara.

Në Kapitullin e tretë mbi Metodologjinë, si pyetjet kërkimore ashtu edhe hipotezat e zgjedhura për kërkimin tonë, do të shpjegohet në mënyrë më të detajuar motivi nga jemi nisur për zgjedhjen e tyre dhe pse është bërë pikërisht kjo zgjedhje.

1.4. Rëndësia e studimit

Mendoj që kryerja e këtij studimi merr rëndësi të veçantë për disa arsye, ndër të cilat do të veçoja ato që janë më kryesoret:

Së pari, ky studim është një ndihmë modeste për të pasqyruar dhe për të njohur gjendjen reale jo vetëm të grave që do të jenë të përfshira në kampion, por të gjithë kësaj kategorie sociale.

Së dyti, nga pikëpamja metodologjike, ky studim është rezultat i kombinimit të dy paradigmave kërkimore, i paradigmes *sasiore dhe cilësore*. E para jep informacion të bollshëm mbi funksionimin e institucioneve sociale si: martesë, familja, edukimi, marrëdhëniet shoqërore, puna; ndërsa e dyta pasuron kërkimin me qasje më të personalizuar të pjesëmarrëseve në studim, siç janë: ndjesitë, opinionet, qëndrimet, vlerësimet dhe reagimet e tyre ndaj ndikimit të fenomenit të gjakmarrjes në shoqërinë shqiptare.

Gjykoj se hulumtimi i problematikës social-psikologjike të grave nga dy këndvështrime metodologjike paraqet avantazh kërkimor si për analizën, ashtu edhe për gjetjet e studimit, pasi njëra strategji kërkimi plotëson tjetrën. Mbetem me mendimin se studimet që përdorin metodat e kombinuara të paradigmave kërkimore paraqesin avantazhe të dukshme në raport me studimet që përdorin një metodologji të vetme.

Edhe pse, shpesh, debate të ndryshme e banalizojnë fenomenin, duke u fokusuar thjesht në shifra të individëve të përfshirë apo në statistika të viktimave të gjakmarrjes, përmes këtij studimi jemi munduar të penetrojmë më thellë për të njohur jo vetëm numrat, por edhe pozitën, realitetin dhe gjendjen, si dhe të bëjmë një studim holistik të këtyre grave. Përmes tyre, edhe të familjeve të tyre.

Ky studim mendoj se do të jetë një ndihmë modeste për grupet e interesit. Diskutimet dhe rezultatet e këtij studimi mund të ndihmojnë për të mobilizuar instanca të ndryshme të shoqërisë sonë, qeveritare ose joqeveritare, për ndërtimin e ligjeve dhe strategjive specifike dhe të qëllimshme në parandalimin dhe shërimin e kësaj dukurie. Është e dukshme që ky target grup është i lënë pas dore edhe deri diku evitohet si nga përfaqësuesit e pushtetit vendor ashtu edhe nga mësuesit e zonës ku këto familje jetojnë. Veprimtarët social gjithashtu dhe OJF-të që ushtrojnë aktivitetet në vendin tonë, veçanërisht shoqatat e grave dhe ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut duhet të kenë një fokus të veçantë mbi këtë kategori njerëzish. Gratë dhe fëmijët e këtyre familjeve përbëjnë një grup vulnerabël, që kërkon domosdoshmërisht mbështetjen ligjore, ekonomike dhe sociale të shtetit dhe të të gjithë shoqërisë. Por gratë duhet së pari të bëhen të dukshme për veten e tyre dhe pastaj për shoqërinë.

Gjykoj se ky studim është i rëndësishëm, pasi përpiqet të japë informacion të mjaftueshëm për këtë fokus grup, dhe në këtë mënyrë, punonjësit socialë të cilët punojnë në këto zona do të mund të orientohen më lehtë për të kuptuar më mirë kontekstin kulturor dhe historik të fenomenit si dhe për të ndikuar në parandalimin e tij. Po ashtu edhe studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale kanë një mundësi të artë për studim më të detajuar të dukurisë së

gjakmarrjes, pasojat dhe mangësitë që shkakton kjo dukuri për zhvillimet sociale në të ardhmen, si dhe të ndikojnë në nxitjen dhe përfshirjen e ligjbërësve në ndërtimin e politikave për këtë grup social me përmasa të konsiderueshme.

Studimi është një material autentik për gjendjen psikologjike të këtyre grave dhe për çrregullimet e stresit që ato vuajnë. Kjo gjë mund të nxisë qoftë edhe një projekt nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë për t'i ardhur në ndihmë kësaj popullate. Duke qenë se dukuria e gjakmarrjes është një dukuri komplekse, përballja e saj kërkon bashkëveprimin e aktorëve të ndryshëm social dhe shtetëror. Shpresoj që përmes këtij studimi të mund të jap kontributin tim modest në kapërcimin e kësaj sfide.

1.5. Konceptet kryesore dhe përkufizimi i tyre

Për të arritur objektivat e vendosura në këtë studim dhe për t'i kuptuar ato qartësisht kemi bërë analizën e situatave, shqyrtimin e literaturës ekzistuese, interpretimin dhe analizën e të dhënave përmes disa koncepteve bazë. Më poshtë kemi shpalosur kuptimin dhe përkufizimin e këtyre koncepteve dhe atë çfarë kemi dashur të shprehim përmes tyre kur i kemi përdorur në tekst të këtij studimi.

Vështrim-i: Në fjalorin e gjuhës shqipe, përveç kuptimeve të tjera të drejtpërdrejta, shpjegohet gjithashtu si një paraqitje e përmbledhur e të dhënave, e fakteve e të tjera, që lidhen me një objekt a me një ngjarje të veçantë.

Kjo fjalë në fjalorin e gjuhës angleze përdoret në kuptimin e përshkrimit të diçkaje. Pra, që na siguron informacione të përgjithshme e jo të detajuara për atë gjë.

Vështrimi Social: është një paraqitje e studimit të shoqërisë dhe mënyrës se si njerëzit jetojnë. Në studimin tonë ne jemi përpjekur që të kemi një ide të përgjithshme për mënyrën se si këto gra jetojnë. Këtë e kemi realizuar përmes analizës së të dhënave të karakterit demografik, historisë familjare të ngujimit, raportet familjare me në qendër gruan, raportet e tyre bashkëshortore, ato me komunitetin, duke paraqitur edhe gjendjen e tyre ekonomike.

Vështrim psikologjik: është një vështrim ose paraqitje e veçorive psikike të një njeriu a të një grupi njerëzish. Ky është një nocion mjaft i gjerë dhe do të duheshin studime të panumërta, në mënyrë që të jepej një paraqitje e të gjitha veçorive psikologjike të një grupi të caktuar njerëzish. Prandaj në studimin tonë ne do të fokusohemi për të parë nëse këto gra vuajnë nga çrregullimi i stresit post traumatik.

Ngujim-i: është mbyllja brenda në një ndërtesë të caktuar, kullë apo në një shtëpi, për një kohë të gjatë për t'u ruajtur nga gjakësi. Në fjalorin anglisht fjala “*ngujim*” do të thotë të ndash diçka nga gjërat e tjera me të cilat më parë ka qenë e lidhur ose e përzier.

Familjet e ngujuara: në studimin tonë janë ato familje, meshkujt e të cilave për një kohë të gjatë kanë ndenjur dhe vazhdojnë të rrinë brenda mureve të shtëpisë, sepse kërcënohen të vriten nga hasmi për një krim të bërë nga vetë ata ose nga dikush tjetër në fisin e tyre.

Gjakmarrje: Zakon i egër e i prapambetur fisnor e feudal sipas të cilit, për të marrë hakun e një të vrari, duhet vrarë njëri prej anëtarëve të familjes a të fisit të vrasësit. Kjo bëhet sipas parimit që gjaku shlyhet veç me gjak. Collins English Dictionary e përkufizon gjakmarrjen si një konflikt në të cilin anëtarët e familjeve ose klaneve në armiqësi vrasin njëri tjetrin.

Kanun: Në fjalorin e gjuhës shqipe përkufizimi i fjalës “*kanun*” është një përmbledhje ligjesh e normash të pashkruara, të trashëguara brez pas brezi, që pasqyrojnë gjendjen

ekonomiko-shoqërore të periudhave të kaluara dhe që në kohën e vet mbronin interesat e klasave e të shtresave të caktuara shoqërore; tërësia e normave të së drejtës zakonore. Në Shqipëri ekzistojnë lloje të ndryshme kanunesh, por në studimin tonë, sa herë që përmendet fjala “*kanun*”, i referohemi kanunit të Veriut të Shqipërisë, Kanunit të Lek Dukagjinit.

Fenomen Social: Në sociologji janë ndërtimet e jashtme sociale të individëve që influencojnë jetët tona dhe zhvillimin, të cilat janë vazhdimisht përfshirëse, ndërsa rritemi dhe maturohemi. Kategoritë e fenomeneve sociale janë mjaft të ndryshme dhe të komplikuar, por parimi thelbësor i një fenomeni të tillë është krijuar nga shoqëria si një opionencë dhe kundërshtim ndaj gjithçkaje që ndodh natyrshëm në botë. Pra, fenomeni social përfshin në vetvete influencat e të gjithë sjelljes.

ÇSPT: Çrregullimi i Stresit Post-Traumatik është një çrregullim i stresit dhe një çrregullim shqetësues mendor që ndodh pasi dikush përjeton ose dëshmon një ngjarje traumatike ose tmerruese, që i ndodh atij vetë ose një personi të afërt të tij.

1.6. Organizimi i studimit

Ky studim është organizuar dhe është ndarë në gjashtë kapituj. Në fund të kapitujve janë të vendosura referencat dhe Shtojca. Më poshtë po japim një përmbledhje të strukturës së tij.

Kapitulli I: Kapitulli i parë është hyrja e studimit ku bëhet paraqitja e fushës së kërkimit, kemi shpalosur problemin themelor që do trajtojmë dhe kemi cilësuar se ku është përqendruar më shumë puna jonë kërkimore. Gjithashtu kemi prezantuar qëllimin e punës sonë dhe objektivat që duam të arrijmë në fund të studimit; parashtrohen pyetjet kërkimore

që do të drejtojnë studimin në dy shtylla kryesore; hipotezat e ngritura, rëndësia e studimit, përkufizimi dhe shpjegimi i termave dhe i koncepteve bazë të përdorur.

Kapitulli II: Shqyrtimi i literaturës. Në këtë kapitull kemi bërë një përmbledhje dhe shqyrtim të literaturës ekzistuese si dhe të studimeve të kryera më parë nga studiues të ndryshëm jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Kemi identifikuar çështjet kyçe që kanë lidhje dhe na ndihmojnë në studimin tonë. Gjithashtu kemi paraqitur një studim të detajuar të fenomenit të gjakmarrjes, duke u nisur nga mesjeta e deri në ditët tona. Më pas, ndalemi kryesisht në çështje të tilla si: gjakmarrja dhe rregulli social; shoqëria shqiptare dhe gjakmarrja, rigjallërimi i fenomenit të gjakmarrjes në ditët tona, gruaja në realitetin e gjakmarrjes e të tjera. Po kështu, në vështrimin teorik, pjesë e këtij kapitulli janë edhe çështje, që ndihmojnë vlerësimin dhe analizën tonë në këndvështrimin psikologjik të tilla si: çfarë është Çrregullimi i Stresit Post Traumatik, tiparet dalluese të tij, kush vuan nga ky çrregullim, ÇSPT dhe ndryshimet gjinore, ÇSPT dhe faktorët e riskut e të tjera.

Më tej, në këtë paraqitje teorike, duke analizuar literaturën që kemi arritur të sigurojmë, bëjmë përpjekje për të identifikuar ndryshimet, kundërshtimet dhe keqinterpretimet lidhur me rëndësinë dhe ashpërsinë e praktikës së ligjeve kanunore, si dhe jehonën e tyre deri në ditët e sotme.

Kapitulli III: Metodologjia. Në këtë kapitull cilësohet metodologjia që përdoret në këtë studim. Fillimisht përshkruhet natyra dhe karakteristikat e kërkimit. Më pas vazhdohet me kampionin dhe mënyrën e përzgjedhjes së tij, sqarohen dhe përshkruhen me hollësi instrumentet e përdorura për të siguruar mbledhjen e të dhënave parësore; Paketa e analizës

së të dhënave; Instrumentet e përdorur: Pyetësi i të dhënave demografike dhe sociale, Pyetësi për historinë e traumës, Intervista Matëse e Simptomave të ÇSPT

Në këtë kapitull bëhet një analizë përshkruese e pjesëmarrësve në studim dhe përshkruhet mënyra dhe arsyeja përse u bë kjo përzgjedhje dhe përse u zgjodh ky kampion përfaqësues. Paraqiten kufizimet dhe vështirësitë e studimit. Një vend të rëndësishëm në këtë pjesë zënë edhe materialet e mbledhura për qëllim të këtij studimi nga dy intervista: Intervista e parë me z. Sokol Delija, njëri prej bajraktarëve të Nikajve të Tropojës, por që është i njohur pozitivisht në komunitetin e kësaj kategorie dhe që ka punuar papushim për të zgjidhur konfliktet jo vetëm në Tropojë, por edhe në Shkodër, Lezhë, Mirditë e të tjera. Material tjetër domethënës është nxjerrë nga intervista e bërë me z. Luigj Mila, president i shoqatës së njohur në Shkodër “Drejtësi dhe Paqe”. Edhe z. Mila është një aktivist i shoqërisë civile, i cili bën një punë pozitive në luftën kundër këtij fenomeni dhe në zgjidhje të konflikteve mes familjeve. Veç kësaj, material tjetër i prezantuar është marrë nga Forumi akademik i organizuar nga Caritas Albania me temën “Gjakmarrja në Shqipëri”.

Kapitulli IV: Analiza empirike e të dhënave. Ky kapitull paraqet me hollësi analizën e të dhënave, rezultatet e mbledhura nga pyetësi i parë, i cili është formuar për qëllim të këtij studimi dhe mbledh kryesisht të dhëna demografike dhe sociale. Këto të dhëna janë të paraqitura me tabela dhe me grafikë, duke paraqitur për çdo pyetje dendësinë absolute dhe atë relative. Pas kësaj ne kemi bërë një analizë të detajuar të tyre për të parë se në çfarë forme dhe mase lidhen ato me pyetjet kërkimore dhe me objektivat e studimit tonë. Në po këtë kapitull, kemi bërë edhe paraqitjen e të dhënave të mbledhura përmes pyetësit të dytë që është pyetësi për historinë e traumës. Nga ky pyetësor kemi hequr rubrikën që mbledh të

dhëna për përvojat traumatike seksuale. E konsiderova të arsyeshëm këtë rimodelim duke ditur që gratë e këtij komuniteti e kanë shumë të vështirë të flasin për marrëdhëniet seksuale mes bashkshortësh dhe prania e këtyre pyetjeve do të ndikonte përgjigjen e tyre për rubrikat e tjera të pyetësorit. Edhe në këtë rast, të dhënat janë shfaqur me grafikë e tabela dhe është parë qartë që çdo grua ka qenë e ekspozuar ndaj një ngjarje traumatike. Në vazhdimësi, është paraqitur edhe instrumenti që ka mbledhur të dhënat nëse tek këto gra ka prani të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik. Analiza e këtyre të dhënave na tregon jo vetëm prezencën, por edhe intensitetin e këtyre simptomave në jetën e përditshme të këtyre grave. Përmes të dhënave të këtij pyetësori dhe interpretimit të tyre do të shihet nëse fenomeni i gjakmarrjes ka rritur mundësinë që gratë e familjeve të ngujuara të vuajnë nga çrregullimi i stresit post traumatik.

Kemi përfshirë gjashtë intervista të hapura që janë bërë me gra, të cilat ishin më të disponueshme për të treguar më shumë nga historia e tyre e ngujimit. Katër intervistat e para janë histori të personave që e vuajnë gjakmarrjen dhe dy të tjera janë të personave që kanë dëgjuar dhe njohin njerëz të ngujuar, por që vetë nuk e kanë përjetuar ngujimin. Kjo bëhet me qëllim që të shihet se sa shumë empatizoheshin gratë me njëra tjetrën dhe si i kuptonin këto të fundit shoqet e tyre në ngujim. Në këtë kapitull kemi vendosur edhe materialet e dy fokus grupeve të mbledhura njëri në zonën e Shkodrës dhe tjetri në zonën e Bathores. Në fund të çdo interviste kemi përmbledhur shkurtimisht veçoritë sociale dhe psikologjike dalluese të çdo interviste.

Kapitulli V: Në këtë kapitull janë të vendosura diskutimet e gjetjeve kyçe të këtij studimi. Në fillim janë paraqitur gjetjet dhe çështjet kryesore të identifikuara dhe më pas jemi

përpjekur t'i interpretojmë ato nën dritën e objektivave, problematikës dhe objektivave të këtij studimi, duke u përpjekur kështu të shikojmë nëse hipotezat e ngritura në fillim janë të vërteta dhe nëse pyetjet kryesore kërkimore kanë marrë përgjigje.

Kapitulli VI: Konkluzione dhe rekomandime për zgjidhje të situatës dhe për studime të mëtejshme. Ky kapitull paraqet përfundimet që kemi nxjerrë nga ky kërkim si dhe kemi dhënë disa sygjerime dhe rekomandime për gjetjen e rrugëve institucionale për zgjidhjen e problemit të gjakmarrjes. Kemi bërë gjithashtu edhe një përmbledhje të përgjithësuar për gjetjet e analizuara në kapitullin 5. Në fund janë vendosur Referencat dhe Shtojca.

KAPITULLI II

SHFLETIMI I LITERATURËS

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të literaturës që kemi përdorur në këtë studim, për të parë si trajtohet ky problem në studime të kryera më parë nga studiues të huaj si dhe nga studiuesit tanë. Më konkretisht, në këtë kapitull bëhen përpjekje për ta parë dukurinë e gjakmarrjes në mënyrë kronologjike, duke u nisur nga mesjeta e deri në ditët tona. Në këtë vështrim, kërkimi ynë në burimet e literaturës synon të evidentojë historinë e gjakmarrjes, si lindi dukuria e gjakmarrjes dhe cili është koncepti për të, si ka evoluar ky koncept bashkë me civilizimin shoqëror. Veç kësaj, nga ana jonë bëhen përpjekje për të evidentuar si vlerësohen pasojat e dukurisë së gjakmarrjes nga studiuesit, qëndrimet që ata mbajnë dhe çfarë rrugësh apo mënyrash sugjerojnë për reduktimin e saj.

2.1. Koncepti mbi gjakmarrjen dhe përmbajtja e saj

Fenomeni i gjakmarrjes është hasur që në mesjetë e ndoshta edhe më herët, përgjithësisht ndër popujt e Mesdheut dhe sidomos në territoret shqiptare, Italinë jugore, Korsikë dhe në pjesët Europiane të Turqisë së sotme (Valentini, 2005; fq. 666-667, 670-672). Gjakmarrja fillimisht ishte një sanksion, por me kalimin e kohës kuptimi i saj u zgjerua dhe sot shihet si një praktikë zakonore, një ligj shoqëror ose fetar, ligj i pashkruar, hakmarrje e thjeshtë ose kombinim i tyre (Mile, 2007). Por ndërsa si praktikat e tjera zakonore edhe gjakmarrja u harrua nga shumë popuj të Europës, shqiptarët kanë bashkëjetuar më gjatë me të dyja këto dhe kanë kaluar më vonë në të drejtën shtetërore. E shkruar sot në Kanunin e Lek Dukagjinit, e kaluar dikur gojë më gojë me qëllimin e mirë për të ruajtur rregullin e jetën në një vend ku

shteti ishte larg shtetasve të vet, gjakmarrja arriti të kalonte nga njëri brez në tjetrin, deri sa mbërriti në ditët e sotme. Qeverisja kanunore gjatë pushtimit shekullor osman, vonesa në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe të gjykatave shtetërore, dobësitë e qeverisjeve të ndryshme dhe lënia jashtë vëmendjes të pjesës veriore dhe verilindore të vendit gjatë viteve të tranzicionit, interesi i ulët për arsimim, mundësitë e pakta ekonomike dhe vështirësitë e jetesës në zonat malore të izoluara dhe pa infrastrukturë, konsiderohen si disa prej faktorëve që ndihmojnë në mbajtjen gjallë të këtij kodi zakonor dhe të fenomenit të gjakmarrjes në Shqipërinë e shekullit të XXI.

2.1.1. Vrasja për gjakmarrje

Në Kanun thuhet se “*gjaku gjithmonë lahet me gjak*” dhe parashikohen rregulla specifike për raste të veçanta të gjakmarrjes (Durham, 2000). Bazuar në këtë kod social, një person duhet ose është i “detyruar” (nga shoqëria) të vrasë një person tjetër me qëllim që të shpëtojë nderin nga një vrasje e mëparshme ose nga një ofendim publik, që mund t’i ketë ndodhur një pjestari të familjes së tij. Pikërisht kjo praktikë njihet si gjakmarrje (Gëllçi, 2005). Gjakmarrja, e cila në Kanunin e Lekë Dukagjinit konsiderohet si dënim kapital, është marrja e jetës së atij individi apo të pjestarëve të familjes së atij individi që ka kryer një vepër të rëndë ndaj jetës, familjes, pronës, nderit dhe dinjitetit të dikujt tjetër (Vickers & Pettifer, 2000). Në Kanun janë 150 norma në lidhje me “gjakun” dhe “gjakmarrjen”. Sipas këtij ligji, “*gjaku*” ose vrasja është veprimi ku jeta e dikujt merr fund, ndërsa “*gjakmarrja*” është vrasja e dytë që bëhet për të “*rimarrë (hakmarrë) gjakun*” e personit të parë të vrarë. Sipas Plasar, vrasja e dytë është dënim për vrasjen e parë. E dyta, bazohet në parimin “*gjak për gjak*” dhe nënkupton dënimin e vrasjes me vrasje dhe/ose që vrasja është e njëjtë me vrasjen, por që

ndërkohë, nuk mund të vrasësh dy ose më shumë njerëz për të marrë hakun e një vrasjeje të vetme. Nëse familja e të vrarit vret më shumë se një person, kjo nuk është më thjesht gjakmarrje dhe sjell më pas një tjetër vrasje, por këtë herë kundër familjes që kreu më shumë se një vrasje (Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999); (Plasar, 2000).

2.1.2. A është gjakmarrja hakmarrje?

Në gjuhën e përditshme shpesh këto dy terma ngatërrohen ose zëvendësojnë njëri tjetrin. Por cili është ndryshimi midis konceptit të Gjakmarrjes dhe Hakmarrjes? Publicisti i njohur Mustafa Nano ka dhënë një përkufizim mjaft të qartë midis këtyre dy termave. Në një prej artikujve të tij të botuar në vitin 2012, me titullin ‘Gjakmarrja si ‘veçori’ kombëtare dhe ngatërresa që i behët me hakmarrjen’, ai e cilëson këtë si një ngatërresë që shumë persona e bëjnë në Shqipëri, duke theksuar se hakmarrja nuk është një fenomen që ndodh vetëm ndër shqiptarë. Sipas këndvështrimit të tij hakmarrjet për krimet e kryera bëhen në gjithë botën, madje janë të panumërt filmat e Hollywood-it që kanë për fabul hakmarrjen. Por ndërsa shqyrtojmë këto dy koncepte, është e rëndësishme të cilësojmë që vrasjet për gjakmarrje në më të shumtën e rasteve nuk janë hakmarrje. Madje vrasjet për gjakmarrje ndryshojnë rrënjësisht nga ato që bëhen për hakmarrje. Më poshtë po japim dy arsye kryesore se përse këto vrasje ndryshojnë nga njëra tjetra:

Së pari, kur dikush vret një person për t’u hakmarrë kundër tij për një krim të kryer më parë, historia mbyllet me këtë vrasje. Kjo për shkak se zgjidhjen e konfliktit e bën shteti. Edhe nëse shteti nuk e zgjidh situatën ashtu siç duhet, historia mbyllet aty, në pritje që një ditë shteti do të veprojë. Por kur vritet një person që është target i gjakmarrjes, për të larë gjakun

e një krimi të kryer më parë jo nga vetë ai, por nga një person tjetër në fisin e tij, ngjarja nuk merr fund aty. Ky gjak i derdhur thërret prap për derdhje gjaku, që duhet të bëhet nga familjarët e jo nga shteti dhe nuk merr fund madje edhe në rastin më të mirë kur shteti e dënon me drejtësi vrasësin e parë. Edhe pse ka shumë mendime që funksionimi i një shteti të konsoliduar dhe fuqizimi i një sistemi drejtësie të pakorruptuar janë elementët kyç që fenomeni i gjakmarrjes të marrë fund, mendoj që vetëm këto dy elementë nuk mjaftojnë për t'i dhënë zgjidhje kësaj dukurie. Ky mendim na çon në arsyen e dytë pse gjakmarrja dhe hakmarrja ndryshojnë rrënjësisht mes tyre.

Së dyti, nëse vrasja për hakmarrje kryet vetëm nga një person, me vullnetin e tij individual dhe pa përfshirjen e palëve të treta, në vrasjet për gjakmarrje është vetëm një person që tërheq këmbëzën e armës, por pas gishtit të tij qëndron një grup i madh njerëzish që mendojnë të njëjtën gjë si ai. Personi që merr gjakun është thjesht një viktimë e mentalitetit dhe traditave të familjes dhe të komunitetin ku ai jeton. Kjo mendësi justifikohet dhe mbrohet me kanunin edhe në rastet më brutale të shkeljes dhe deformimit të ligjeve të kanunit. Gjithashtu ky person është viktimë e një morali të caktuar publik a kolektiv, e një ethosi të caktuar, të cilët të shtojnë të marrësh gjak, të justifikojnë në rastin kur ti merr gjak, madje, të nderojnë për vrasjen që ti bën, ose të bëjnë të ndihesh me turp në rastin kur ti nuk e bën atë vrasje (Nano, 2012 <https://www.shqiperia.com/shqip//aID/1712>). Kështu mund të themi se hakmarrja është një reagim i egër dhe gjaknxehët njerëzor. Kurse gjakmarrja mund të cilësohet më shumë si një dukuri sociale dhe një veprim i mirëmenduar dhe i planifikuar në grup. Dëshira dhe kultura, tradita dhe opinionet e të tjerëve që nxisin individët e përfshirë në këtë fenomen për t'a mbrojtur vet nderin e familjes së tyre, i shtyn njëri-tjetrin të përfshirë në këtë fenomen për t'a mbrojtur vet nderin e familjes së tyre, i shtyn njëri-tjetrin të përfshirë në këtë fenomen për t'a mbrojtur vet nderin e familjes së tyre, i shtyn njëri-tjetrin të përfshirë në këtë fenomen për t'a mbrojtur vet nderin e familjes së tyre.

dëmtuar (së cilës i është bërë një vrasje, i është dëmtuar prona ose nderi i tij ose i një anëtar i të familjes) që të marrin përsipër zgjidhjen e situatës, e cila është vrasja. Kjo, edhe kur shteti e ka dënuar fajtorin e krimit fillestar me dënimin e përcaktuar me ligj.

Sipas studiuesit tonë, Elezi, nuk mund të ketë njehsim të këtyre dy nocioneve, pasi dallimi mes hakmarrjes dhe gjakmarrjes është që, vrasja për gjakmarrje kryhet për të marrë gjakun e një vrasje të mëparshme, tentativë për vrasje, plagosje të rëndë apo të lehtë, kurse vrasja për hakmarrje bëhet si shpagim për rrahje, grindje, fyerje, dhunë, veprime të padrejta të mëparshme (Elezi, 2000, fq. 7).

Përmes përcaktimit të dallimit mes hakmarrjes dhe gjakmarrjes kuptojmë rrethanat e vrasjes së parë dhe asaj që pason ose kërcënimit për vrasje. Shumë vrasje sot nuk justifikohen dot me Kanunin, por mund të cilësohen si *vrasje për vetëgjyqësi*. Njerëz të cilët nuk e kanë lexuar kurrë kanunin e përdorin atë vetëm si një nocion referimi për të justifikuar veprimet e tyre përpara një shoqërie që e legjitimon kanunin, por jo vetëgjyqësinë ndaj njerëzve të pafajshëm. Në shumë nga këto raste edhe pse mungon baza kanonike, familjet fshihen ose ngujohen, dërgojnë ndërmjetës që të bisedojnë për falje, duke e futur kështu veten automatikisht në situatë gjakmarrje. Kjo nga frika e pasojave të ashpra që sjell gjaknxehësia, vetëgjyqësia dhe gjakmarrja në jetën jo vetëm të një personi, por të një fisi të tërë, e më tej, të një komuniteti të tërë.

2.2. Gjakmarrja në vëmendje të shkencave sociale

Dukuria e gjakmarrjes ka ngjallur shumë interes në shkencat sociale pas një gjysmë shekulli, në një kohë kur ajo dukej se ishte zhdukur. Kështu, ajo ka tërhequr vëmendjen e disa grupeve me fokus të veçantë. Kriminologjia psh. është e interesuar në konkurrencën e ligjit të shtetit

modern dhe sistemit ligjor tradicional (Wahl, 1984). Etnologjia ka qenë shumë aktive në kërkime mbi gjakmarrjen në Kosovë, Shqipëri dhe zona të tjera të Ballkanit (Oakes, 1997; Schwander – Sievers, 1995). Teologjia ka rizbuluar gjakmarrjen si një problem të një drejtësie hyjnore, që mbështetet në thënien; “Sy për sy dhe dhëmb për dhëmb”, e shkruar në Dhjatën e Vjetër (Levetiku 24:20, Bibla). Vetë Bashkimi European po përballet me pasojat e këtij fenomeni, ndërsa kërkon të gjejë zgjidhje për qindra emigrantë azilkërkues kryesisht nga veriu i Shqipërisë, të cilët deklarojnë se për shkak të gjakmarrjes ata janë të kërcënuar me jetën nëse kthehen në vendin e tyre. Nga ana tjetër, globalizimi ka patur ndikimin e vet në sektorë të ndryshëm të zhvillimit të një vendi, duke përfshirë këtu edhe vendin tonë. Të gjitha këto: emigrimi, internacionalizimi i konflikteve etnike dhe konkurenca në rritje midis traditës dhe fesë, mund të përmbliidhen si *fenomeni i globalizimit*. Për më tepër, mund të thuhet se globalizimi e ka sjellë në dritë gjakmarrjen si një fenomen ekzistues ligjor dhe kulturor, i cili nuk mund të anashkalohet.

Sigurisht, ka pasur një periudhë të interesit shkencor për gjakmarrjen kohë më parë, por shumica e artikujve për këtë fenomen datojnë ose në kohën tonë ose në fillimet e shek XX. Për këtë literaturë, fenomeni i gjakmarrjes ishte me interes si një fenomen etnologjik (Corso, 1930; Cozzi, 1910). Nga ana tjetër, gjakmarrja shihej si një problem i hershëm ligjor European (Ducros, 1926) dhe ishte interesante për shkencat sociale, sepse ofronte një këndvështrim alternativ të sistemit ligjor modern dhe të zhvillimit të parashikuar të tij. Gjakmarrja sot ka të bëjë më shumë me pasionin për të trazuar ndjenjat për hakmarrje dhe me vetëgjyqësinë. Disa preferojnë ta lexojnë gjakmarrjen si një alternativë ndryshe ndaj modernitetit. Të tjerë e shohin atë si një apendiks qesharak të paramodernitetit. Honore de

Balzak novelën e tij *La Vendetta* (1996 [1855]) e shkroi në një kohë të një mungese të madhe të rregullit social e moral dhe pasqyronte dëshirat e tij për “*kohët e mira të vjetra*”. Burime të tjera të literaturës, nga ana tjetër, kanë tendencë ta banalizojnë këtë fenomen social duke e cilësuar si tipar të një shoqërie me tipin sanguin të personalitetit (Goscinnny & Uderzo, 1999). Nga pikëpamja e këtyre autorëve, gjakmarrja është shenjë e një karakteri të papjekur kulturor.

Sado të tunduar të jemi për të gjykuar fenomenin e gjakmarrjes, ekzistenca e saj mbetet e pakuptueshme në një shoqëri moderne si kjo e sotmja, e veçanërisht pasioni që përfshihet në të mund të admirohet ose të përqeshet, por nuk mund të mohohet.

2.2.1. Gjakmarrja dhe rregulli social

Edhe pse shpesh gjakmarrja është cilësuar si një fenomen primitiv, ajo është përshkruar gjithashtu si një mekanizëm parandalues i dhunës. Nderi dhe turpi janë elemente të dinamikës së këtij fenomeni mjaft kompleks, i cili përfshin më shumë njerëz sesa në të vërtetë kanë lidhje me të. Sipas sociologëve, gjakmarrja prek disa çështje të kërimit social, siç janë familja (Dean, 1997), ndërlidhja dhe ndërvlerësia sociale, si dhe pikëpyetjet mbi shtetëzimin (Godelier, 1999, fq.20).

Sado i paqartë të jetë, koncepti i gjakmarrjes nuk mund të njehësohet kursesi me mungesën e rregullit social. Në disa shoqëri ku është praktikuar ky fenomen, gjakmarrja është konsideruar si e kundërta e kaosit dhe në kontrast të plotë me kaosin e thjeshtë në shoqëritë pa qeverisje të plotë qendrore, si mekanizëm përmes të cilit kërkohej të arrihej një balancë sociale (Rosenthal, 1996, fq.137). Sipas shpjegimit Biblik dhe teologjik, themeli universal i çdo gjakmarrje është ideja se gjaku mund të lahet vetëm me gjak dhe me asgjë tjetër. “*Cildo*

që derdh gjakun e një njeriu, gjaku i tij do te derdhet nga një njeri, sepse Perëndia e ka krijuar njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij” (Bibla, Zanafilla 9:6). Pra sipas këtij koncepti, ata që vrasin për të marrë gjakun, e bëjnë diçka të tillë të detyruar për të vendosur në vend rregullin e duhur social, i cili është prishur me vrasjen e parë. Nëse gjakmarrja shihet si një fenomen primitiv për të parandaluar dhunën dhe për të vendosur rregullin social, ne jemi të vetëdijshëm që është provuar edhe e kundërta. Ajo ka qenë nxitës i vazhdimësisë së dhunës dhe krijimit të një kaosi që është kalur brez pas brezi, por që kurrë nuk është harruar.

Në funksionimin e gjakmarrjes ka disa rregulla interesante që shpesh janë edhe kontradiktore në përmbajtjen e tyre. Kështu psh. nëse gjakmarrja kombinohet me çështjen e nderit (ashtu siç ka ndodhur shpesh), atëherë jo vetëm dëmtimi fizik duhet të shpaguehet me gjak, por gjithashtu edhe dëmtimi i nderit të personit. Psh. sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, nëse në një konflikt të ashpër, dikush vret dikë tjetër duke i dëmtuar fytyrën, vrasësi i ka marrë viktimës jo vetëm jetën, por edhe nderin e tij, pasi fytyra është simbolikë e nderit. Vrasësi do ta bënte një gjë të tillë vetëm nëse viktimja gjatë konfliktit do të cënonte nderin e tij. Përndryshe, nëse viktimja nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe është vrarë nga vrasësi, duke iu dëmtuar fytyra, atëherë familja e dëmtuar ka të drejtën sipas kanunit që të marrë dy herë gjak ose të bëjë një vrasje të ngjashme, duke dëmtuar fytyrën tek personi që do të hakmerret. Kjo gjë mund ta bëjë këtë ligj të humbasë efektin e tij rregullues.

Është dëgjuar shpesh të flitet për “*Dhënien e Besës*” si një nga virtytet e shqiptarit. Gjurmët e këtij zakoni mund t’i gjejmë edhe tek sjellja në situatë gjakmarrje. Dhënia dhe marrja e besës mund të jetë një proces lehtësues dhe ndihmues, madje edhe sigurues (Kanuni, 2009 {1933}, Libri i 7-të, Nye i 88-të). Kjo bëhet për një farë kohe për disa nga anëtarët e familjes

së ngujuar, por kur nderi që është si një *reaktor shpirtëror* i grupeve dhe fiseve familjare është nën kërcënim, atëherë gjakmarrja bëhet në mënyrë të frikshme e komplikuar.

Thyerja e Besës duket të jetë një burim i pashmangshëm i gjakmarrjes, sepse *besa* përfshin disa aktorë konfliktualë, jo vetëm palët e konfliktuara në fillim. Kështu psh, nëse një person vritet kur është mik në shtëpinë e dikujt tjetër, vrasësi mund të ketë marrë kështu gjakun e një të afërmi të tij të kryer më parë, por gjithashtu, ai ka prerë në besë të zotit e shtëpisë dhe ai do të kërkojë që të hakmerret për gjakun e personit të vrarë edhe nëse nuk ka asnjë lidhje gjaku apo farefisnore me viktimën (Stephanie Schwandner-Sievers, 1995, fq.116). Gjithashtu, është farefisi i personit të vrarë që mund të mbajë dy qëndrime ndaj një situate të tillë: Do të përpiqet vetë që të marrë gjakun e personit të tyre të afërt, ose do të detyrojë apo kërcënojë të zotit e shtëpisë, në të cilën u vra personi, që ai vetë të marrë hak për personin që u vra nën besën e tij (Kanuni, 1999).

Ky fenomen është një ndëshkim, i cili është njohur si i ligjshëm nga shoqëria, edhe pse ekzekutimi i tij është porositur nga anëtarë individualë. Shoqëria pranon gjakmarrjen si një nga masat e mundshme për të siguruar stabilitetin e saj, por duhet theksuar se mjete të tilla janë shumë primitive.

Sipas studiuesve, gjakmarrja është një reagim shumë i pasionuar dhe i pamenduar ndaj kërcënimit të jashtëm dhe kjo ndihmon për të dalluar anëtarët e grupit nga ata që janë të huaj. Durkheim është i bindur se shoqërisë moderne i mungojnë pasionet e egra, të cilat kulminojnë në gjakmarrje. Pasionet në shoqërinë moderne janë më shumë individuale sesa kolektive dhe përdoren për karrierën personale dhe jo për vendosjen e axhendave kolektive (Durkheim, 1975,b fq.161; 1968, fq.143).

Autorët perëndimor kanë shkruar për gjakmarrjen me ndjenja zemërimi dhe admirimi në të njëjtën kohë, sepse pasionet për ta pasqyrojnë një parajsë të humbur të shfaqjes hapur të ndjenjave. Kështu, në shkrimet e tyre gjakmarrja është përshkruar si burrërore, po ashtu edhe femërore. Në raste të tjera nuk është asnjëra prej këtyre, përveçse një pasion legjitim që duhet të formohet në sens ligjor. Asnjë kulturë nuk pranon shfaqen e egër të ndjenjave të gjakmarrjes. Çdo kulturë njih dhe përdor mekanizma që shërbejnë për t'i qetësuar këto ndjenja.

2.3. Shoqëria shqiptare dhe gjakmarrja

Shqipëria ka një popullësi të përbërë prej 2.9 milion njerëz, të cilët jetojnë brenda territorit shqiptar dhe pothuajse i njëjti numer shqiptarësh jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë, kryesisht në vendet e ish-Jugosllavisë, si dhe emigrantë, që për shkaqe ekonomike janë zhvendosur në disa vende të tjera dhe kryesisht në Greqi, Itali, Gjermani e të tjera. Shqipëria ka pesë fe zyrtare të njohura nga qeveria; komuniteti musliman, komuniteti bektashi, komuniteti katolik, komuniteti ortodoks dhe komuniteti ungjillor. Rreth 58 % e popullsisë së Shqipërisë i takon komunitetit musliman. Njerëzit po largohen nga vendi për shumë arsye dhe njëra nga këto është edhe papunësia, e cila është rritur me 17.3 %. Forca punëtore është duke u përpjekur të emigrojë në vendet perëndimore për të bërë një jetë më të mirë. Rreth 54 % e popullsisë jeton në zonat urbane dhe në bazë të raporteve të tre muajve të parë të vitit 2015 vendi ka njohur një rritje ekonomike prej 2.81 % (INSTAT 2015).

Dihet se shoqëria shqiptare përbëhet nga sisteme heterogjene të diferencimit shoqëror, të bazuara këto në identitete etnike, gjuhësore, fetare, familjare, fisnore, rajonale dhe socio-ekonomike. Kurse në Veri të Shqipërisë, aty ku gjakmarrja është më shumë e pranishme,

familjet dhe marrëdhëniet brenda familjes janë më të gjëra dhe ende shumë të forta. Struktura e fuqisë patriarkale ka tendencë të riprodhojë vetveten në të gjitha nivelet e shoqërisë. Detyrimet e gjakut janë shumë më të forta se çdo detyrim tjetër, pasi kërkojnë angazhim të thellë dhe përgjegjësi. Ndoshta kjo është një ndër arsytet më të forta se përse edhe në ditët e sotme fenomeni i gjakmarrjes vazhdon të jetë i pranishëm.

Marrja e gjakut në këtë komunitet nuk është një çështje individuale, të cilën një person e ndërmerr për vete ose për arsye të tjera personale apo emocionale. Prandaj mund të themi që kjo është më tepër një lloj garancie kolektive e ofruar nga grupi i të gjithë anëtarëve në të cilën ndodhet ky individ.

Gjakmarrja është një mjet për rivendosjen e simetrisë për një shkëmbim shoqëror, i cili është bërë i pabalancuar përmes një akti paraprak, atij të vrasjes së një personi. Nëse një anëtar mashkull i një grupi është vrarë, konsiderohet se është kryer një krim kundër të gjithë grupit si një i tërë. Kur kjo gjë ndodh, menjëherë një shenjë turpi zbret mbi grupin e dëmtuar, mbi familjen apo fisin. Pra, aty ku vrasja ka ndodhur, turpi mund të hiqet nga ata vetëm duke vrarë një anëtar të grupit ofendues (grupit që ka bërë vrasjen) dhe nuk ka rëndësi nëse është vrasësi i parë ai i cili vritet apo jo. Ajo që ka rëndësi është që ai duhet të jetë një individ në të njëjtën linjë gjaku me personin që ka bërë krimin herën e parë. Në këtë histori ka rëndësi të theksohet fakti se kjo vrasje apo linjë gjaku nuk përfshin dhe nuk ka të bëjë me femrat. Përkundrazi, nëse vritet një femër, gjaku i saj mund të blihet me para nga familja e vrasësit ose mund të falet. Një marrëdhënie hakmarrjeje kërkon që individët, familjet dhe fiset të shmangin çdo aluzion apo dobësi që ata mund të kenë, duke qenë se përshtypja dhe përmbajtja e tyre kanë po aq rëndësi sa realiteti dhe sepse sulmi simbolik dhe fizik është i

lidhur ngushtë me të gjithë ata. Vrasësit e mundshëm parësor e dinë që me vrasjen e dikujt tjetër, ata janë duke ekspozuar veten, familjen dhe fisin e tyre, ndaj kërcënimit të tmerrshëm të hakmarrjes ndaj grupit. Në këtë mënyrë, akti i vrasjes për motivin e gjakmarrjes mund të përfshijë breza për t'u mbyllur përfundimisht. Që në fëmijërinë e hershme, një anëtar i grupit i mësohet se gjaku nuk është falur dhe që nuk duhet të falet. Për shkak të gjakmarrjes, çdo burrë i familjes mund ta gjejë veten në listën e "*të dënuarve me vdekje*". Duke vrarë një person nga një familje tjetër, vrasësi e bën familjen e vet dhe fisin një objektiv ndaj vdekjes. Kështu, dy familjet e zgjeruara dhe në disa raste edhe dy fise mund të përfshihen në gjakmarrje.

Kultura e këtij komuniteti është një kulturë kolektiviste në të cilën individët pritet të sakrifikojnë veten e tyre për dinjitetin dhe nderin e grupit. Edhe aty ku një individ mund të mos dojë të vazhdojë një gjakmarrje, ai mund të përballë me turp të fortë social dhe presion për t'a bërë këtë. Në këtë komunitet falja konsiderohet si një dobësi ose tregues që familja nuk e ka pasur të rëndësishëm personin e vrarë në fillim. E gjithë shoqëria dhe komuniteti në këto zona nxisin dhe inkurajojnë marrjen e gjakut, edhe pse të gjithë e dinë që personi që do të marrë gjakun, mund të kalojë gjithë jetën e tij në burg për shkak të zbatimit të ligjeve në fuqi. Njerëz të ndryshëm të pyetur në qelitë e burgut pas marrjes së gjakut, janë përgjigjur se ndihen të çliruar nga gjithë ajo barrë që çdo gjë rreth tyre kishte vendosur mbi ta dhe tani, pasi kishin vendosur çdo gjë në vend, ata u shprehën se mund të flinin të qetë.

2.3.1. Gjakmarrja ndër vite

Prezenca e fenomenit të gjakmarrjes ndër shekuj dhe rezistenca që ky fenomen i ka bërë kohës janë mjaft shqetësuese. Statistikat që sjell historia, të dhënat etnografike, eksperiencat

e vizitoreve të huaj në vendin tonë deri në fillimet e shekullit XX tregojnë për përmasat e mëdha që kjo dukuri kishte në shoqërinë shqiptare, sidomos në zonat Veriore dhe Verilindore të Shqipërisë. Gjatë kohës së qeverisjes së mbretit Zog iu bë rezistencë ligjore këtij fenomeni dhe pati rezultate në krahasim me periudhen pararendëse, por sërisht situata mbeti problematike. Kushtetuta e re e vitit 1928 i dha Zogut fuqinë për të tri pushtetet: *legjislative, gjyqësor dhe ekzekutive*. Zbatimi i ligjit dhe i rendit shihej si një kusht paraprak themelor për progresin e shtetit, prandaj Zogu dekretoi me ligj *heqjen e gjakmarrjes* (Vickers, 2008, fq. 123). Kjo ndikoi në uljen e numrit të vrasjeve, por, megjithatë, rreth 46 % e 1652 vrasjeve në shkallë vendi në vitet 1930- 1938 janë kryer për gjakmarrje. Ndonëse numri i vrasjeve në përgjithësi dhe atyre për gjakmarrje në vitin 1938, krahasuar me vitin 1930, pati përkatësisht një rënie në masën 2,1 dhe 2,5 herë, përsëri vrasjet për gjakmarrje në fund të periudhës zogiste zinin 41 % të totalit të vrasjeve. Për t'u shënuar është fakti se 33% e vrasjeve për gjakmarrje të kryera në vitet 1930-1938 në shkallë vendi i përkisnin prefekturës së Shkodrës (Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, 2005). Në këtë drejtim, një kthesë pozitive filloi në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe u thellua më tej në vitet e pasluftës. Vetëm 291 raste vrasjesh për gjakmarrje janë regjistruar gjatë Luftës (Elezi, 2000). Duket sikur nevoja e përbashkët për t'u mbrojtur nga pushtuesi i të gjithë shqiptarëve i ka shtyrë ata të bëhen bashkë e ta vlerësojnë njëri-tjetrin më shumë se më parë. Në periudhën e komunizmit, pas luftës II Botërore, me fuqizimin e shtetit dhe miratimin e një sërë ligjeve, përfshirë këtu edhe ligjin e dënimit me vdekje dhe internimin e familjes së vrasësit në zona larg vendbanimit të mëparshëm, me ndryshimin e gjendjes social - ekonomike dhe kulturore e arsimore të popullsisë, me rritjen e kontrollit të vendit nga

institucionet shtetërore, statistikën e vrasjeve për shkak të gjakmarrjes me kalimin e kohës erdhën duke rënë. Me miratimin e Kushtetutës së re aplikimi i kodeve të Kanunit u konsiderua i paligjshëm dhe armiqësor. Propaganda kundër Kanunit ishte e ashpër dhe dënimet për këdo që do të qeverisej përmes tij ishin të rrepta. Të gjithë këta faktorë ndikuan në uljen e kushteve për të jetuar sipas rregullave kanunore dhe ushtrimin e gjakmarrjes. Duke iu referuar të dhënave statistikore në periudhën e viteve 1946-1950 vrasjet me motiv gjakmarrjen ishin 17 % të vrasjeve në vend, ndërsa në vitet 1951-1955 numri i vrasjeve për gjakmarrje u ul në 13,5 % ndërsa pas kësaj periudhe deri në vitin 1982 u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme. Nga viti 1982 – 1990 nuk pati asnjë vrasje me motiv gjakmarrjen. Nisur nga kjo shifër, u mendua se kjo dukuri i mbeti historisë apo së kaluarës, por fatkeqësisht, ky nuk ishte fundi i gjakmarrjes

Me rënien e komunizmit dhe për shkak të trazirave që e shoqëruan në atë kohë Shqipërinë, gjakmarrja u zgjua më e egër dhe më e deformuar se kurrë më parë. Madje, në këtë kohë u zgjuan edhe hasmëri të vjetra të dhjetëra e dhjetra viteve më parë. Tranzicioni, në vitet kur shqiptarët luftonin për demokraci, zgjoi tek një pjesë e njerëzve dëshirën për vetvendosje të rendit. Por liria për zhvillim u kuptua prej tyre si liri për veprime të gjithanshme, duke përfshirë edhe vendosjen e drejtësisë së munguar. Ata thirrën në ndihmë kujtesën dhe me dëshirën për të vendosur drejtësi edhe për paraardhësit e tyre që nuk ishin më, rifilluan marrjen e gjakut për ta. Është interesant fakti sesi ky komunitet, me këtë mentalitet, i shikon drejtuesit e grupeve të ndryshme fetare. Për një kohë ata ishin një referencë e fortë, pasi shiheshin si njerëz me pushtet, të cilët mund të bënin diçka për pajtimin e familjeve të ndryshme të përfshira në konflikt. Por në historinë e Shqipërisë kjo prirje u bë akoma më

interesante me ngjarjet e vitit 1967, ku lideri i asaj kohe Enver Hoxha e shpalli Shqipërinë si vendin e parë ateist në të gjithë botën edhe pse ndjekësit fetarë ekzistonin ende, veçse ishin të fshehur ndër banorë në të gjitha anët e vendit. Duke ndjekur heqjen e besimit në vitin 1967 urdhërat fetarë nuk kishin akoma forcë që të ndalonin rihapjen e gjakmarrjes, megjithëse suksesi ishte për shkak të forcës dhe elokuencës së personalitetit të liderit më tepër se çdo bindje fetare e pjesës dëgjuese. Kanuni kishte një peshë shumë më të madhe, sesa ligjet e Kishës (De Waal, 2007, fq.79).

2.3.2. Rigjallërimi i fenomenit të gjakmarrjes pas rënies së komunizmit

Me rënien e komunizmit dhe bashkë me të edhe të forcës kontrolluese të shtetit, me lirinë e papritur në të cilën u gjend shoqëria shqiptare, me tranzicionin nga shoqëri nën diktaturën komuniste në shoqëri demokratike, u krijuan kushtet për rizgjim të ndjenjës për gjakmarrje tek ato familje dhe individë që e kishin mbajtur të ndrydhur për vite me radhë vrasjen që i ishte shkaktuar njërit prej anëtarëve të familjes së tyre. Paradoksal ishte fakti që edhe pse vrasërit fillestarë nuk jetonin më, gjaku merrej në brezat pasardhës. Në kushtet e shoqërisë së lirë lulëzoi jo vetëm gjakmarrja e rregulluar me kanun, por edhe një ndjenjë vetë-gjyqësie për konfliktet e ndodhura më vonë, qoftë edhe për motive banale. Shoqëria shqiptare dhe aktorë të ndryshëm të saj siç janë organet shtetërore, mediat, organizatat dhe studiues shqiptarë dhe të huaj kanë vlerësuar problematikën e rritjes së fenomenit të gjakmarrjes pas rënies së komunizmit. Statistikat e ndryshme të familjeve të implikuara në situatë gjakmarrje si edhe shifrat e të vrarëve dhe vrasësve flasin qartë për përmasat që ka marrë ky fenomen. Në statistikat e nxjerra vihet re një ndryshim midis shifrave që japin organet shtetërore nga ato të organizatave joqeveritare, por edhe me këtë vështirësi ekzistenca e këtij fenomeni

është e pakundërshtueshme dhe e lehtë evidentueshme. Megjithë masat ligjore të marra për dënimin e vrasësve me motiv gjakmarrjen, apo me ndihmën që u jepet familjeve të prekuara, kjo plagë e shoqërisë nuk po njihet rënie. Është e nevojshme që të bëhen studime të thella sociologjike, psikologjike, etnologjike dhe kriminologjike, për të kuptuar më mirë dhe për të ndërtuar një strategji kombëtare jo vetëm në përballjen e fenomenit, por edhe për zhdukjen e tij.

Shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare në një intervistë të tij në vitin 2001, për revistën Ligji dhe Jeta, publikuar njëkohësisht edhe në portalin Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, lidhur me këtë çështje shprehet se:

“Gjakmarrja sot në Shqipëri, e ka shpjegimin si reaksion kundër ndalimit të rreptë me ligj që i bëri komunizmi dhe u muar si “zakon i mirë”, që duhet të ringjallet. Por është zakon që s’duhet të ringjallet. Kjo që po ndodh, s’ka të bëjë me kanunin shqiptar dhe është shumë barbare, kryhet me kallashnikov. Është një gjëmë e zezë, e trishtueshme dhe duhet të mbyllet se është turp për kombin shqiptar. Sot ngujimi i qindra grave dhe fëmijëve në shtëpi për shkak të gjakmarrjes është një gjë e tmerrshme, e pabesueshme. Ky është një kod juridik zakonor i vjetër, i lindur në rrethana të caktuara historike. Në mungesë të shtetit, është opinioni publik që merr rolin e tij ” (Kadare, 2001, Revista Ligji dhe Jeta).

Ndryshimet e mëdha socio - politike, ekonomike, dhe demografike në Shqipërinë e pas viteve ‘90, dobësimi i funksionimit të shtetit dhe i institucioneve ligjzbatuese në vend, heqja e ligjit për dënimin me vdekje, rritja e nivelit të krimit të organizuar, e të tjera, ishin elementë për krijimin e një atmosfere ku kanuni dhe gjakmarrja u rigjallëruan sërish edhe më fort se më parë. Keqkuptimi që populli shqiptar pati për konceptin e lirisë shkatërroi çdo kufi etik

të kuptimit të lirisë së vërtetë. Kjo 'liri' krijoi një atmosferë ideale që kanuni të lulëzonte. Shkaqeve për vrasjet për marrjen e gjakut të personave të vrarë para periudhës komuniste, iu shtuan tashmë edhe konfliktet që u krijuan për pasuritë e paluajtshme, ndarjen e pasurive dhe pronave të cilat iu kthyen pronarëve, por edhe konflikte të tjera morale familjare, siç ishin divorcet, rimartesat, apo edhe rrëmbimi i vajzave të reja për shfrytëzim prostitucioni, etj. Në vitin 2004, në të gjithë territorin e Shqipërisë janë regjistruar 184 familje, përkatësisht me 306 anëtarë gjithsej, prej të cilëve 27 fëmijë, që janë të prekur drejtpërdrejt nga fenomeni i gjakmarrjes. Vetëm në qarkun e Shkodrës gjatë vitit 2012, janë evidentuar 200 familje të prekura nga gjakmarrja dhe prej tyre 116 janë të ngujuara. Të gjitha statistikatat e mësipërme vijnë nga Policia e Shtetit dhe nga Zyra e Informacionit të Përpunimit Kriminal. Për herë të parë këto institucione dalin me një dokument zyrtar mbi gjendjen e gjakmarrjes dhe numrin e familjeve të prekura në vendin tonë. Sipas këtij dokumenti vetëm në Bashkinë e Shkodrës janë evidentuar 48 familje të prekura nga gjakmarrja me 116 anëtarë gjithsej, prej të cilëve 21 fëmijë që nuk kanë mundësi as të frekuentojnë shkollën për shkak të këtij fenomeni. Por ndërsa konsiderojmë statistikatat zyrtare është e rëndësishme të theksojmë se shifrat që vijnë nga Policia e Shtetit janë në kontraditë të plotë me statistikatat e organizatave të ndryshme që punojnë në terren me familjet e ngujuara. Sipas këtyre organizatave fenomeni i gjakmarrjes njih një shtrirje në pjesën më të madhe të vendit, por ka përqendrim më të lartë në zonat Veriore dhe Verilindore të Shqipërisë. Politikatat e dobta ekonomike dhe prania e një niveli të lartë varfërie janë faktorë për nxitjen e konflikteve të reja dhe rrjedhimisht shton rritjen e numrit të familjeve të prekura nga gjakmarrja. Që prej viteve '90 e deri më sot, qeverisjet e ndryshme të vendit tonë janë përpjekur të stabilizojnë treguesit makroekonomikë. Edhe pas

rënies së menjëherëshme të PBB në 1997, në nivelin e 1992, në vitet në vazhdim pati një rritje mesatare 6-8 % në vit. Edhe pse vihet re një rritje ekonomike reale, vlen të theksohet që ajo nuk ka shënjuar ndonjë ndikim të rëndësishëm në mirëqënien e popullatës së gjerë. Në vendin tonë ka një pabarazi të lartë të të ardhurave për frymë dhe ato janë ndër më të ultat në Europë. Varfëria vazhdon t'i shoqërojë familjet që migrojnë nga vendet e izoluara dhe pa infrastrukturë edhe në vendbanimet e reja. Mosmarrëveshjet mbi ndarjet e tokave bëhen nxitëse për raste vrasjesh dhe rrjedhimisht më vonë edhe shkak për gjakmarjen. Migrimi i popullsisë për në zonat pranë qyteteve me potencial më të lartë ekonomik dhe me mundësi më të larta për punësime, ka krijuar zona të mëdha informale me familje të paregjistruara, nën varfëri të plotë ekonomike. Të dhëna të ndryshme tregojnë se 70% e këtyre familjeve vazhdojnë të jetojnë në varfëri. Kjo jo vetëm për shkak të illegjimitetit të tyre që i penalizon ata për të patur akses në mbështetjen që ofrohet në kushte të tilla, por edhe për shkak të mungesës së një punësimi të rregullt, pasi një pjesë e mirë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e tregut për punësim. Gratë që u bënë pjesë e studimit tonë dhe familjet e tyre vijnë nga këto zona informale të krijuara në periferi të qytetit të Shkodrës dhe në periferi të Tiranës, në zonën e quajtur Bathore. Edhe pse fenomeni i gjakmarrjes me kalimin e viteve është duke njohur rënie, pasojat që sjell kjo dukuri janë shqetësuese. Kryesisht në shumicën e rasteve në vrasjet për gjakmarrje, gjaku merret mbi një njeri të pafajshëm, i cili është i lidhur përmes gjakut me vrasësin e parë. Dorasi mbetet gjallë dhe mbas kryerjes së dënimit vazhdon jetën i pacënuar. Por sipas Komitetit Mbarëkombëtar të Pajtimit të Gjakeve situata është alarmante. Sipas tyre në vitin 2012 numri i vrasjeve për gjakmarrje ka arritur në 152. Vrasjet e femrave në vitin 2012 janë 10 herë më të larta se mesatarja vjetore gjatë

viteve të tranzicionit. Nga 2-3 vrasje në vit, kjo shifër ka arritur në 25 në vitin 2012. Gjithashtu ata evidentojnë në Shqipëri 6500 persona të prekur nga gjakmarrja, prej të cilëve 129 fëmijë të prekur drejtëpërdrejt dhe të rrezikuar për jetën. Sipas shtypit: Në vitin 2011 janë bërë 139 vrasje dhe prej tyre 109 janë bërë për hakmarrje, nder dhe gjakmarrje. Në vitin 2012 janë bërë 67 vrasje për të njëjtat motive. Po sipas shtypit të përditshëm në 2011 janë evidentuar 1640 familje të prekura dhe në 2012 evidentohen rreth 1309 familje, duke e ulur kështu numrin e të prekurve me 20% nga viti në vit. E nëse kjo rënie do të vazhdonte me të njëjtat rritme edhe në vitet e tjera pasardhëse dhe gjithashtu nëse nuk do të shënoheshin raste të reja të gjakmarrjes, sot numri i familjeve që vuajnë fenomenin do të ishte zero (*Gazeta Shqiptare e datës 10.07.2012*).

Një tregues domethënës për egzistencën në masë të këtij fenomeni është edhe numri i madh i azilkërkuesve në vende të huaja. Që në vitin e parë që shqiptarëve iu dha mundësia e lëvizjes së lirë, numri i famijeve që nuk donin të ktheheshin më për shkak se i druhashin vdekjes ishte alarmues. Njihet fakti që një pjesë e tyre e përdorën dhe keqpërdorën këtë pretekst për të gjetur strehim në vendet ku shkuan, por gjithashtu, një pjesë tjetër kishin realisht kërcënim për jetën në Shqipëri. Standartet kushtetuese e demokratike të legjislationit të vendit tonë nuk e njohin kanunin, i cili ka pasur fuqi në kohën kur nuk ka pasur ligje. Në atë kohë ai ka patur rolin e tij rregullues dhe parandalues, kurse sot kemi një shtet të së drejtës kushtetuese, prandaj kanuni nuk mund t'i përgjigjet më kohës sonë.

Më poshtë kemi paraqitur në tabelë numrin e vrasjeve për gjakmarrje.

Viti	Nr i vrasjeve	Numri i vrasjeve për gjakmarrje	Përqindja
1998	573	45	7.8
1999	496	41	8.2
2000	275	41	14.9
2001	208	32	15.3
2003	132	12	9
2004	190	11	5.7
2005	131	5	3.8
2006	87	4	4.5
2007	103	0	0
2008	88	5	5.6
2009	82	1	1.2
2011	135	5	3.7
2012	100	5	5

Tabela 1. Vrasjet për gjakmarrje

Heqja e ligjit për dënimin me vdekje në Shqipëri duket sikur hapi dyert për shtimin e numrit të vrasjeve për gjakmarrje. Nga të dhëna të raportuara nga policia e shtetit për numrin e vrasjeve të ndodhura nga viti 1998 deri në 2012, vihet re se ka një rritje të numrit të vrasjeve për gjakmarrje nga viti 1998 deri në 2001. Pas kësaj periudhe, ka patur një luhatie të përqindjeve nga viti në vit. Ndërsa përsa i përket familjeve të ngujuara, të dhënat nga policia tregojnë se janë 67 familje të tilla:

- 48 familje në rrethin e Shkodrës;
- 13 familje në rrethin e Kukësit;
- 4 familje në rrethin e Lezhës;
- 1 familje në Tiranë;
- 1 familje në Durrës.

Njerëz të mbyllur në shtëpitë e tyre janë:

- 93 meshkuj në Shkodër, nga të cilët 21 fëmijë dhe 2 studentë;
- 16 njerëz në rrethin e Kukësit, nga të cilët 6 gra dhe 7 fëmijë;

- 4 meshkuj në Lezhë;
- Në Tiranë 1 person;
- Në Durrës 1 burrë, 1 grua dhe 3 fëmijë (Gazeta Shqiptare, 17 tetor 2012).

Ndërkohë që paraqiten këto të dhëna, duhet të mbahet parasysh se burime të ndryshme paraqesin të dhëna të ndryshme dhe sidomos kur krahason të dhënat zyrtare me ato të OJF-ve që operojnë në zonat dhe në terren ku këto familje jetojnë. Edhe Avokati i Popullit ka pasur një interesim të madh mbi fenomenin. Përmes disa të dhënave të publikuara prej kësaj zyre, numri i vrasjeve ka arritur deri në 152 në vitin 2012 dhe kanë qenë me përqendrim më të lartë në Veri dhe Verilindje të Shqipërisë. Të dhënat për vrasjet e vitit 2011 në bashkinë e Shkodrës tregojnë se vrasjet për motivet e gjakmarrjes zënë 57,8 % të të gjitha vrasjeve për këtë fenomen në të gjithë vendin. Gjithsej ndër vite, rreth 1450 fëmijë kanë qenë të detyruar të ndërpresin aktivitetin shkollor dhe të ngujohen për shkak të gjakmarrjes. Kjo dukuri evidentohet kryesisht në rajonin e Shkodrës, Lezhës, Kukësit dhe të Dibrës (Të dhënat e Zyrrave rajonale të SHSHS, 2003; SKZHES, 2004).

Sot, sipas Nenit 144-78:a të datës 02.05.2013 “*Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm*”. Në pamje të parë kjo duket të jetë një masë e efektshme nga ana legislative për ndalimin e një fenomeni të tillë, por që për shkak të moszbatueshmërisë së tij në mënyrën e duhur, nuk ka dhënë rezultatin e pritur. Familjet e dëmtuara kanë një mungesë të lartë besimi në organet shtetërore dhe për këtë arsye ata zgjedhin që të vetëvendosin drejtësinë. Nga një investigim i bërë së fundmi në gjykatën e rrethit në Shkodër, asnjë person që ka vrarë për gjakmarrje nuk ka marrë dënimin e parashikuar në ligj për këtë krim. Siç thamë edhe më sipër, ligji parashikon dënimin me së

paku 35 vite burgim deri në burgim të përjetshëm për personat që vrasin me paramendim për të larë gjakun e një personi të vrarë më parë nga familja e tyre. Mosfunksionimi i instancave të drejtësisë në mënyrën e duhur është një ndër shkaqet kryesore që e mban gjallë fenomenin e gjakmarrjes.

2.3.3. Gruaja në realitetin e gjakmarrjes

Nëse hedhim një vështrim në të kaluarën dhe në mënyrën sesi kanuni e trajton gruan, duket qartë se femra në përgjithësi ka qenë gjithmonë pjesa më e diskriminuar e shoqërisë, vlera e së cilës ishte mjaft e ulët. Ajo duhet të zbatonte gjithmonë urdhrat e burrit dhe të qëndronte e nënshtuar. Nuk kishte të drejtë të ndërhynte në vendimmarrje për çështje të ndryshme që mund të ndikonin edhe vetë jetën e saj. Në kanun ligjërohej e drejta që burri të ushtronte dhunë mbi të dhe shkonte deri aty, që në dy raste të veçanta burri të kishte të drejtën madje edhe ta vriste gruan (e drejtë kjo që babai i saj ia jepte burrit të saj në ditën e martesës). Kjo e drejtë simbolizohej nga një fishek që nusja merrte me vete në pajën e saj kur shkonte te shtëpia e burrit. Femra në tërësi konsiderohej si tepërcë në shtëpinë e saj dhe si shtesë në shtëpinë e burrit.

Që në lindje, kur mësohej që foshnja e sapolindur ishte femër, në shtëpi nuk kishte gëzim. Kur fëmija ishte mashkull lajmi përhapej me shpejtësi në të gjithë fshatin ose krahinën, madje e shtëna me armë në ajër kur vinte në jetë një fëmijë djalë, ishte pjesë e festës së madhe dhe e lajmërimit të së gjithë krahinës. Me kalimin e kohës, ndërsa fëmija rritej, diferenca në vlerësim ndaj dy gjinive rritej gjithnjë e më shumë. Edhe në ditët e sotme familjet që ruajnë me fanatizëm traditat e të parëve, mes tyre ruajnë edhe këtë zakon diskriminues ndaj femrës. Vajza nuk kishte *“tagër me zgjedh fatin e vet; do të shkonte me*

atë që e fejojnë mashkujt e shtëpisë” (Kanuni Libër i tretë, neni 12, tagri i djalit dhe vajzës), pra që nuk kishte të drejtë të merrte vendime thelbësore, si p.sh për fejesën apo martesën e saj, madje as për fejesën apo martesën e fëmijëve të saj. Kanuni i Lek Dukagjinit e cilëson gruan si *“Gja me bajt”*. Edhe nëse shohim në situata të rënda si gjakmarrja, që është edhe rasti mbi të cilin mbështetet studimi ynë, sipas ligjeve kanunore për gruan nuk merret gjak. Gruaja nuk bie në gjak dhe nuk çon gjak në shtëpi të vet (Kanuni, 1999).

Nga një intervistë e marrë për qëllim të këtij studimi nga njëri prej bajraktarëve të zonës së Tropojës, z. Sokol Delija, na tregon se nëse gruaja do të vritej për gjakmarrjen, atëherë as familja e prindërve të saj dhe as familja e burrit të saj nuk kanë të drejtë që të vrasin dikë nga familja armike. Për gruan nuk merret gjak, por jeta e saj mund të blihet kundrejt një shpërblimi material ose monetar që jepet nga familja që dëmton. Z. Delija shkon edhe me tej dhe na tregon që sipas kanunit dhe traditave dikur, nëse do të vritej një grua shtatëzanë, asaj do t’i hapej barku dhe nëse fëmija do të ishte djalë, shpagimi financiar do të ishte dyfishi i asaj që do të paguhej nëse fëmija do të ishte vajzë. Gruaja nuk vritet për gjakmarrje dhe nuk ka të drejtë të vrasë të tjerë për gjakmarrje apo të marrë gjakun për të dashurit e saj. Por z.Delija thotë se sot kanuni nuk respektohet më, por vetëm përdoret për interesa personale dhe janë duke vrarë gjithkënd. Njerëzit janë të papërfaqësuar si nga ligji i shtetit, ashtu edhe nga kanuni, prandaj situata është bërë një rrëmujë e madhe.

Luigj Mila, presidenti i shoqatës “Drejtësi dhe Paqe”, na jep nga prespektiva e tij edhe një arsye tjetër positive se pse kanuni e ndalonte të merrej gjak mbi gratë. Z. Mila thotë se kjo nuk bëhej sepse gjaku i gruas nuk ishte me vlerë, por sepse gruaja konsiderohej si mbartëse e jetës. Pra, ishte diçka shumë e rëndë të prekje këtë fabrikë të riprodhimit njerëzor.

Në një studim të bërë nga Insituti Shqiptar për Çështjet Publike mbi efektet e gjakmarrjes tek gratë dhe vajzat në Shqipëri, thuhet se me futjen e familjeve të këtyre grave në gjak, pra me izolimin e burrave të shtëpisë, shihen dy skenarë për gruan:

Skenari i parë është që gruaja, burri i së cilës është i detyruar të jetojë i ngujuar, fillon të ngarkohet me të gjitha detyrimet që nga ana kulturore dhe tradicionale i takojnë burrit, që në momentin e parë që ngujohen. Pra, prej saj pritet që ajo të kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë jashtë mureve të shtëpisë edhe pse disa prej tyre i takojnë rolit të bashkëshortit të saj. Nga ana tjetër, edhe pse prezente fizikisht në të gjitha këto përgjegjësi, gruaja e ka nënshtruar veten e saj dhe vendimarrjen poshtë burrit. Kjo do të thotë që edhe pse është fizikisht e lirë, ajo nuk është e tillë në vendimarrje.

Nëse deri më momentin para ngujimit të familjes së saj, gruaja ka qënë ajo që ka zbatuar urdhrat e bashkëshortit, ka bërë punët e shtëpisë dhe vetëm është kujdesur për fëmijët, në momentin e ngujimit është ajo e cila duhet të dalë të punojë dhe të sigurojë jetesën për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes së saj, por njëkohësisht të bindet vendimeve të burrit të saj. Ato përjetojnë dhe vuajnë në heshtje shpesh herë dhimbjen e humbjes së babait të tyre, bashkëshortit, vëllait, djalit etj, për shkak të gjakmarrjes. E kaluara e tyre nuk është i vetmi shkak për dhimbjen e tyre, ato janë të mbushura me ankth e pasiguri për të ardhmen; kush nga të afërmit e saj do të jetë viktimë e rradhës?

Realiteti i këtyre grave është i ngarkuar me emocione negative, që shkaktohen nga dhuna psikologjike e fizike që ushtrohet mbi to nga burri dhe nga djemtë e tyre të ngujuar. Situata e burgosjes brenda mureve të shtëpisë, pafuqia për të ndryshuar realitetin e varfërisë që i kaplon këto familje, i shtyn burrat të bëhen të varur nga alkoli dhe të bien në depression të

plotë. Shpesh gratë janë nën presionin e dhunës mashkullore, jo vetëm psikologjike por edhe atë fizike, dhunë të cilën në shumicën e rasteve as ato vetë nuk e konsiderojnë si një problem, madje e justifikojnë, që për shkak të ngujimit bashkëshortët dhe djemtë e tyre kanë “stres”, duke qenë se në fund të fundit janë jetët e tyre që rrezikohen së pari në situatën e gjakmarrjes dhe se ato nuk kanë kohë të mendojnë për veten e tyre, pasi kanë një familje për të mbajtur e për të ruajtur.

Të gjendura nën një presion të tillë të vazhdueshëm, këto gra janë të prirura dhe të cënuara nga çrregullime të ndryshme psikologjike dhe sidomos nga çrregullimet e stresit.

Edhe pse çrregullimet e stresit kanë ekzistuar shumë vite më parë, ato u bënë të njohura për herë të parë në DSM-në e vitit 1980, kur American Psychiatric Association i prezantoi ato. Që prej shtatorit të vitit 2001 një ndërgjegjësim i ri u ngrit në të gjithë botën. Për shkak të sulmeve terroriste të ndodhura papritur dhe në përmasa tragjike të paimagjinueshme, njerëzit nuk kanë më sigurinë si më përpara. Edhe eksperiencia e fluturimit dhe udhëtimit me avion për shumë njerëz që prej asaj kohe ka ndryshuar. Terma të tillë si terrorizëm apo frikë ndaj ngjarjeve të papritura vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të jenë çështje kryesore në ekranet dhe në diskutimet e përditshme të njerëzve. Me ndryshimin e kaq shumë situatave edhe kërkimet për etiologjinë, nozologjinë dhe trajtimin e ÇSPT janë rritur drastikisht që prej vitit 2001.

2.4. Çfarë është çrregullimi i stresit post traumatik

ÇSPT është një çrregullim i ankthit i paraprirë nga një ngjarje traumatike, gjatë së cilës jeta e një individi apo e personave të tjerë të afërm të tij është vënë në një rrezik real. Ngjarja traumatike mund të jetë: një situatë e vështirë, luftë, tërmet, dhunë, abuzim, aksident, etj, në të cilën personi ndihet i pafuqishëm për të bërë diçka (APA, 2000:467).

Edicioni i pestë i DSM-së e ka lëvizur çrregullimin e stresit post traumatik nga kapitulli i çrregullimeve të ankthit në një grup të ri të “çrregullimeve që lidhen me traumën dhe stresorët” (American Psychiatric Association, 2013). Ky rishikim ka sjellë në fokus konsideratat që lidhen me shprehjet e stresit si rezultat i eksperiencave traumatike. Këto konsiderata janë të rëndësishme pasi statusi nozologjik i ÇSPT ka aplikime të rëndësishme për vlerësimin dhe menaxhimin klinik të pacientëve me këtë çrregullim (Andreasen, 2010 dhe Kilpatrick, 2013).

Personi i ndodhur në një situatë të vështirë ose përballë një ngjarje traumatike ndihet i pafuqishëm dhe i paralizuar për të përballuar situatën. Kjo situatë e vë individin përballë limitit të potencialit të vet dhe shpesh është shumë më e madhe se kapaciteti i tij për përballim, për zgjidhje apo për ndryshim. Për rrjedhojë për shkak të pafuqisë së tij për të ndryshuar diçka, individi mbushet plot me ndjenja faji. Kështu mund të ndihet një person që në një tërmet, luftë, apo ngjarje të tjera, ka humbur një person të dashur ose është dëmtuar edhe vetë fizikisht; kështu mund të ndihet një femër që ka rënë pre e një grupi abuzuesish seksual; kështu mund të ndihet edhe një fëmijë në një skenë të ashpër dhune mes prindërve. Kur je në rrezik është e natyrshme të kesh frikë. Gjendja e frikës normalisht prodhon disa ndryshime në organizëm në një kohë shumë të shpejtë (edhe në disa të qindat e sekondës), dhe në këtë mënyrë e përgatit personin për t’u mbrojtur nga rreziku dhe për ta evituar atë ngjarje apo përjetimin e saj. Ky reagim quhet “*sulmo ose vrapo*” dhe është një reagim i shëndetshëm që mbron personin nga një rrezik i mundshëm. Në çrregullimin e stresit post traumatik ky reagim është dëmtuar dhe personi ndihet gati i paralizuar dhe i tmerruar para një situatë të tillë të rrezikshme. Kjo gjë e kthen këtë eksperiencë në një traumë

për të. Njerëzit të cilët janë të ekspozuar ndaj një ngjarje traumatike apo ndaj një stresori, janë përballë një rreziku më të lartë ndaj ÇSPT dhe gjithashtu edhe ndaj depresionit, çrregullimit të panikut, çrregullimit të ankthit të përgjithësuar, abuzimit të substancave psikoaktive, në krahasim me ata të cilët nuk kanë përjetuar ngjarje traumatike (Kessler, 1995). Ata mund të kenë gjithashtu simptoma somatike dhe sëmundje fizike, veçanërisht hypertension, asma dhe sindroma të dhimbjes kronike (Zatzick, 1997).

2.5. Tiparet dalluese të çrregullimit të stresit post traumatik

Përgjithësisht për t'u dhënë një diagnosë e ÇSPT, një person duhet që së pari të ketë qënë i ekspozuar ndaj një stresori ekstrem ose ngjarje traumatike, ndaj së cilës personi përgjigjet me frikë, pafuqi dhe terror e duhet të ketë tri tipe dalluese të simptomave që konsistojnë në:

1. Ripërjetimin e ngjarjes.
2. Shmangjen e kujtuesve qofshin ato vende apo mendime rreth ngjarjes.
3. Hipervigjilencë për të paktën një muaj që nga koha që ka ndodhur ngjarja (APA, 1994).

Ripërjetimi i ngjarjes i referohet kujtimeve të hidhura të incidentit në formën e pamjeve stresuese, makth, ose flash-backs. Flashbackët, apo thënë ndryshe ripërjetimi i traumës, shpesh herë shoqërohen edhe me simptomat fizike si rrahje zemre të shpeshta dhe të forta, dridhje, djersitje, etj. Gjithashtu simptoma të tjera në ripërjetimin e ngjarjes janë ëndrra të këqija, tmerret e natës apo situata të ngjashme, mendime të frikshme, etj. Simptomat e ripërjetimit mund të shkaktojnë probleme në jetën e përditshme. Ato mund të nxiten nga mendime apo nga ndjenja, fjalë, objekte apo situata që kujtojnë ngjarjen dhe nxisin ripërjetimin e traumës (Ronald M. & Frank N. Shiromoto, 2010).

Simptomat e shmangjes ose evitimit konsistojnë në përpjekjen që bën individi për të shmangur çdo gjë që i kujton dhe është e lidhur me ngjarjen traumatike. Simptomat e evitimit mund të renditen si më poshtë:

- * Të qëndruarit larg nga vendet, ngjarjet dhe njerëzit që kujtojnë traumën.
- * Shkëputja emotive: pandjeshmëria, izolimi emocional, etj.
- * Ndjenja të forta faji, depresion, preokupim i tejskajshëm, etj.
- * Humbje të interesit për aktivitete që personit i kanë dhënë kënaqësi më parë.
- * Vështirësi për të kujtuar ngjarjen traumatike (Pango, 2004, fq.19).

Shumë situata që e çojnë personin të kujtojë ngjarjen traumatike nxisin evitimin. Kështu individi fillon të modifikojë jetën e përditshme: p.sh, pas një aksidenti të hidhur personi mund të evitojë të ngasë përsëri makinën apo edhe të udhëtojë me makinë. *Simptomat e hipervigjilencës* i referohen manifestimeve psikologjike si: pagjumësia, nervozizëm, mungesë përqëndrimi, trembje e lehtë, shpërthime inati, hipervigjilencë dhe reagime të befasishme. Simptomat e hipervigjilences janë konstante edhe pse nuk janë të lidhura direkt me ngjarjen traumatike (North, Nixon, Shariat, 1999).

Këto simptoma e bëjnë të vështirë dhe ndërhyjnë në jetën e përditshme të individit që i përjeton ato. Ndërhyrjet janë si në fjetjen, të ushqyerit, përqendrimin, etj. Prania e këtyre simptomave pas ngjarjes traumatike është e kuptueshme. Ndonjëherë personat kanë simptoma edhe më të rënda të cilat zhduken vetë pas disa javësh. Në këto raste kemi të bëjmë me çrregullimin akut ndaj stresit, por kur simptomat zgjasin me shumë se dy javë mund të flasim për çrregullimin e stresit post traumatik. Disa persona me këtë çrregullim psikologjik

nuk demostrojnë asnjë simptomë për javë ose një muaj, por pas një kohe më të gjatë. Brenda një muaji pas eksperiencës traumatike, personi që e përjeton mund të ketë simptomat e çrregullimit të stresit akut. Edhe pse çrregullimi i stresit akut jo domosdoshmërisht ndiqet nga ÇSPT, ai shoqërohet me një rrezik në rritje të tij (Harvey & Bryant, 1998).

2.6. Kush vuan nga ky çrregullim

ÇSPT mund të prekë çdo person pa dallim moshe, gjinie, statusi social, race apo kombësie. Siç përmendëm edhe më sipër mund të preken veteranët e luftës, të mbijetuarit nga sulmet fizike dhe seksuale, abuzimet, aksidentet, fatkeqësitë natyrore, ngjarje të rënda dhune, etj. Edhe pse jo të gjithë personat me ÇSPT mund të kenë qenë protagonistë të një ngjarje traumatike, ata vetë kanë qenë dëshmitarë të një ngjarje të tillë të rrezikshme. Disa prej tyre madje preken nga çrregullimi i stresit post traumatik pasi kanë asistuar në një ngjarje që ka dëmtuar apo vënë në rrezik një mik apo një familjar. Edhe vdekja e papritur e një personi të dashur mund të shkaktojë ÇSPT. Fëmijët gjithashtu mund të vuajnë nga ky çrregullim. Ata reagojnë ndryshe nga të rriturit. Tek fëmijët shumë të vegjël simptomat mund shoqërohen me urinim në shtrat edhe pse më parë kanë mësuar të shkojnë në banjë, ndalojnë së foluri, ngjiten pas prindit apo mbas një të rrituri tjetër. Ata gjithashtu ripërjetojnë dhe riprodhojnë traumën në momente të ndryshme gjatë aktiviteteteve dhe lojrave me fëmijët e tjerë (lojë, vizatim, etj).

Adoleshentët zakonisht shfaqin simptomat që i demostrojnë edhe të rriturit. Ata mund të zhvillojnë edhe sjellje shkatërruese apo thyerje rregullash, agresivitet si dhe sjellje ose ndjenja hakmarrëse. Është e rëndësishme të kujtojmë se jo të gjithë personat që përjetojnë një ngjarje të rrezikshme e zhvillojnë këtë çrregullim. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e

personave nuk e zhvillojnë këtë çrregullim (jo të gjithë veteranët e luftës psh zhvillojnë ÇSPT). Në studime të mëparshme është vërtetuar se persona të ndryshëm të ekspozuar ndaj së njëjtës ngjarje traumatike kanë reagime krejtësisht të ndryshme. Jo vetëm në gjini, moshë, apo kombësi, por madje edhe në kultura të ndryshme reagimi ndaj traumës dhe mundësitë e zhvillimit të ÇSPT janë të ndryshme.

Janë shumë faktorë që luajnë një rol të rëndësishëm në gjenezën e këtij çrregullimi. Disa janë faktorë rreziku që e bëjnë personin vulnerabël ndaj ÇSPT. Faktorët e rezilences mundet të zvogëlojnë shfaqjen e çrregullimit. Gjithashtu shfaqja e këtij çrregullimi varet edhe nga historiku që një individ ka pasur më parë. Është e rëndësishme e shkuara e individit në mënyrën sesi ka reaguar në traumat e tjera, nëse ka pasur të tilla. Kjo do të ndikojë edhe mënyrën sesi ky person do të reagojë ndaj traumës pasardhëse.

2.7. ÇSPT dhe ndryshimet gjinore

Gratë ndryshojnë nga burrat në zhvillimin e çrregullimit të stresit post traumatik pasi edhe tipet e ngjarjeve traumatike ndaj të cilave ata janë të ekspozuar janë të ndryshme (Breslau, Kessler & Chilcoat, 1998). Vëzhgimet ndërkombëtare dhe modelet statistikore që parashikojnë rastet e ÇSPT thonë se gratë kanë më shumë gjasa se burrat që të përjetojnë ÇSPT. Disa ekspertë shkojnë më tej dhe sugjerojnë se femrat janë dy herë më shumë të predispozura sesa burrat për ta zhvilluar gjendjen e çrregullimit të stresit postraumatik, pavarësisht se burrat janë më të ekspozuar ndaj traumave më të mëdha (Adamson, 2008; Breslau, 1998). Kjo mund të jetë për faktin se shumë gra i përjetojnë ndryshe traumat. Frika e kushtëzuar është cilësuar si procesi thelbësor në zhvillimin e çrregullimit të stresit post traumatik (Orr, 2000; Pitman, 2000). Një vëzhgim tjetër ka konstatuar se pothuajse gjysma

e grave presin të përjetojnë një traumë serioze gjatë jetës së tyre. Meqë ÇSPT është një produkt i traumave të përjetuara, studiuesit kërkuar lidhjen mes gjinisë dhe zhvillimit të ÇSPT.

Në Amerikë prevalenca e ekspozimit ndaj traumës është mbi 50% si për gratë ashtu edhe për burrat. Në fakt meshkujt janë më të prirur të përjetojnë trauma. 61% e meshkujve jetojnë një ngjarje traumatike, ndërsa nga gratë vetëm 51% e tyre përjetojnë një ngjarje të tillë gjatë gjithë jetës së tyre (Perkonigg, 2000). Fatmirësisht vetëm 8.1% e burrave dhe 20.4% e grave të cilët përjetuan një traumë progresuan në zhvillimin e çrregullimit të stresit post traumatik (Kessler, 1995). E gjithë kjo thekson faktin që përjetimi i traumave nuk do të thotë domosdoshmërisht që individi do të përjetojë një çrregullim si përgjigje ndaj traumës. Një studim mbi gratë e përdhunara zbuloi se 31% e viktimave të përdhunimit zhvillojnë çrregullimin e stresit post traumatik (Kilpatrick, Edmunds & Seymour, 1992). Përqindja e shfaqjes së depresionit dhe ankthit rritet në 3-4 herë tek femrat e ekspozuara ndaj dhunës krahasuar kjo me ato që nuk janë të ekspozuara (Mullen, 1998; Saunders, 1992).

Studime të tjera të kohëve të fundit mbi gjendjen e shëndetit mendor dhe mbi prespektivat e çrregullimit të stresit post traumatik kanë parë që dallimet gjinore mund të luajnë një rol në faktin se kush është më vulnerabël ndaj zhvillimit të këtij çrregullimi. Një nga arsyet për ndryshimet gjinore të ÇSPT është fakti se si burrat dhe gratë mësojnë përgjigjen përmes frikës ndaj një ngjarje traumatike. Pas një studimi eksperimental të bërë në kushte laboratorike është zbuluar se gratë e mësojnë këtë përgjigje më fortë dhe më shpejt sesa burrat (Journal of Psychiatric Research, 2012). Ndryshimet në të mësuarin e frikës mund të jetë një nga mekanizmat më të rëndësishëm në zhvillimin e çrregullimit të stresit post

traumatik. Kushtet e një frike më të lartë tek gratë mund të reflektojnë një vulnerabilitet paraegzistues ose prezencë dhe përjetime traumash në të shkuarën (Inslicht S., 2012). Pra edhe mënyra e përgjigjes ndaj traumës varet në mënyrë të pashmangshme nga historiku i mëparshëm që një individ mund të ketë pasur me trauma të tjera në të shkuarën. Ky mund të jetë një ndër faktorët që shpjegon pse gratë janë shumë më të predispozura për të zhvilluar ÇSPT pas traumës. Një pritje më e madhe e të pasurit një përgjigje të kushtëzuar nga frika mund të shpjegojë reaktivitetin këmbëngulës emocional dhe psikologjik ndaj sinjaleve, që është karakteristikë e çrregullimit të stresit post traumatik (Pitman, 1989; Pitman, 2000).

Më tej një hulumtim i Universitetit Emory (2014), sugjeron që tendenca për zhvillimin e PTSD mund të ketë edhe lidhje gjenetike. Gjithashtu prezenca shumë e lartë e PACAP e evidentuar kryesisht tek gratë që shfaqnin simptoma të çrregullimit të stresit post traumatik gjatë studimit, mund të ndihmojë në shpjegimin e ndjeshmërisë së femrës ndaj këtij çrregullimi. Aktivizimi i PACAP mund të jetë përgjegjës për nënshtrimin e gruas ndaj ÇSPT më shpesh sesa meshkujt (McKenzie, 2014). Strukturat e trurit të përfshira në frikën e kushtëzuar dhe PTSD janë të përfaqësuara në dy forma të dallueshme (seksualisht dimorfe ose të dytrajtëshme) dhe përmbajnë receptorë specifik për steroidet siç është estrogjeni (Goldstein, 2001). Gjithashtu estradioli që është perkursor i estrogjenit në femra gjatë viteve të riprodhimit, është gjetur të modelojë frikën dhe shtrirjen e të mësuarit në kafshë si dhe në studimet me njerëz (Chang, 2009; Milad, 2006; 2009; Zeidan, 2011). Edhe pse jo gjithmonë (Gupta, 2001) estradioli është gjetur të jetë i lidhur me rritjen e reagimit të kapsllitjes së syve (Leuner, 2004), frikën e kushtëzuar, kushtëzimin kontekstual (Jasnow, 2006) dhe konsolidimin e shtrirjes së memories dhe mësimit (Milad, 2010; 2011).

Një tjetër arsye se përse gratë janë më të lidhura me zhvillimin e ÇSPT është “make-up” i tyre emocional. Gratë përgjithësisht njihen si më të prirurat për çrregullimet e ankthit dhe të depresionit. Ndryshe nga burrat, gratë priren të marrin përgjegjësi personale për statusin e tyre të viktimës. Këto tendenca mund ta bëjnë më të vështirë për to shmangien e kalimit përmes përgjigjeve të tjera emocionale të çrregullimeve ndaj traumës. Nga ana tjetër, gratë janë më të hapura ndaj ndjenjave të tyre krahasuar me burrat. Përveç kësaj, ato janë më të gatshme të kërkojnë ndihmë kur kuptojnë që kanë luftë emocionale. Gratë gjithashtu arrijnë të krijojnë më mirë grupe mbështetëse për t’i ndihmuar ato në mbajtjen e rimëkëmbjes që terapia iu dha atyre. Kështu, ndërsa gratë janë më vulnerabël ndaj zhvillimit të ÇSPT, ato janë gjithashtu më të prirura në kërkimin e ndihmës dhe në mbajtjen e shërimit.

2.8. ÇSPT dhe faktorët e riskut

Në vitet e fundit janë identifikuar disa faktorë risku për ekspozimin ndaj traumës dhe për zhvillimin më pas të çrregullimit të stresit post traumatik.

1. Gjinia - Si faktor i grupit të parë është identifikuar gjinia. Edhe pse burrat janë më shumë të ekspozuar ndaj ngjarjeve traumatike sesa gratë (Kessler, 1995), ata ndryshojnë pasi tipet e ngjarjeve traumatike ndaj të cilave janë të ekspozuar janë të ndryshme (Breslau, Kessler, Chilcoat, 1998). Burrat kanë më shumë tendencë të jenë të ekspozuar ndaj luftrave dhe dhunës fizike, ndërsa gratë janë më të ekspozuara ndaj dhunës seksuale, emocionale dhe psikologjike. Ndryshimet e ekspozimit ndaj traumave mes burrave dhe grave mund të ndikojë konsideratat për trajtim.

2. Mosha – Ekspozimi ndaj traumës dhe rrjedhimisht ekspozimi ndaj ÇSPT mund t'i ndodhë çdo individ të çdo moshe. Mënyra e shfaqjes së simptomave është e ndryshme për mosha të ndryshme. Asnjë moshë e caktuar nuk ka imunitet ndaj çrregullimit të stresit post traumatik.
3. Historia e traumës së mëparshme – Ekspozimi ndaj traumës së mëparshme mund të modifikojë vulnerabilitetin ndaj traumës pasuese, të influencojë në zhvillimin e ÇSPT dhe mund të komplikojë trajtimin dhe restaurimin pasues (Ballenger, Davidson & Lecrubier, 2000; Breslau & Chilcoat, 1999). Fakti që një person është ekspozuar ndaj traumave të tjera paraardhëse ka bërë që brenda tij të jenë formuar disa filtra dhe disa faktorë psikologjik. Kjo mund ta ndikojë atë pozitivisht ose negativisht për traumën pasardhëse, kjo në varësi të adaptimit dhe të mënyrës së përballimit të saj.
4. Sjellje agresive – Është vënë re se disa persona me ÇSPT kanë probleme me sjellje agresive të cilat janë frekvente, impulsive dhe episodike (Ursano, 2004). Studime të tjera kanë dokumentuar një rritje të dhunës brenda familjes, abuzimin e fëmijëve, dhe delikuenca pas ngjarjes (Curtis, Miller & Berry, 2000).
5. Sjellje vetëdëmtuese – Përgjigja ndaj ekspozimit të traumës mund të përfshijë edhe sjellje vetëdëmtuese që renditen nga vetëgjymtimi e deri tek çrregullimi i të ngrënit apo abuzim me substanca dëmtuese (Ursano, 2004). Në fakt, ÇSPT ka demonstruar shoqërizimin më të fortë me sjelljet vetëvrasëse se çdo çrregullim tjetër (Kessler, 2000).

2.9. ÇSPT dhe shëndeti fizik

Ekspozimi ndaj incidenteve traumatike ka treguar të ketë efekte negative në shëndetin dhe mirëqënien e personave të përfshirë. Modelet teorike parashtrojnë se ÇSPT përfaqëson një mekanizëm kyç që lidh shfaqjen e traumës. Në një meta-analizë të fundit të kryer nga Pacella

(2013) është gjetur një shoqërizim dhe lidhje e fortë mes ÇSPT dhe shëndetit të dobët të përgjithshëm. Duke pasur ÇSPT apo nivele të larta të simptomave të këtij çrregullimi është gjetur të ketë një lidhje të fortë me pasojat negative shëndetësore fizike, duke përfshirë edhe rrezik më të madh për kushte mjekësore dhe një cilësi jete që lidhet me shëndetin, të reduktuar, me efektin më të madh të vëzhguar për simptomat e shëndetit të përgjithshëm. Lauterbach ka gjetur se individët me ÇSPT në krahasim me ata që nuk e kanë këtë çrregullim e vlerësuan shëndetin e tyre më dobët dhe më keq, raportuan më shumë stres ambiental dhe ishin më të prirur të raportonin të paktën një gjendje shëndetësore fizike jo të mirë (Lauterbach, 2005). Edhe pse ÇSPT është një shqetësim domethënës në popullatën e përgjithshme, në shëndetin e dobët mendor, dhe dukshëm në prevalencën e ÇSPT, ky çrregullim është një shqetësim serioz dhe në rritje në disa grupe të veçanta.

Prezenca edhe e çrregullimeve të tjera si depresioni ose ankthi mund të rezultojë në pranimë e më shumë simptomave fizike. Problemet fizike dhe sëmundjet mendore mund të bashkëndodhin në mënyra dhe forma të ndryshme. Ndodh që mjekimi që përdoret për sëmundje të ndryshme fizike mund të ketë efekte anësore dhe të çojë në probleme mendore. Depresioni psh. mund të jetë efekt anësor i disa ilaçeve. Gjithashtu problemet shëndetësore dhe ato mendore mund të kenë një shkak të përbashkët siç është stresi. Prezenca e të dyjave shkakton një ndjesi humbje tek individit dhe e bën atë të ndihet sikur jeta nuk është njësoj siç ishte para se të sëmurej. Këto probleme mund të ndryshojnë cilësinë e jetës dhe në këtë mënyrë të shtojnë masën e stresit. Ato gjithashtu mund të rrisin intensitetin e simptomave të ÇSPT. Problemet mendore mund të shkaktojnë probleme me shëndetin fizik dhe e kundërta. Kur një person ka probleme fizike dhe mendore, kjo gjendje e bën atë të pafuqishëm të

përdorë faktorët mbrojtës të përballimit. Kjo gjë mund të ketë impakt në çdo fushë të jetës. Mund të ndryshojë vetëvlerësimin, mënyrën se si ndihesh dhe mendon për vetveten dhe marrëdhëniet me të tjerët. Prek aftësinë e punës dhe të shijuarin e jetës. Por jo në çdo rast dhe jo gjithmonë çrregullimet mendore lidhen me sëmundjet fizike. Nëse dikush vuan nga ÇSPT dhe në të njëjtën kohë është edhe i sëmurë, kjo nuk do të thotë që çrregullimi i stresit është gjithmonë përgjegjës për sëmundjen fizike.

KAPITULLI III

METODOLOGJIA

Kjo pjesë e këtij studimi do të trajtojë këto çështje: do të shpjegojë qëllimin dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e kërkimit, metodologjia e përdorur për studim, popullata e përfshirë në studim dhe përzgjedhja e kampionit, instrumentet matëse, procedurat e kërkimit dhe mbledhja e të dhënave, analiza statistikore për përpunimin e të dhënave, çështje etike të kërkimit si dhe kufizimet e tij. Të gjitha këto elemente shtjellohen në mënyrë të detajuar dhe në tërësi formojnë kornizën metodologjike të këtij punimi doktoral.

3.1. Qëllimi i studimit dhe objektivat

Qëllimi i këtij punimi është të studiojë gratë e familjeve të ngujuara nga Veriu i Shqipërisë, të vlerësojë problemet sociale e psikologjike me të cilat ato përballen çdo ditë dhe të sugjerojë rrugë e mënyra për kapërcimin e tyre.

Objektivat

Realizimi i qëllimit të mësipërm do të bëhet i mundur vetëm nëse realizohen konkretisht objektivat që i kemi venë vetes në fillim të punës sonë. Këto objektiva janë si më poshtë:

- Të analizohet konkretisht situata sociale dhe psikologjike në familjet e grave të ngujuara, kushtet e jetesës së tyre si dhe marrëdhëniet brenda familjes ku ato jetojnë.

- Të bëhet një vlerësim i detajuar i fenomenit të gjakmarrjes, duke e parë atë historikisht nga zanafilla deri në kohët e sotme, për të evidentuar qartë faktorët që ndikojnë në mbajtjen gjallë të fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.
- Të sigurohet njohja nga afër e subjekteve që vuajnë pasojat e gjakmarrjes, duke kryer vizita në familjet e tyre, duke vëzhguar, biseduar e intervistuar ato.
- Të evidentohen qartë fushat në të cilat ky grup social ka më shumë nevojë për ndihmë për të sensibilizuar e bërë të njohur nevojat e tyre në organet e pushtetit, në shoqëri civile e të tjera.
- Përmes instrumentave që do të përdorim do të shikojmë nëse gjakmarrja e përjetimi i ngjarjeve traumatike ka efekte në shëndetin mendor të këtyre grave dhe si mund të ndihmohen ato.
- Të sigurohen të dhëna përmes instrumenteve matës, nëse këto gra shfaqin simptoma të ÇSPT (Çrregullim i Stresit Post Traumatik) dhe në çfarë nivel janë ato.
- Do të formulohen sugjerime e rekomandime të nevojshme, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në reduktimin apo në zgjidhjen e rasteve të familjeve që janë në hasmëri dhe gjakmarrje.

Duke qenë se zgjedhja e kësaj teme për punim doktoral nuk ka qenë e rastësishme, por në gjykimin tonë mjaft e rëndësishme, synimi përfundimtar lidhet me pritshmëritë e mia si studiuese, që një ditë, të mund të flitet për gjakmarrjen si një fenomen i hidhur i së shkuarës së vendit tonë, që është vetëm pjesë e historisë e që nuk do të jetë më e pranishme në të ardhmen jo të largët të këtij vendi.

3.2. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Studimi ynë do të përpiqet që t'u japë përgjigje dy pyetjeve kryesore kërkimore prej të cilave do të orientohet e drejtohet edhe hulumtimi ynë:

Pyetja 1. *Si ndikon aktualisht fenomeni i gjakmarrjes në aspektet themelore të jetës sociale të grave të ngjuara?*

Disa prej aspekteve që ne do të masim gjatë kryerjes së studimit janë: gjendja financiare, punësimi, niveli i arsimit, marrëdhëniet e tyre brenda familjes, marrëdhëniet e tyre si qenie sociale me mjedisin rrethues e të tjera.

Pyetja 2. *Si ndikon aktualisht gjakmarrja në gjendjen psikologjike të grave të ngjuara?*

Dihet se gratë e ngjuara bëjnë një jetë të stresuar, prandaj për këtë arsye, në kërkimin tonë përdorim një instrument për të parë a ka prani të simptomave të Çrregullimit të stresit post-traumatik dhe cili është niveli i tyre tek kjo kategori e grave.

Në fakt, rrethi i pyetjeve për këtë temë është shumë i gjerë, prandaj në punim do të gjejmë përgjigje edhe për një varg çështjesh të tjera, të cilat zbërthejnë dy pyetjet kryesore që u prezantuan më sipër. Si çështje të tilla të shprehura në formë pyejesh janë:

- Cila është gjendja sociale dhe situata reale e grave të ngjuara në Shqipëri; si janë marrëdhëniet e tyre si qenie sociale me mjedisin rrethues;
- si ndikon fenomeni i gjakmarrjes në gjendjen e tyre psikologjike;
- cilat janë pritshmëritë e vetë grave për të ardhmen e tyre si dhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre;

- sa të identifikuara janë këto gra dhe familjet e tyre nga organet qeverisëse vendore e qendrore dhe sa ndihmohen prej tyre;
- cila është situata e gjakmarrjes sot në Shqipëri; a është ky fenomen i njëjtë me gjakmarrjen e vendosur me kanunin e Lekë Dukagjinit;
- a është mjaftueshëm e ndërgjegjësuar shoqëria shqiptare për pasojat dhe problematikat që sjell ky fenomen, në veçanti për vështirësitë që përjetojnë gratë në përballimin e jetesës në këtë situatë dhe çfarë po bën shoqëria civile për të qenë zëri i atyre që nuk mund të flasin për veten e tyre, e të tjera.

Nuk ishte i lehtë kërkimi dhe dhënia e përgjigjeve ndaj këtyre pyetjeve. Aq më tepër, nuk mund të pretendojmë se me përgjigjen tonë është shteruar gjithçka. E vërteta është se nëpërmjet një procesi relativisht të gjatë të punës në terren, duke përdorur teknika të punës kërkimore shkencore, kemi bërë përpjekje për t'iu afruar dhe për ta njohur nga afër këtë realitet të dhimbshëm, i cili duhet të ndryshojë patjetër.

Hipotezat

Hipoteza 1: Fenomeni i gjakmarrjes ka ndikim të drejtpërdrejtë në shumë aspekte të jetës sociale të grave të ngjuara.

Kjo hipotezë merr për bazë faktin se edhe pse gjakmarrja duket sikur kërcënon drejtpërdrejt meshkujt, gratë i vuajnë në një formë tjetër pasojat e saj. Kjo gjë duhet vërtetuar e qartësuar konkretisht përmes fakteve e argumentave.

Hipoteza 2: Fenomeni i gjakmarrjes ka impakt negativ afatgjatë në psikologjinë e grave të ngjuara.

Kjo hipotezë merr për bazë faktin se fenomeni i ngujimit shoqërohet me një jetë tepër stresante dhe me prani të çrregullimit të stresit post traumatik tek gratë e ngjuara, pasi ato kanë përjetuar ngjarje traumatike në të shkuarën e tyre, duke qenë dëshmitare të drejtpërdrejta të këtyre ngjarjeve.

3.3. Metodologjia e përdorur në studim

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metodologji e kombinuar: *sasiore dhe cilësore*.

Ky studim u mbështet tek metodologjia sasiore për të eksploruar situatën sociale tek gratë e familjeve të ngjuara, të cilat raportuan për gjendjen e tyre sociale përmes intrumenteve të përdorur, siç janë pyetësorët. Për këtë qëllim janë përdorur tre pyetësorë nga ana jonë. Pyetësori i parë hedh dritë mbi gratë e familjeve të ngjuara duke i parë ato si qenie sociale. Në këtë vështrim, janë mbledhur të dhëna demografike si: mosha, vendbanimi, përkatësia krahinore ose nënkulturore, statusi martesor, niveli i arsimimit dhe punësimi. Këto karakteristika kanë kuptim për studimin tonë, sepse na ndihmojnë të kuptojmë më gjerësisht situatën në të cilën jetojnë këto gra. Veç kësaj, kjo na ndihmon për të bërë më të qarta lidhjet mes koncepteve si ndikimi i nivelit të shkollimit, punësimit, numrit të fëmijëve në lidhje me çrregullimin e stresit post traumatik.

Gjithashtu, në studim u përdor edhe metoda cilësore me qëllimin për ta pasuruar atë me të dhëna të tjera që bazohen në përvojat personale të grave. Për këtë janë përdorur si instrumente intervista si dhe materialet e mbledhura nga dy fokus grupet. Projekti kërkimor u realizua në rrethin e Shkodrës dhe të Tiranës dhe qëllimi parësor i intervistave është që përmes tyre të zbulojmë se si ndikon fenomeni i gjakmarrjes në gjendjen sociale dhe psikologjike të grave që vuajnë prej saj.

Me disa gra që ishin gati të tregonin më shumë për jetën e tyre kam përdorur intervistën e lirë. Kam përdorur këtë intervistë edhe me gra të tjera që ishin pjesë e komunitetit të grave të prekura nga gjakmarrja por që ato vetë nuk e vuanin fenomenin, kjo për të parë dhe kuptuar sa e njihnin këto gra situatën në të cilën ndodheshin shoqet e tyre dhe sa të sensibilizuara ishin ato për të dhënë ndihmë në rast nevojë. Po ashtu, përmes dy fokus grupeve të organizuara në të dyja zonat gjeografike ku ky studim është bërë, kemi siguruar material të rëndësishëm për të parë gjendjen e grave të familjeve të ngujuara, si dhe për të kuptuar sa të socializuara janë ato në vendbanimin e tyre të ri. Edhe në këto fokus grupe janë ftuar gra të cilat nuk e vuanin fenomenin e gjakmarrjes. Kjo është bërë me qëllimin për të parë se sa shumë njihet ky fenomen nga njerëzit që nuk vuajnë prej tij, si dhe cilat janë marrëdhëniet mes dy kategorive përfaqësuese të grave të familjeve të ngujuara dhe ato jo të ngujuara. Evidentohen disa faktorë ndikues në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhen këto gra. Nëpërmjet pohimeve, diskutimeve të opinionëve të ndryshme dhe analizës së të dhënave kemi evidentuar një sërë prej këtyre faktorëve. Disa prej tyre janë niveli i ulët ekonomik, forca e kanunit, niveli i ulët arsimor, tranzicioni i tejzgjatur që po kalon vendi ynë.

Në këtë studim fenomeni i gjakmarrjes analizohet e studiohet duke respektuar edhe kriterin kronologjik, duke e parë atë si ka evoluar në kohë të ndryshme, duke kërkuar origjinën, historinë dhe gjendjen aktuale të këtij fenomeni në Shqipëri, si dhe pozitën e gruas në këtë kod zakonor. Kemi proceduar në këtë mënyrë që të kuptojmë më mirë gjendjen e grave dhe të familjeve të tyre, të cilat janë pjesë e këtij studimi. Për këtë janë shfrytëzuar të dhëna nga botime të mëparshme dhe nga media elektronike që trajtojnë këtë fenomen dhe faktorë që lidhen me të. Kjo literaturë përfshin jo vetëm gjakmarrjen, por edhe pajtimin e konflikteve,

legjislacionin, kanunin, doket e zakonet, pozitën e gruas, marrëdhëniet familjare dhe eksodin e popullsisë. Veç kësaj, nga ana jonë u përdorën edhe materiale të ndryshme apo artikuj të shtypit të përditshëm, përshtypje nga udhëtimet e të huajve në Shqipëri, vëmendjen e të cilëve e ka tërhequr edhe e drejta zakonore shqiptare. Një ndihmesë të madhe për të patur një tablo sa më të qartë lidhur me gjakmarrjen, ka dhënë informacioni i siguruar nga institucionet shtetërore siç janë: Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta, Policia e Shtetit, (SKZHES) dhe INSTAT-i. Punimet dhe të dhënat e konferencës kombëtare "*Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të së drejtës për jetën*", organizuar në vitin 2010 nga institucioni i Avokatit të Popullit, ishin një ndihmë me vlerë për trajtimin e gjakmarrjes si dukuri sociale dhe juridike. Gjithashtu material i rëndësishëm është marrë nga forumi akademik që organizata "Drejtësi dhe Paqe" në bashkëpunim me "Caritas" kanë organizuar në të njëjtin vit në qytetin e Shkodrës.

3.4. Kampioni

Për shkak të punës në terren përmes fondacionit "Jo Gjakmarrjes - Po Jetës" dhe përmes ndihmës së komunitetit në zonat e përcaktuara prej nga do të zgjidhej kampioni, patëm mundësinë të takonim shumë gra që vinin nga familje të ngujuara. Arritëm të kontaktonim me rreth 100 gra e vajza nga familje të përfshira në gjakmarrje, por vetëm 50 prej tyre ranë dakort që të merrnin pjesë në studim. Në mënyrë që të kishim një kampion sa më përfaqësues në shtrirje gjeografike, i kushtuam një kujdes të veçantë përzgjedhjes së grave pjesëmarrëse në intervistim, duke marrë një pjesë nga njësitë 2 dhe 3 të Bathores urbane si dhe nga njësitë 5 dhe 6 të Bathores rurale. Po ashtu patëm përfaqësi edhe nga zonat periferike të qytetit të Shkodrës. Më kryesorja ishte që secila grua të përfaqësonte një familje.

3.4.1. Përzgjedhja e kampionit

Fillimisht duhet të theksojmë se përzgjedhja dhe identifikimi i kampionit ishte mjaft i vështirë, kjo pasi jo të gjitha gratë e gjetura prej kësaj kategorie ishin të gatshme për t'u bërë pjesë e studimit dhe për të plotësuar pyetësoin. Individët, pjesë e këtij komuniteti, janë përdorur shpesh si kampion për studime të ndryshme që studentët e shkencave shoqërore kanë bërë më parë për këtë fenomen. Gjithashtu është mjaft e vështirë që t'i shpjegosh kësaj klase shoqërore vlerat e një studimi të tillë dhe sa e rëndësishme është pjesmarrja e tyre në të. Në këtë studim kampioni është përzgjedhur duke përdorur strategjinë e kampionimit jo me probabilitet, pra kampioni i qëllimshëm mbi bazën e gjykimit. Ky kampionim buron nga studiuesit, të cilët “synojnë një grup të veçantë, me dijeni të plotë” dhe ky kampion nuk mund të “përfaqësojë popullatën e gjerë” (Cohen, Manion dhe Morrison, 2000:102. Kjo strategji mund të prodhojë një kampion që mund të mos jetë përfaqësues për të gjithë popullsinë, por kjo nuk është një mangësi për ne, pasi studimi ynë fokusohet në një grup të popullsisë me kritere të veçanta.

3.4.2. Kriteret për përzgjedhjen e kampionit

Kampioni i qëllimshëm është i bazuar në gjykimin rreth disa karakteristikave të përshtatshme të anëtarëve të kampionit. Më poshtë, po rendisim kriteret kryesore të përzgjedhjes së grave për studim. Në zgjedhjen e kampionit tonë janë respektuar kriteret e mëposhtme:

- Subjektet janë gra që vijnë nga zonat e Veriut dhe të Verilindjes së Shqipërisë.

- Subjektet janë gra, familjet e të cilave janë aktualisht të ngujuara dhe vuajnë pasojat e gjakmarrjes.
- Këto subjekte janë gra që kanë rënë dakort të marrin pjesë vullnetarisht në këtë studim.

Kampioni në këtë studim është përfaqësues për faktin se janë përcaktuar, specifikuar dhe respektuar kriteret që janë përdorur për ta zgjedhur atë. Gjithashtu, nga statistikat zyrtare të raportuara nga Policia e Shtetit, numri i familjeve të ngujuara për shkak të gjakmarrjes është 67 familje në të gjithë Shqipërinë. Nga një raport i Ministrisë së Brendshme i vitit 2012, numri i personave të ngujuar është 155. Madje, në këtë raport përdoret termi “persona me vetëkufizim lirie”. Nën dritën e këtyre statistikave, numri i grave në studimin tonë siguron një përfaqësi të kënaqshme të kësaj kategorie.

3.5. Instrumentat e përdorur

Qasjet metodologjike të ndjekura në kryerjen e këtij studimi janë një ndërthurje e metodave dhe instrumentave sasiore dhe cilësore që përdoren zakonisht për kërkim në shkencat sociale. Instrumentat e përdorur janë pyetësorët dhe intervistat. Në pyetësorët kanë marrë pjesë 50 gra, ndërsa në intervistën e lirë 10 gra. Në intervistë të lirë janë marrë edhe disa gra që nuk janë të prekura nga gjakmarrja. Kjo është bërë për të parë se si e perceptojnë ato pozitën e shoqeve të tyre dhe sa të ndjeshme janë ndaj këtij problemi. Veç kësaj, kam mbledhur të dhëna edhe nga dy fokus grupe me nga 8 gra secili, njeri i mbledhur në Shkodër dhe tjetri në Bathore.

3.5.1. Pyetësi i të dhënave demografike dhe sociale

Sic e përmendëm edhe më sipër, ky pyetësor u hartua për nxjerrjen e karakteristikave themelore socio-demografike për qëllim të këtij studimi dhe u strukturua në një mënyrë të mirëmenduar për të mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme për studimin tonë. Ky është pyetësi i parë që kemi përdorur dhe përbëhet nga 22 pyetje të cilat ndahen në disa kategori të ndryshme për mbledhjen e informacioneve të ndryshme. Një nga kategoritë ka pyetje që siguron informacion për kohën, arsyen dhe historinë familjare të ngujimit. Një rubrikë tjetër paraqet gjendjen ekonomike të tyre dhe nëse kjo gjendje ka ndryshuar për mirë apo për keq me ndryshimin e vendbanimit përmes migrimit. Më pas kemi kategorinë që merr informacion në lidhje me marrëdhëniet që kanë këto gra si qenie sociale, marrëdhënie me familjarët, të afërmit, shoqet dhe komunitetin më gjerë, kontaktet me instancat shtetërore përkatëse dhe me OJF të ndryshme, dhe sa të evidentuara janë këto familje e veçanërisht gratë nga të gjithë këta aktorë socialë që veprojnë në shoqërinë tonë. Ndërsa në kategorinë e fundit të pyetjeve jemi fokusuar më shumë në mbledhjen e sugjerimeve për ndryshimin e situatës së gjakmarrjes duke ndryshuar kështu edhe të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Pyetësi ishte i përbërë nga dy lloj pyetjesh, pyetje të hapura dhe të mbyllura. Qëllimi i përdorimit të pyetjeve të hapura ishte të grumbullojmë sa më shumë informacion të detajuar dhe përgjigjet e tyre janë kategorizuar në bazë të shpeshtësisë së përgjigjeve apo opinioneve të dhëna nga gratë. Në këtë mënyrë mund të kishim një analizë të saktë të tyre. Duke ditur paraprakisht nivelin e ulët arsimor të tyre u përpoqëm që të formulonim pyetje të qarta, të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, për të marrë informacionin e nevojshëm për studimin tonë.

Pyetësi për historinë e traumës

Për të evidentuar traumën të cilën gratë kanë përjetuar, kemi përdorur pyetësin e historisë së traumës (Trauma History Questionary, THQ, Green 1996), versionin e shkurtuar për qëllim të këtij studimi. Qëllimi për përdorimin e këtij pyetësi, nuk ishte vetëm të shikonim nëse këto gra ishin përballur në jetën e tyre me një ngjarje traumatike apo jo, por gjithashtu, edhe të shikonim nëse kjo ngjarje traumatike kishte lidhje të drejtpërdrejtë ose indirekte me fenomenin e gjakmarrjes. Nga ky pyetësor kemi hequr rubrikën e Eksperiencave Fizike dhe Seksuale. Kjo u bë për dy arsye:

Së pari, për gratë e kësaj kategorie është tabu për të folur për marrëdhëniet normale seksuale me bashkëshortët e tyre. Përballë pyetjeve të këtij grupi në pyetësor, ato do të mund të ndiheshin nën presion dhe madje edhe të fyera. Gjithashtu, një nga qëllimet e këtij studimi është të shikojmë se si lidhet eksperiencia e një ngjarje traumatike që fenomeni i gjakmarrjes ka shkaktuar tek to me gjendjen e tyre psiko-sociale.

Së dyti, edhe pse jemi të vetëdijshëm që ekspozimi ndaj traumave të së shkuarës ose të fëmijërisë së tyre mund të ndikojnë në vulnerabilitetin dhe mënyrën e tyre të reagimit ndaj traumës që fenomeni ka shkaktuar, kemi zgjedhur që të fokusohemi vetëm në këtë segment dhe në punime të mëtejshme mund të bëjmë një studim më të zgjeruar duke përfshirë edhe traumat e mundshme që mund të kenë kaluar ato në fëmijëri.

3.5.3. Paketa e analizës së të dhënave

Për të parë dallimet e mundshme statistikore në karakteristikat demografike të pjesëmarrëseve në hulumtim, u zhvillua testi i hi-katrorit (Chi - Square Goodness – of - Fit).

Vlerat e fituara përmes testit *chi-square*, për sa i përket nivelit të arsimimit të pjesmarrëseve $\chi^2 (3, N = 50) = 35.440, p = .000$, treguan që hipoteza zero që presupozon se nuk ka dallime ndërmjet pjesmarrëseve në nivelin e arsimimit, nuk është realizuar. Pra, referuar vlerave të probabilitetit, mund të themi se ka dallime në nivelin e arsimimit ndërmjet grave pjesmarrëse në hulumtim.

Dallime të rëndësishme statistikore ka pasur ndërmjet pjesmarrëseve për sa i përket statusit të tyre civil. *Chi-square*, $\chi^2 (2, N = 50) = 43.960, p = .000$ tregoi vlera të signifikanës statistikore. Numri më i madh i grave pjesmarrëse janë të martuara (38 prej tyre, ose 76 %). Edhe në të dhënat për statusin e tanishëm të punësimit, pjesmarrëset treguan dallime të vlefshme statistikore $\chi^2 (2, N = 50) = 32.122, p = .000$. Përqindjen më të lartë të grave pjesmarrëse në hulumtim e përbëjnë gratë që nuk punojnë (35 prej tre ose 70 %) dhe vetëm 8 prej tyre (16 %) janë të punësuar.

Ndërkohë *chi-square* testi nuk tregoi dallime ndërmjet pjesmarrëseve në punësimin e tyre në sektorin publik ose privat. Vlerat e fituara të *chi-square* testit janë: $\chi^2 (1, N = 50) = .818, p = .1$

3.5.4. Intervista matëse e simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik, PSS-I

PSS-I - Intervista matëse e simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik (PTSD Symptom Scale Interview, PSS - I, Foa E., Riggs D., Dancu C. & Rothbaum B. 1993). PSS-I përmban 17 pyetje të një interviste gjysmë të strukturuar që tregon praninë dhe ashpërsinë e simptomave të DSM-IV. Simptomat e çrregullimit të stresit post traumatik janë të lidhura me një ngjarje të vetme ose me disa ngjarje të identifikuara si traumatike për individët me një histori traumatike të njohur. PSS-I merr rreth 20 minuta për t'u administruar dhe mund

të aplikohet nga intervistues të trajnuar për të njohur pasqyrën klinike të personave të traumatizuar. Çdo rubrikë është vlerësuar me një pyetje të vetme të shkurtër. Nuk ka hetime apo pyetje që pasojnë. Të intervistuarat pyeten në lidhje me simptomat që kanë përjetuar që nga momenti që ka ndodhur trauma. Ky afat kohor ndryshon për persona të ndryshëm në varësi të ndodhisë së ngjarjes traumatike. Për secilin artikull, intervistuesi cakton një vlerësim për të reflektuar një kombinim të frekuencës dhe ashpërsisë (nga 0 = aspak, 1 = Një herë në javë a më pak, 2 = 2 - 4 herë në javë pak a shumë, 3 = 5 ose më shumë herë në javë).

a. Rezultatet e PSS-I

Rezultati i PSS-I-së nxirret thjesht duke bërë shumën e pikëve të pyetësorit individual. Ky pyetësor ka 3 grupe të mëdha rubrikash që janë: ripërjetim, shmangie, dhe hipervigjilencë (reagim i shtuar). PSS-I ka veti të shkëlqyera psikometrike. Klasifikimi i besueshmërisë së diagnozës së çrregullimit të stresit post traumatik dhe ashpërsisë së përgjithshme është i shkëlqyeshëm (Foa, 1993).

b. Pikëzimi i rezultatit

Rezultatet e PSS-I shënohen duke mbledhur rezultatet individuale nëpër secilin artikull. Për të marrë rezultatet e seriozitetit për secilën shkallë: ripërjetimin, shmangien dhe hiperzgjimin (hyperarousal), mjafton të mblidhen pikëzimet për secilin artikull brenda secilit grup. Për të fituar peshën totale të PTSD, mblidhen pikët në të 17 artikujt e PSS-I.

c. Analizimi i të dhënave

Pas përfundimit të punës në terren është bërë rishikimi edhe një herë i kampionit dhe janë hequr ato subjekte që ndikonin negativisht në rezultatet e studimit. Numri final i

pjesmarrëseve me të cilat janë zhvilluar analiza të mëtjeshme është 60 subjekte (50 në intervista të lira dhe 10 në fokus grup).

Të gjitha rezultatet janë llogaritur sipas udhëzimeve të dhëna në manualin përkatës. Pikët në shkallët e pyetësorit janë paraqitur përmes mesatares aritmetike (MA) dhe devijimit standard (SD), në intervalin e besimit 95% (95 % CI).

Analizat janë:

Vlerësimi i besueshmërisë dhe i saktësisë së pyetësorëve të përdorur në studim si dhe konsistenca e brendshme është analizuar duke përdorur Cronbach alfa (α).

- Për të parë dallimet ndërmjet përgjigjeve të mbledhura u përdor chi-square goodness-of-fit test.
- Për dallimet ndërmjet grupeve u përdor t-testi dhe ANOVA një drejtimëshe. Meqenëse ANOVA njëdrejtimëshe është një analizë statistikore omnibus, si e tillë nuk mund të na tregojë se cilat grupe të veçanta janë dukshëm të ndryshëm nga njëri-tjetri. Meqenëse në hulumtimin tonë ne kemi më shumë se tre grupe, dallimet e mundshme të vlefshme statistikisht ndërmjet tyre, i kemi gjetur duke përdorur testin post-hoc Bonferroni.
- Përdorimi i analizës së njëanshme të variancës (ANOVA) është i njohur dhe mund të përdoret për rastin e një rezultati sasior me një kategori shpjeguese që ka dy ose më shumë nivele të trajtimit. Termi njëkahësh i quajtur edhe një faktor, tregon se ekziston një variabël i vetëm shpjegues me dy ose më shumë nivele dhe zbatohet vetëm një nivel trajtimi në çdo kohë për një temë të caktuar. Në ANOVA ne përdorim sasi të variancës për të studiuar barazinë ose jo-barazinë e mesatareve të popullsisë. ANOVA krahason

mesataret e mostrës ose grupeve, për të bërë konkluzione rreth popullsisë (Howell, D. C. 2002).

- Për të kuptuar nëse ekziston një ndërveprim midis dy variablave të pavarura me variablin e varur, kemi përdorur ANOVA dy drejtimëshe, e cila krahason dallimet mesatare ndërmjet grupeve që kanë qenë të ndarë në dy ndryshore të pavarura (të quajtura faktorë).
- Për të përcaktuar ndikimin e variablave në PTSD kemi përdorur regresionin e thjeshtë dhe regresionin e shumëfishtë.

Në një ekzaminim të kohëve të fundit, klasifikimi i besueshmërisë për ashpërsinë e simptomës ishte .94 (Foa, 2005). Foa dhe Tolin (2000) raportuan se PSS-I dhe CAPS (cognitive-affective personality system, Walter Mischel, Yuichi Shoda, 1995) kishin një nivel qëndrueshmërie të brendshëm të barabartë e të lartë; PSS-I dha klasifikim pak më të lartë besueshmërie sesa CAPS; pra CAPS dhe PSS-I u lidhën ngushtë me njëri-tjetrin. Në përgjithësi, CAPS dhe PSS-I performuan mirë dhe në mënyrë të barabartë. Kështu që, koha e nevojshme për vlerësimin e çrregullimit të stresit post traumatik me PSS-I është relativisht e shkurtër pa sakrifikuar besueshmërinë ose vlefshmërinë.

3.6. Çështjet etike

Jemi përpjekur në mënyrë të qëllimshme që të mos shkelim asnjë çështje etike në këtë studim. E kemi bërë këtë duke ruajtur konfidencialitetin ndaj grave të intervistuar, duke ruajtur anonimitetin e tyre, si dhe duke përdorur çdo të dhënë që kemi marrë përmes instrumentave matës vetëm për qëllim të këtij studimi. Pasi kemi identifikuar dhe zgjedhur me kujdes gratë pjesëmarrëse në studim, kemi bërë me to takime e biseda paraprake, duke shpjeguar përmes një komunikimi të qartë qëllimin dhe procesin e plotësimit të pyetësorëve

dhe atë të intervistimit. Kemi bërë takime me rreth 100 gra të ngjuara, pastaj në bashkëpunim me to është vendosur data dhe koha kur mund të aplikoheshin pyetësorët e hulumtimit. Shoqata e psikologëve amerikanë (2010), prezanton parimet etike dhe kushtet e studimeve, që janë respektuar kryesisht gjatë realizimit të studimit, siç janë:

1. *Informimi*: Kemi informuar gratë që përbëjnë kampionin e zgjedhur për studim që përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë të rastësishme. Pas takimeve të shumta që kemi bërë me to për t'i instruktuar për procesin e intervistimit, ka patur edhe subjekte që kanë refuzuar pjesëmarrjen në studim.
2. *Pjesëmarrja vullnetare*: Gjithashtu kemi informuar subjektet e përfshira në studim që pjesëmarrja e tyre në të do të ishte me zgjedhje të lirë dhe vullnetare, si dhe në çdo moment, nëse gratë nuk do të ndiheshin mirë gjatë procesit të intervistimit apo të fokus grupeve, ato ishin të lira të tërhiqeshin nga studimi duke mos pasur asnjë pasojë, pavarësisht plotësimit të pjesshëm të pyetësorit. Informacioni i mbledhur nga gratë përmes pyetësorëve, nuk evidentohet në sistemin kompjuterik.
3. *Qëllimi i studimit*: Kemi informuar të gjitha subjektet për qëllimet dhe arsyet se pse po e bëjmë këtë studim. Pas këtij informimi gratë kanë vendosur për pjesëmarrje.
4. *Kontakt për informim* më të detajuar me studiuesin: Në çdo pyetësor, subjektet kanë patur kontaktin e intervistuesit dhe gratë kanë qenë të lira të kontaktojnë për çdo informacion të mëtejshëm mbi ecurinë e studimit apo për çdo paqartësi.
5. *Anonimiteti*: Të gjitha gratë që kanë marrë pjesë në studim janë siguruar më parë se për çdo të dhënë që ato kanë paraqitur në pyetësorë është ruajtur anonimiteti dhe konfidencialiteti

i tyre. Jemi treguar të kujdesshëm gjithashtu duke shmangur çdo informacion që do të orientonte në zbulimin e identitetit të pjesëmarrëseve.

6. *Informacioni mbi variablat e studimit*: Në mënyrë që të mos ndikonim në përgjigjet e dhëna të grave në pyetësor dhe që këto përgjigje të ishin sa më objektive, kemi shmangur informimin për variablat kyçe të studimit. Është bërë vetëm një informim i përgjithshëm pa kaluar në detaje specifike, duke mos rrezikuar dhe opinionizuar kështu subjektet e studimit.

3.7. Kufizimet dhe vështirësitë e studimit

Nuk ishte i lehtë kërkimi dhe dhënia e përgjigjeve për pyetjet e parashtruara në fillim të këtij studimi. Edhe pse është treguar kujdes maksimal për të qenë objektive në trajtimin e kësaj teme dhe në gjetjet tona, për të rritur shkallën e besueshmërisë dhe të vlefshmërisë së të dhënave apo të konkluzioneve e sugjerimeve, punimi ka kufizimet e veta që kanë ardhur nga vështirësitë e mëposhtme me të cilat jemi ndeshur hap pas hapi në punën tonë:

1. Kufizimi i parë lidhet me faktin që nuk ka studime të plota që të trajtojnë ngujimin apo dukurinë e gjakmarrjes si dukuri sociale dhe psikologjike. Në këndvështrimin tonë, nëse do të kishim trajtime psikologjike, atëherë puna jonë do të ishte e orientuar dhe më e lehtë për t'u kryer.

2. Literatura ekzistuese që trajton fenomenin e gjakmarrjes është mjaft e kufizuar. Edhe ato pak burime informacioni apo studime të kryera nuk janë të plota dhe nuk e trajtojnë gjerësisht këtë temë. Po kështu, është e kufizuar edhe literatura në gjuhë të huaj për të parë nëse është e përhapur dukuria e ngujimit dhe e gjakmarrjes në vende të tjera dhe si trajtohet ajo.

3. Studimi është fokusuar në atë grup të popullatës që vuan pasojat e gjakmarrjes. Si rrjedhojë, përzgjedhja dhe madhësia e kampionit përcaktohet nga numri i subjekteve që vuajnë prej këtij fenomeni. Ne jemi munduar të sigurojmë një kampion sa më përfaqësues, duke marrë për bazë statistikën që kemi siguruar nga burimet e Policisë së Shtetit dhe Avokati i Popullit. E vërteta është se ka qenë një kufizim mjaft i madh për studimin tonë mungesa e statistikave të sakta për këto familje. Për më tepër, gjatë punës jam gjendur në mes të një konflikti dhe ndryshimi të madh mes statistikave shumë të ulta të paraqitura nga organet shtetërore, si dhe nga një realitet tjetër statistikash i paraqitur nga organizata të ndryshme jo qeveritare, që merren me ndihmë dhe punë konkrete në terren me këtë kategori familjesh. Pra, numri i familjeve të regjistruara në Policinë e Shtetit ndryshon në mënyrë drastike në raport me statistikën që sjell Avokati i Popullit, si dhe me statistikën që kanë organizatat, si dhe Komiteti i Pajtimt të Gjakeve. Kjo lidhet me faktin se në komunitetet ku familjet janë në konflikt hasmërie, raportimi i konfliktit në komisarjat konsiderohet turp dhe dobësi. Kjo gjë i bën statistikën e policisë të jenë të kufizuara dhe të zvogëluara në raport me numrin real të familjeve të ngujuara. Përsa u përket statistikave që disponojnë organizata të ndryshme që punojnë në terren, duhet thënë se ka një skepticizëm dhe dyshim të përgjithshëm, pasi statistikën e tyre janë të ekzagjeruara dhe kjo bëhet qëllimisht prej tyre që të sigurohen e përfitohen sa më shumë fonde. Statistikën e Avokatit të Popullit janë më të neutralizuara, por mendoj që edhe ato nuk janë plotësisht të sakta.

4. Përzgjedhja e kampionit ishte një vështirësi në vetvete. Kjo për shkak të izolimit social që kanë këto familje dhe për shkak të frikës ndaj personave të panjohur. Gjithashtu, këto familje ishin mjaft të shpërndara gjeografikisht. Disa prej tyre ishin në zona të thella rurale ku mund

të shkohej deri në një vend të caktuar me makinë dhe pastaj duhej të ecje disa kilometra në këmbë.

5. Tregimi i historisë personale dhe i të dhënave të tjera të kërkuara përmes pyetësorëve konsiderohej si diçka që nuk mund të flitet me njerëz të panjohur. Kjo për shkak të rrezikut para të cilit janë të ekspozuara këto familje. Krijimi i besueshmërisë dhe bindja e këtyre grave që gjithçka bëhet vetëm për qëllim studimi dhe për asnjë qëllim tjetër, ishte një proces i vështirë në vetvete.

6. Mohimi që i bëhet egzistencës së këtij fenomeni nga instancat shtetërore dhe nga akademikë të ndryshëm, ekzistenca e një paragjykimi që çdo gjë bëhet për ngritje fondesh nga organizata të ndryshme, ka qenë një vështirësi tjetër për këtë studim.

7. Mungesa e instrumentave matës të standartizuar, të përkthyer në gjuhën shqipe, për të mbledhur të dhënat për studimin tonë, ka qenë një nga kufizimet e tjera të këtij studimi. Dy nga tri pyetësorët e përdorur i kemi përkthyer vetë nga gjuha angleze.

8. Në 6-mujorin e parë të këtij viti Shqipëria u rendit në vendin e dytë në Listën e shteteve azil-kërkuese ndër vendet Perëndimore. Lëvizja e madhe e shqiptarëve për të kërkuar azil në vende të tjera të Europës, ku një pjesë e madhe e azilkërkuesve kanë pasur si pretekst gjakmarrjen për arratisjen e tyre, e ka bërë edhe më të vështirë mundësinë për të ditur gjendjen dhe numrin real të familjeve të prekura nga ky fenomen.

3.8. Kufizime specifike të këtij kërkimi

Nga instrumentat që kemi përdorur për kërkim kemi hequr rubrikën e eksperiencave fizike dhe seksuale. Këtë e kemi bërë për 2 arsye:

a. Është tabu për këtë kategori grash të flasësh për marrëdhëniet normale seksuale mes bashkshortësh. Kemi gjykuar se përballë kësaj rubrike ato mund të ndiheshin nën presion dhe nuk do të merrnim ndonjë të dhënë. Përgjithësisht këto janë gra që lindin shumë fëmijë. Interesant është fakti se mbi 60% e fëmijëve të lindur prej tyre janë meshkuj.

b. Qëllimi i studimit është të shikojmë si lidhet eksperiencia e një traume të shkaktuar nga gjakmarrja me gjendjen e tyre psiko-sociale. Jemi të vetëdijshëm që ekspozimi i traumave në të shkuarën mund të ndikojë në vulnerabilitetin dhe në reagimin e subjekteve ndaj traumës që fenomeni ka shkaktuar. Por objekt i temës sonë është problematika sociale dhe psikologjike e grave të ngugjuara dhe jemi fokusuar në këtë vështirësi. Në punime të mëtejshme mund të bëhet një studim më i zgjeruar duke përfshirë edhe traumat që ato kanë kaluar në fëmijëri.

KAPITULLI IV

ANALIZA EMPIRIKE E TË DHËNAVE

PARËSORE

Ky kapitull paraqet një analizë të hollësishme të të dhënave që kemi mundur të sigurojmë përmes instrumentave të përdorur, siç janë pyetësorët dhe intervistat e kryera me subjektet tona. Paraqitja e të dhënave bëhet përmes shifrave, fakteve dhe të dhënave të tjera të mbledhura në terren për çështje të tilla që lidhen me tregues demografikë, tregues të situatës sociale dhe të gjendjes psikologjike të grave të ngujuara. Është treguar kujdes që të dhënat e siguruar të prezantohen sa më qartë përmes shifrave dhe analizës së tyre, por duke bërë edhe paraqitje tabelore apo grafike. Në fund të çdo rubrike kemi bërë konkluzione, duke përmbledhur shkurtimisht vlerësimet tona për çështjet e veçanta.

4.1. Mjedi rrethues i të intervistuarave

Pasi u zgjodh kampioni për studim u kontaktua përmes telefonit për të lënë takim me secilën prej grave në ambientet e fondacionit “*Jo Gjakmarrjes–Po Jetës*”. Nga ana jonë u tregua kujdes për të krijuar një ambient të ngrohtë e miqësor rreth një tavoline ku ofrohej çaj dhe kafe. Ky ambient synonte të krijonte një ndjenjë rehatie dhe lirie për të folur. Intervistat u kryen një nga një, në mënyrë që gratë të mos ishin të ndrojtura për të ndarë atë që ndjenin dhe mendonin në të vërtetë. Dialekti i thellë verior nuk përbente problem, pasi qëndrimi për 16 vjet mes tyre bëri që komunikimi të ishte i lehtë. Gjithashtu, edhe marrëdhëniet e ndërtuara më parë me to, krijuan një ambient të besueshëm dhe të lirshëm, ku ato mund të flisnin pa ndrojtje. Gjatë dhënies së intervistave, të përzgjedhurat kishin luhatje të theksuara

emocionesh. Ato qeshinin e qanin shpesh dhe madje edhe në të njëjtën kohë, merrnin frymë thellë, ngrinin zërin, heshtnin, lëviznin qepallat dhe shumë herë këto shfaqje emocionesh mbivendoseshin.

Anketimi dhe intervistat u zhvilluan me gratë, banore në periferi të qytetit të Shkodrës dhe banore të Bathores. Konkretisht, në katër prej ndarjeve të saj: dy nga zona urbane 2 dhe 3 si dhe dy nga ato rurale 5 dhe 6. Banorët janë kryesisht të ardhur nga zonat veriore të vendit. Shumica e tyre janë me origjinë nga fshati dhe për rrjedhojë marrëdhëniet e tyre janë të ndërtuara në bazë të lidhjeve familjare dhe atyre krahinore. Këta banorë nuk u vendosën në këtë zonë sipas një plani paraprak nga pushteti vendor, por pasi zaptuan tokat e lira, ata ndërtuan shtëpitë e tyre pa leje apo pa ndonjë plan specifik ndërtimi (model i njohur si ZNIP, zaptim, ndërtim, infrastrukturë, planizim).

Zhvendosja e popullsisë nga zona veriore e vendit, e nxitur nga dëshira për një jetë më të mirë, solli me vete edhe disa probleme sociale të tyre dhe një ndër to ishte edhe gjakmarrja. Këto zona u krijuan nga një migrim i menjëhershëm dhe i paplanifikuar i popullsisë dhe karakterizohen nga një nivel shumë i ulët ekonomik. Kjo pasi duke u shpërngulur nga vendbanimi i mëparshëm lanë pas çdo gjë që kishin dhe në vendin ku u vendosën nuk kishin asgjë, përveçse një copë toke edhe këtë të zaptuar. Në vendin ku u vendosën u përballën me një shkallë të lartë papunësie që ishte veçanërisht e lartë për këtë target grup pasi nuk ishin në gjendje të përmbushnin kërkesat e tregut. Por vlen për t'u theksuar se ky komunitet nuk u varfërua përmes migrimit, por fakti që vijnë nga zona të thella Veriore dhe Verilindore të Shqipërisë të cilat karakterizohen përgjithësisht nga një nivel i lartë varfërie. Përkatesisht në qarkun e Dibrës dhe të Kukësit, 45 % e popullsisë jeton nën nivelin zyrtar të varfërisë,

kështu një pjesë e madhe e familjeve që migrojnë prej këtyre rrethëve marrin me vete si problematikën ekonomike ashtu edhe atë sociale të qarkut prej nga vjen. Zona në të cilën jetojnë këto familje të zhvendosura është më pak e zhvilluar ekonomikisht dhe ka më pak shërbime publike. Vendosja e tyre përmes zaptimit të tokave e bën të vështirë investimin publik në kanalizime, shtrim të rrugëve, ndërtimin e shkollave, spitaleve, pra zhvillimin e infrastrukturës në tërësi.

Një nga problemet e mëdha të familjeve që janë në situatë gjakmarrje është se, një pjesë e tyre, akoma nuk ka bërë zhvendosjen për në vendbanimin aktual në gjendjen civile. Kjo për shkak të nevojës për t'u fshehur nga gjakësi, por duke mos shmangur fshehjen ndaj shërbimeve publike gjithashtu.

4.2. Disa tregues demografikë të grave të familjeve të ngujuara

Më poshtë, do të paraqesim të dhënat empirike të mbledhura nga pyetësi i parë, i cili është bërë për qëllim të këtij studimi. Arsyeja përse jemi ndalur në çdo pyetje specifike, bëhet me qëllim që të njohim sa më mirë kampionin dhe të përpiqemi që në fund të këtij kapitulli të jemi në gjendje të analizojmë dhe t'iu përgjigjemi pyetjeve si dhe të shpjegojmë vërtetimin e hipotezave.

✓ **Mosha**

Mosha e pjesëmarrëseve në studim paraqitet e shpërndarë si në tabelën më poshtë:

Mosha	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
a. Nën 25vjeç	3	6
b. 26-35 vjeç	10	20
c. 36-45 vjeç	24	48
d. mbi 46	13	26
Totali	50	100

Tabela 2. Mosha

Siç shihet në tabelën më sipër, 6 % e të intervistuarave janë të moshës nën 25 vjeç, 20 % janë në interval të moshës 26 – 35 vjeç, 48 % e të intervistuarave janë në intervalin e moshës 36-45 vjeç dhe 26 % janë mbi 46 vjeç.

✓ **Arsimi**


Arsimi	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Fillor	8	16
8-vjeçar	30	60
I mesëm	11	22
I lartë	1	2
Pas universitar		0
Totali	50	100

Tabela 3. Arsimi

Nga tabela e mësipërme rezulton se pjesa më e madhe e grave të pyetura kanë arsim 8-vjeçar. Të pyetura se cila ishte arsyeja që ato nuk kishin vazhduar arsimin e mesëm apo të lartë, një pjesë e madhe e tyre treguan se nuk iu takonte atyre të merrnin këtë vendim, por ishte babai, vëllezërit më të mëdhenj, e familjarë të tjerë që vendosnin për shkollimin e tyre. Gjithashtu, edhe tradita apo vetë kushtet ku jetonin kërkonin prej tyre që pas disa vitesh shkollimi (*mjaft i keni, ju vajzat*) ato duhej të përgatiteshin për martesë dhe të merreshin vetëm me punët e shtëpisë. Megjithatë, interesant është fakti që një pjesë jo e vogël e tyre ishte me arsim të mesëm. Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e kësaj kategorie të fundit e kishin kryer shkollën e mesme përpara vitit 1991. Asnjëra nuk ishte analfabete, ndërsa vetëm një kishte kryer arsimin e lartë për mësuesi.

✓ **Statusi civil**

Statusi civil i pjesëmarrëseve është i paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Grafik 1. Statusi civil

Rezulton se pothuajse të gjitha gratë kishin qenë të martuara. Ndër to, 22 % kishin humbur bashkëshortin dhe asnjëra nuk ishte martuar rishtaz.


✓ **Numri i familjarëve**

Numri i familjarëve	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
0-3	14	28
4-7	32	64
8-10	4	8
Total	50	100

Tabela 4. Numri i familjarëve


Siç duket edhe nga paraqitja në tabelën më sipër, 64 % e grave jetojnë në familje me 4,5, 6 dhe 7 anëtarë, ndërsa 28 % e tyre jetonin vetëm me 1, 2 dhe 3 anëtarë. Me kalimin e kohës ka një prirje që çiftet të lindin më pak fëmijë dhe familjet të jenë më të vogla. Arsyeja e këtyre familjeve të vogla shpjeguar prej grave, është mungesa e kushteve për t'i rritur fëmijët me të gjitha kërkesat e kohëve të sotme (*nuk kemi më çfarë t'i rrisim*). Familjet më të mëdha dhe me më shumë fëmijë vijnë kryesisht nga zonat veriore të vendit, vende të cilat jo vetëm janë karakterizuar nga një numër i lartë lindshmërie, por edhe djemtë e rritur të martuar

jetojnë në të njëjtën familje me prindërit dhe fëmijët e tjerë. Pra është tipi i familjes së përbërë në një trung të përbashkët. Për lehtësi shpërngulje dhe gjetje strehimi një pjesë e familjeve të vogla janë rezultat i ndarjeve nga familjet e mëdha me shumë kurorë. Këto rezultate mbështeten edhe nga numri i fëmijëve të këtyre familjeve, ku 67 % e tyre kanë 1, 2 dhe 3 fëmijë.



Grafik 2. Numri i fëmijëve

Ndërsa, përsa i përket gjinisë së fëmijëve të këtyre grave, 61 % e tyre janë djem.



Grafik 3. Gjinia e fëmijëve


✓ **Rrethi** nga janë larguar, pasi janë ngujuar për shkak të gjakmarrjes.

Nga të dhënat e kësaj rubrike shfaqet dukshëm se pjesa më e madhe e grave të familjeve të ngjuara janë shpërngulur nga pjesa Veriore dhe ajo Verilindore e vendit. Pjesa më e madhe e tyre ka ardhur nga Dukagjini, Tropoja, Kukësi dhe fshatrat përreth, ndërsa përqindja më e vogël është nga Peshkopia, Dibra, Mirëdita dhe Burreli.

Vendbanimi i mëparshëm	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Dukagjin	13	26
Tiranë	1	2
Tropojë	9	18
Mirditë	1	2
Peshkopi	2	4
Dibër	2	4
Kukës	6	12
Burrel	1	2
Nuk janë zhvendosur nga Shkodra	15	30
Totali	50	100

Tabela 5. Rrethi nga i cili janë larguar

Të dhënat tregojnë se 30 % e këtyre familjeve kanë qenë të shpërngulura nga vendlindja e tyre dhe janë vendosur në Shkodër, para se të ishin të ngjuar për shkak të gjakmarrjes. Kjo gjë tregon gjithashtu, një nga karakteristikat e kampionit tonë, që këto familje janë të ardhura nga zonat Veriore dhe Verilindore të Shqipërisë. Më poshtë, kemi bërë edhe paraqitjen grafike të të dhënave që të kemi siguruar si dhe një pamje vizive të shpërndarjes së zonave:



Grafik 4. Vendbanimi i mëparshëm

4.3. Paraqitja e nivelit ekonomik të familjeve të prekura nga gjakmarrja

Në këtë kategori të pyetjeve të pyetësorit ishte sfidë më vete të merrje informacion në lidhje me të ardhurat me të cilat këto familje jetonin si dhe një përshkrim të detajuar të gjendjes së tyre ekonomike. Gratë e kishin të vështirë të ishin transparente në këtë fushë. Diçka e tillë mund të shpjegohet edhe me faktin që në përgjithësi me të tjerët ato flasin vetëm për nevojat dhe vështirësitë që hasin në përballimin e jetesës dhe kur vjen puna për të ardhurat kjo është diçka që duhet ta dinë vetëm bashkëshortët, madje as fëmijët. Gjithsesi u munduam që në këtë pjesë të bënim pyetje të përgjithshme me shpresën se do të merrnim informacion të nevojshëm.

➤ *Numri i anëtarëve të familjes që sjellin të ardhura për familjen.*

Kjo pyetje iu drejtua të intervistuarave për të krijuar një ide të përgjithshme se cili është niveli i tyre i jetesës dhe sa mundësi u ishin krijuar atyre në vendbanimin e ri. Bie në sy se pjesa më e madhe e familjeve të marra në studim kishin vetëm një burim të ardhurash. Për efekt të studimit të gjendjes ekonomike të këtyre familjeve, si burim të ardhurash është

llogaritur edhe mbështetja e tyre nga shteti përmes asistencës sociale dhe pensionit që ato marrin kur humbasin kryefamiljarin. Tepër shqetësues është fakti se 18 % e këtyre familjeve nuk kanë asnjë burim të qëndrueshëm të ardhurash. Me burim të qëndrueshëm kuptohet një punë që gjeneron të ardhura të vazhshdeshme mujore. Këto familje përballojnë jetesën me të ardhura nga punë të rastësishme dhe më së shumti përmes punimit dhe mbjelljes së tokës në vendbanimin e tyre të dikurshëm dhe të tanishëm. Kjo është edhe arsyeja pse këto familje janë vendosur në periferi të qytetit të Shkodrës dhe në Bathore. Punët e bujqësisë në vendbanimin e mëparshëm për të siguruar ushqim për familjet e tyre, shoqërohen pandashmërisht me frikën dhe pasigurinë për jetën. Vendi nga i cili këto familje janë larguar është i rrezikshëm për to (kjo është një ndër arsyet kryesore pse janë larguar prej aty), por nevoja për të mbajtur familjen gjallë i detyron pothuajse të gjithë anëtarët të kalojnë situata të rrezikshme të mbushura me frikë e pasiguri për jetën. 14 % e familjeve që kanë 2 burime të ardhurash janë familje që kanë një të punësuar dhe pension ose ndihmë sociale nga shteti. E punësuar në këtë rast është vet gruaja.

Numri i anëtarëve që gjenerojnë të ardhura	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
0	9	18
1	31	62
2	7	14
3-5	3	6
Total	50	100

Tabela 6. Anëtarët që gjenerojnë të ardhura


Komunitetet ku banojnë familjet e ngujuara janë të sensibilizuara duke kuptuar në një masë të mirë vështirësitë ekonomike që sjell fenomeni i gjakmarrjes dhe karakterizohen nga një gadishmëri për ndihmë materiale dhe financiare ndonëse edhe ato familje vetë mund të jenë

të varfëra. Nga informacionet e mbledhura në fokus grupe, por edhe nga biseda të lira me gratë, ato u shprehen se ndihmoheshin nga familjarë dhe të afërm sidomos nga familja e gruas, pasi familjet nga ana e burrit janë njësoj të ngujuar siç ata. Një pjesë e grave merreshin edhe me punë dore dhe punime të vogla artizanale, por edhe për këto punë e kishin të vështirë të gjenin treg. Në disa familje meshkujt e shtëpisë punonin pavarësisht rrezikut për jetën me të cilin përballeshin. Por edhe për ta ishte shumë e vështirë të gjenin punë pasi nëse punëdhënësit e dinin që ata ishin target i gjakmarrjes do t'ju refuzonin punën për shkak të rrezikut me të cilin mund të përballeshin. Gratë e këtyre familjeve ku burrat punonin bashkëjetonin me frikën se ndonjë ditë ata nuk do të ktheheshin të gjallë në shtëpi. Rreziku për to ishte real dhe i përditshëm. Duket se për këtë kategori familjesh, barra kryesore për sigurimin e jetesës së tyre, bie automatikisht mbi gratë. Këto familje ishin të vendosura në Bathore, ndërsa në familjet e vendosura në periferi të Shkodrës, asnjëra nuk kishte burra të punësuar, pasi rreziku për ta ishte shumë i madh. Ky rrezik jo vetëm që frikëson këta burra, por gjithashtu, frikëson edhe punëdhënësit, duke u mohuar atyre çdo mundësi punësimi.

➤ ***Profesioni, aktiviteti që gjeneron të ardhura.***

Të pyetura se cili është aktiviteti që bëjnë për të siguruar të ardhura, gjysma e grave të intervistuar u përgjigjën se nuk kishin asnjë profesion. Kultura dhe tradita e vendit të tyre të origjinës, i ka lënë pa shkollë e pa profesion pjesën më të madhe të këtyre grave. Kur mbarojnë shkollën 9-vjeçare, atyre u vjen koha të mbyllen në shtëpi dhe të presin kërkesat për martesë (*një vajzë e mbyllur në shtëpi është një vajzë e mirë*). 12 % e grave punojnë në bujqësi në shtëpitë e tyre dhe më pak punojnë me pagesë në tokat e të tjerëve. Ndërsa një pjesë e vogël e tyre punon në rrobaqepsi, duke qënë se fasoneritë janë të shumta në Shkodër.

Orët e gjata të punës dhe pagesa shumë e ulët e bënë jetën më të vështirë për këto gra, të cilat duhet që njëkohësisht të mbajnë familjen e tyre me të ardhura dhe të shërbejnë me punët e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve. Edhe pse bashkëshortët janë të ngjuar në shtëpi dhe nuk kanë me çfarë ta kalojnë kohën e tyre, vazhdon akoma të jetë tabu e pathyer që meshkujt të ndihmojnë me punët e shtëpisë dhe në njëfarë mënyre të lehtësojnë sadopak barrën e gruas. Në kohën kur tregu i punës sa vjen e më shumë kërkon kualifikime të veçanta, këto gra janë të destinuara të dështojnë në përpjekjet që bëjnë për të siguruar një vend pune dhe të ardhura për jetesën. Të dhënat na tregojnë se 50% e grave kanë prejardhje fshatare, gjë që e vështirëson më shumë integrimin e tyre në tregun e punës në qytet. Mungesa e eksperiencës në punë të mëparshme gjithashtu është faktor pengues në gjetjen e një pune të qëndrueshme.



Grafiku 5. Profesioni

➤ **Punësimi**

Përsa i përket gjendjes së tanishme të punësimit, është shqetësues fakti që 72 % e këtyre grave janë të papuna. Kjo ndodh për shkak të disa faktorëve të cilët kanë dalë në pah edhe në këtë studim.

Ndër faktorët kryesor që kushtëzojnë këtë gjendje janë: Niveli arsimor (pjesa më e madhe me arsim 8-vjeçar), mungesa e një profesioni, përshtatje e ngadaltë me jetën e qytetit pasi pothuajse të gjitha gratë vijnë nga fshatrat e veriut, kujdesi dhe koha që duhet t’ju japin familjes së tyre të cilat kanë më tepër probleme sesa familjet normale.


Statusi i punësimit	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Punësim i rregullt	8	16
Pa punë	36	72
Punë me raste	6	12
Totali	50	100

Tabela 7. Statusi i Punësimit

12 % e grave punonin në punë të paqëndrueshme që i gjenin në mënyrë të rastësishme. Ky fakt forcon tekato ndjenjën e pasigurisë dhe të vetëvlerësimit, duke i bërë që të ndjehen të pafuqishme për t’u kujdesur për fëmijët e tyre. Ndërsa 16 % pohuan punësimin e tyre të rregullt, kryesisht në sektorin e fasonerisë, infermieri dhe arsim.

➤ **Spektori i punësimit**


Të punësuarat e rregullta janë punësuar në 63 % të rasteve në sektorin privat dhe më së shumti në rrobaqepsi. 88 % janë të siguruara, ndërsa 12 % jo, kjo nisur edhe nga informaliteti i tregut dhe i lejuar edhe nga nevoja që këto familje kanë për punë.



Grafiku 6. Sektori i punësimit

➤ ***A janë të mjaftueshme të ardhurat që siguron nga puna?***

Kjo pyetje iu drejtua grave të cilat kishin një punësim të rregullt. Siç shihet edhe nga grafiku, 38 % ishin të kënaqura me të ardhurat që mermin nga puna e tyre, duke i cilësuar ato si të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e përditshme të familjes së tyre. Përgjithësisht, këto familje kishin edhe një tjetër burim të ardhurash që mbështet burimin kryesor që është puna e tyre.



Grafiku 7. Sasia e të ardhurave


➤ *Nëse të ardhurat nuk janë të mjaftueshme, si e përballoni jetesën?*

Kjo pyetje iu drejtua të gjitha grave të intervistuar, të cilat nuk kishin të ardhura të mjaftueshme. Përgjigjet ishin surprizuese: 62 % e familjeve të ngujuara jetojnë duke marrë borxh dhe me shpresën se të tjerët do të bëjnë diçka për ta. Të afërmit, kryesisht nga fisi i gruas (të cilët nuk janë të përfshirë në ngujim), janë suportuesit kryesor të këtyre familjeve. Gjithashtu, edhe të afërm në emigracion dhe miq të tjerë të familjes, solidarizohen për t'i mbështetur, në përgjigje të nevojës që ata kanë për ndihmë. Madje edhe komshinjtë dhe familjet që jetojnë në të njëjtën lagje, herë pas here ndihmojnë me ushqime dhe gjenden pranë këtyre familjeve për t'i ndihmuar në nevojat e tyre jetësore.

15 % e grave pohojnë se i kanë sytë nga shteti për ndihmë edhe pse në 97 % të rasteve kur këto familje janë identifikuar nga shteti si familje në situatë gjakmarrje, shteti nuk ka bërë asgjë për t'i ndihmuar.

Ato kishin pakënaqësi për neglizhencën që instancat shtetërore ju kanë bërë atyre jo vetëm duke mos bërë asgjë për t'i ndihmuar, por edhe duke mohuar që kjo dukuri ka ngjuar shumë familje në territorin e Shqipërisë. Ky reagim ishte si një remineshencë që vinte nga kohët e shkuara, që është detyra e shtetit të zgjidhë problemet e popullit të vet. Një pjesë e mirë e grave nuk kishin informacion të mjaftueshëm për funksionimin e qeverisjes së sotme dhe nuk paraqisnin interes të dinin më shumë, e vetmja gjë që ju interesonte ishte që shteti të bënte diçka për to, por që as ato vetë nuk dinin se çfarë. Mosnjohja e veprimtarive të institucioneve të ndryshme shtetërore i penalizonte ato për të patur akses dhe për të përfituar prej tyre.

Në rastet e tjera, këto familje e përballojnë jetën duke bërë vetëm shpenzimet e domosdoshme për të jetuar, shpesh duke u kthyer në zakonet e të parëve për të bërë punët e përditshme (lajnë rrobat me dorë, përdorin zjarrin në vend të energjisë elektrike, gatuajnë bukën në shtëpi e të tjera). Një fenomen i dhimbshëm është edhe përfshirja e fëmijëve në punë të vështira si psh.: mbledhja e hekurave në shtratin e lumenjve, puna në të zezë në fabrikë këpucësh, ngarkimi me përgjegjësitë e punëve të shtëpisë që i bën zakonisht e zonja e shtëpisë, përgjegjesi për mbajtjen e motrave apo vëllezërve më të vegjël e të tjera.



Grafiku 8. Sasia e të ardhurave 2

➤ ***Të ardhurat që shpenzojnë gratë për veten e tyre***

Të ardhurat që shpenzoni për veten	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
0	38	76
1-5000 lekë	11	22
Nuk e di	1	2
Totali	50	98


Tabela 8. Të ardhurat që shpenzojnë gratë për veten e tyre

Niveli i të ardhurave që 76 % e grave shpenzonin për veten e tyre ishte 0 lekë. Shumica e grave u përgjigjën se nuk shpenzonin asnjë financë për kujdesin e tyre personal siç mund të jenë veshmbathje, bizhuteri apo ndonjë libër. Ato u shprehën se njerëz të ndryshëm iu jepnin gjërat që nuk ju duheshin më dhe jetonin kryesisht *me të falura*. Nevoja e tyre e madhe e shoqëruar nga niveli i lartë i papunësisë, i bën këto gra të mos plotësojnë asnjë nga nevojat personale që ka një grua në një familje të zakonshme. Ndërsa 22% e grave që shpenzojnë për veten e tyre deri në 5000 lekë, i shpenzojnë këto lekë për të blerë gjërat e domosdoshme si rroba, bojë për flokët dhe barna mjekësore, këto të fundit vetëm atëherë kur ato sëmureshin rëndë dhe marrja e tyre ishte domosdoshmëri. Vetëm njëra nga të intervistuarat u përgjigj se nuk mbante fare llogari dhe nuk e dinte se sa shpenzime bënte për veten gjatë një muaji.

➤ ***A ka ndryshuar gjendja juaj ekonomike krahasuar me kohën kur jetonit në vendbanimin tuaj të mëparshëm? Nëse po, pse?***

Siç vihet re, edhe nga paraqitja grafike, 48 % e të intervistuarave pohojnë se gjendja e tyre ekonomike është përmirësuar disi për shkak të ndihmës nga asistencë sociale që marrin, pasi janë zhvendosur në vendbanimin e tanishëm. 38 % nuk kanë kushte më të mira ekonomike edhe pse vendi në të cilin janë zhvendosur është më i zhvilluar ekonomikisht krahasuar me vendin që kanë lënë pas. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se, pjesa më e madhe e tyre nuk kanë qenë të ngujuara kur kanë qenë në vendbanimin e tyre të mëparshëm dhe, gjithashtu një pjesë e mirë e tyre nuk kanë bërë pasaportizimin në kohën e zhvendosjes së tyre në vendbanimin aktual. Një nga arsytet e mostransferimit të dokumentacionit familjar është edhe frika nga hasmi, sepse për të bërë të gjithë këtë procedurë duhet që kryefamiljari të udhëtojë në vendin e tij të origjinës. Gjithashtu, është edhe një neglizhencë nga ana e familjes, duke

shprehur kështu në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, mungesën e shpresës që ata kanë për ndonjë ndihmë konkrete nga strukturat qeveritare. Vetëm 14 % e grave treguan se gjendja e tyre ekonomike ishte më e mirë në vendbanimin aktual sesa në atë të mëparshëm. Si një faktor ndikues në përmirësimin e kësaj gjendje gratë përmendën ndihmën e vazhdueshme mujore që ato merrnin nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe kryesisht fetare. Kjo ndihmë e përmuajshme konsistonte në ushqimet bazë, veshmbathje, barna mjekësore, etj. Pra mund të themi se këto gra janë të pafuqishme ekonomikisht, krejtësisht të varura në ndihmën e faktorëve të tjerë të jashtëm dhe pa një iniciativë konkrete për të ndryshuar gjendjen e tyre dhe të familjes së tyre e aq më pak atë të komunitetit ku jetojnë.



Grafiku 9. Ndryshimi i gjendjes ekonomike


4.4. Cila është historia e familjes suaj të ngujimit

Kjo pyetje i vendosi në siklet pothuajse të gjitha gratë dhe e shprehën parehatinë edhe me gjuhën e trupit. Ishte tabu për to që kjo histori të ndahej me të panjohur, pasi “*nuk i duhet*

gja kujt dhe nuk mund të besohet lehtë”. Shumica e grave ranë dakort që t’ju përgjigjeshin pyetjeve në mënyrë sipërfaqësore pa kaluar në detaje që ato i gjykonin se mbartnin rrezik.

➤ ***Prej sa kohësh jeni të ngujuar?***

Grafiku tregon se përqindja më e lartë është ajo e grave që tregojnë për 6-10 vite ngujimi. 2% e grave ishin në situatë gjakmarrje por jo të ngujuar (pasi i ka ndodhur një vrasje në rrethin familjar tani është kjo familje që sipas rregullit të gjakmarrjes do të marr gjak mbi fisin tjetër).



Grafiku 10. Vitet në ngujim

Ndër të intervistuarat ka edhe raste të vrasjeve të njëpasnjëshme (*më vrau-e vrava, më vrau sërish - e vrava sërish*), por edhe të ngujimit për shkak të disa vrasjeve nga persona të ndryshëm të së njëjtit fis. Dhe kështu cikli vazhdon si një vorbull e zezë që përpin pa mëshirë shumë jetë, në shkelje jo vetëm të ligjit aktual të kushtetutës së Shqipërisë, por edhe të neneve të kanunit. Pjesa tjetër e familjeve kishin një shpërndarje pothuaj të njëjtë të viteve në ngujim, në intervalet 1-5 vite ngujim, 11-15 vite ngujim dhe më shumë se 15 vite. Kjo tregon për vazhdimësi të këtij fenomeni pa asnjë hije ndryshimi.

➤ ***A keni aktualisht ndonjë anëtar të familjes të ngjuar?***

Vetëm 10 % e grave raportuan se në momentin që flisnin nuk kishin asnjë anëtar të ngjuar të familjes. 90 % e tyre u shprehën se kanë familjare dhe të afërm të ngjuar dhe se çdo tentativë për pajtim dhe zgjidhje të konfliktit kishte dështuar pa arritur në një zgjidhje konkrete për faljen e gjakut. Pjesa tjetër pohonte që i kishin bërë përpjekjet vetëm në dy vitet e para duke dërguar bajraktarë dhe pleq të ndryshëm në shtëpinë e gjaksit për të kërkuar falje për njerëzit e pafajshëm, por edhe në këtë rast nuk kishin patur sukses. Kështu, në njëfarë mënyre, ata janë dorëzuar nga përpjekjet për pajtim.

A vazhdoni të jeni të ngjuar?	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Po	45	90
Jo	5	10
Totali	50	100


Tabela 9. Statusi aktual i ngujimit

➤ ***Vitet në ngujim në vendbanimin aktual***

Gjatë kryerjes së pyetësorit rezultoi se kishte gra, familjet e të cilave nuk kishin pasur probleme me gjakmarjen në vendbanimin e mëparshëm. Pra, konflikti që i ka futur ato në kthetrat e gjakmarrjes, ka ndodhur pas vendosjes së tyre në Shkodër dhe në Bathore. Kjo situatë ishte e papritur dhe e paparashikuar për to, pasi siç u shprehën kishin lënë gjithçka mbrapa për një jetë më të mirë dhe për një të ardhme tjetër për fëmijët e tyre dhe jo për t'u përfshirë në konflikte të reja.

Kjo e dhënë tregon se mjedisi nuk është totalisht përcaktues i kësaj dukurie, pa mohuar rolin e tij të rëndësishëm. Po ashtu edhe kanuni nuk është plotësisht përcaktues pasi sipas

dëshmime të grave të rinjtë konfliktuoheshin për shkaqe banale dhe e përdornin kanunin për vetë-gjyqësi, por që ata nuk e kishin lexuar asnjëherë atë (*”Nuk e njoh, vetëm kam dëgju nga nana”*). Duke mos e njohur këtë kod zakonor ata nuk iu referoheshin rregullave të tij, por pretendonin se zbatonin kanunin duke vrarë apo duke u vrarë dhe duke futur gjithë familjen dhe fisin në një zinxhir vrasjesh që nuk dukej se do të mbaronte kurrë.



Grafiku 11. Ngujimi në vendbanimin aktual

Një përqindje e vogël grash raportuan se kanë më shumë se 15 vite që familjet e tyre përjetojnë gjakmarrjen dhe disa prej tyre kishin hyrë nuse në familje të ngujuara. Edhe pse jo të shumta në numër ngarkesa emocionale dhe psikologjike e tyre ishte mjaft e rëndë, ngarkesë të cilën e shprehën me thënien: *“Na duket sikur kështu kemi lindur, me peshën dhe frikën e vdekjes mbi krye”*. Duket qartë se fakti i të jetuarit në një zonë më të zhvilluar, në të gjitha aspektet, nuk e ndalon aspak gjakmarrjen. Nga të dhënat është e dukshme që pjesa më e madhe e grave i kanë familjet 1 deri në 5 dhe 6 deri në 10 vite në ngujim në vendbanimin aktual. U vu re se disa gra të reja të moshës 23-26 vjeçare nuk e dinin saktë historinë e ngujimit të familjes së tyre, pasi ngjarja kishte ndodhur përpara se ato të martoheshin dhe madje, një pjesë të tyre nuk iu ishte bërë me dije se djali që po i kërkonte dorën për martesë vuante gjakmarrjen. Megjithatë, ato pohuan se edhe sikur ta dinin këtë fakt, ato prap do të

merrnin të njëjtin vendim pasi konsideronin se kështu e kishte shkruar Zoti për to. Pakënaqësia më e madhe e tyre ishte se nuk kishin shijuar asgjë nga jeta në çift pasi që ditët e para të jetës martesore filluan të jetonin me frikën se një ditë do ta humbisnin bashkëshortin e tyre.

➤ ***Shkaku i ngujimit***

Shkaku i ngujimit	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Vrasje që ka bërë djali	2	4
Vrasje që ka bërë burri	8	16
Vrasje që ka bërë kunati	19	38
Vrasje që ka bërë kushëri	11	22
Vrasje nga kunata	1	2
Vrasje që ka bërë babai	2	4
Vrasje e ndodhur shumë vite më parë	5	10
Burrin e kanë vrarë	2	4
totali	50	100

Tabela 10. Shkaku i ngujimit

Bashkëshortët e tyre si dhe burra të tjerë të familjes fshiheshin diku ose qëndronin të burgosur brenda katër mureve të shtëpisë. Ato nuk e kishin përjetuar ose e kishin harruar një jetesë normale në çift. Në hulumtimin e arsyeve se përse kishin ndodhur këto vrasje, të cilat kishin shënuar edhe *futjen e familjes në gjak*, në ndihmë na erdhi dhe diskutimi i fokus grupeve. Vrasjet për gjakmarrje mund të kategorizohen në dy grupe kryesore:

- a.** vrasje të vjetra për gjakmarrje të kryera edhe deri para 50-60 vitesh, madje që kur brezi i sotëm i meshkujve të përfshirë në vrasje nuk kishte lindur ende.
- b.** vrasje të reja për gjakmarrje si pasojë e vrasjes për shkaqe të ndryshme. Këto të fundit mbizotërojnë si në statistikat që ka policia e shtetit, po ashtu edhe në statistikat që kanë

organizata të ndryshme që punojnë në terren. Rreth 70 % e vrasjeve kanë ndodhur për arsye banale si zënka, sharje dhe fyerje dhe në një pjesë të tyre palët kanë qenë në gjendje të dehur. Pjesa tjetër e vrasjeve ka ndodhur për konfliktet e pazgjidhura për pasuritë e paluajtshme, për devijimin e kanaleve vaditëse në tokat bujqësore, si dhe për çështje nderi. Është e dukshme se shkaktarët që çojnë në këto konflikte janë faktorë social dhe ekonomik. Ndikimi i kanunit është një faktor tjetër gjithashtu, por nuk është një faktor përcaktues. Për këtë nisemi nga fakti që në pjesën më të madhe të vrasjeve janë të përfshirë të rinjtë e pas viteve '90, të cilët vetëm kanë dëgjuar për kanunin dhe jo vetëm që nuk e njohin atë, por që kanë bërë vrasje edhe në kundërshtim me të. Sipas dëshmive të grave, sot po vriten gra, fëmijë e klerikë, të gjitha këto vrasje të ndaluara dhe të dënuara reptësisht në kanun. Nuk po funksionon më sistemi i pleqësisë dhe ndërmjetësimit prë pajtim. Kleri nuk ka më fuqinë dhe pushtetin që ia përcakton kanuni dhe Besa nuk mbart më forcën dhe paprekshmërinë e fjalës së dhënë. Tabela e mësipërme tregon se njerëzit e përfshirë në konflikt dhe në vrasjen fillestare janë anëtarë të rrethit të ngushtë familjar: burri, kunati, kushëri i afërt, por nuk përjashtohen as ndërlidhjet farefisnore dhe ato të krushqisë. Kështu edhe pse këto familje kanë migruar në një vend më të mirë ku nuk ka pasur gjakmarrje më parë, disa prej tyre e kanë marrë me vete këtë fenomen edhe në vendbanimin e ri. Ndikimi dhe lidhja me familjen dhe fisin vazhdon të jetë e fortë pavarësisht distancës. Nuk rezultoi as nga historitë e jetës së tyre dhe as nga të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorve, që ndonjë grua të ishte e përfshirë drejtpërsëdrejti në vrasje fillestare apo në marrje gjaku. Ndërsa duhet theksuar se kur e hodhëm në diskutim në një prej fokus grupeve një shembull të tillë të trajtuar në shtypin

e përditshëm, rastin e një gruaje që për të larë gjakun e të vëllait vret një fëmijë, disa prej grave empatizoheshin me këtë rast dhe e justifikonin motivin e saj dhe krimin e bërë.


4.5. Pasojat e gjakmarrjes të gratë dhe fëmijët e tyre

Ky studim synon të evidentojë këtë kategori grash si raste tepër specifike, jo vetëm për shkak se ato vijnë nga zonat me përqendrimin më të lartë të vrasjeve me motiv gjakmarrjen, po edhe për të risjellë në vëmendje të shtetit dhe të gjithë aktorëve të tjerë të shoqërisë, të cilët janë të interesuar për zhdukjen e fenomenit. Specifikisht studimi synon përshkrimin me vërtetësi të situatës së tyre si dhe të shkallës në të cilën këto gra vuajnë pasojat e një vargu krimesh. Për këtë, iu drejtuam atyre një grup të veçantë pyetjesh.

- ***Si ka ndikuar fenomeni i gjakmarrjes në aspektin ekonomik, social dhe psikologjik?***
(Ndikimi në raportet e tyre bashkëshortore; në marrëdhëniet me fëmijët; në lidhjet me komunitetin)

Më poshtë, Grafiku 12 pasqyron të gjitha fushat mbi të cilat ka ndikuar gjakmarrja. Në intervistim nuk e përdorëm cilësimin *negativ* për të mos patur ndikim në përgjigjet që gratë do të jepnin. Të gjitha të intervistuarat janë shprehur se bëhej fjalë për ndikime negative të kësaj dukurie në raportet e tyre të përditëshme, në çdo aspekt të jetës.

Gjithashtu nga përgjigjet rezulton se përqindja më e madhe e tyre pohojnë që gjakmarrja të ketë pasur ndikim negativ në aspektin social dhe psiko-social, edhe pse një pjesë e mirë e grave i kanë zgjedhur të gjitha opsionet e dhëna.



Grafiku 12. Problemet në të cilat ka ndikuar gjakmarrja

➤ *A ka ndryshuar gjendja sociale me ndryshimin e vendbanimit*

Ndryshimi i gjendjes sociale me ndryshimin e vendbanimit	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Eshtë përmirësuar	11	31
Eshtë keqësuar	15	43
Njësoj	9	26
Totali	35	100


Tabela 11. Ndryshimi i gjendjes sociale

Pjesa më madhe e grave të intervistuar pohon se gjendja e tyre sociale është më e keqe se ajo e mëparshme. Kjo shpjegohet nga fakti se koha e lëvizjes së pjesës më të madhe të këtyre familjeve, përkon edhe me momentin e rënies në gjak dhe e ngujimit të së gjithë familjes. 69 % pohojnë se lëvizja për në vendbanimin aktual nuk e ka përmirësuar gjendjen e tyre ose e ka përkeqësuar atë, duke i lënë këto familje të zhgënjyera nga lëvizja për të gjetur një jetë

më të mirë. Ndryshimi i vendbanimit dhe integrimi i këtyre familjeve në vendbanimin e ri rezulton me ndikim pozitiv dhe ka shërbyer për të përmirësuar nga ana sociale jetën e 31 % të familjeve të shpërngulura.

➤ ***Si është përmirësuar gjendja sociale?***

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur mënyra sesi 31 % e grave e kanë jetën e tyre sociale më të përmirësuar.



Grafiku 13. Përmirësimi i gjendjes sociale

45 % e grave pohojnë se ndjehen më mirë nga mundësia që kanë për të bërë vetë pazarin dhe për sigurinë që iu jep fakti që ka më shumë shërbime publike si shkolla, spitale, rajon policie e të tjera. Nga përgjigjet e dhëna vihet re se kërkesat e tyre janë të pakta dhe modeste, shprehen të jenë të kënaqura edhe me ndryshime shumë të vogla në rutinën e tyre. Të intervistuarat deklarojnë se mjaftohen me çdo veprimtari që i nxjerr nga muret e shtëpisë dhe i bashkon ato me njerëz të tjerë siç janë koha e blerjeve në treg, vizita me raste tek të afërmit apo pjesëmarrja në aktivitete shoqërore, siç edhe pohojnë 80 % e grave që u

intervistuan krahas grave të zonës së Bathores. Aktivitetet shoqërore lidhen kryesisht me pjesëmarrje në veprimtari të shoqatave që veprojnë në terren, siç janë kurse të edukimit dhe këshillimit, si dhe disa kurse afatshkurtra rrobaqepësie, parukerie apo gatimi, ku aktualisht marrin apo kanë marrë pjesë më parë.

➤ ***Si është përkeqësuar?***

Si është përkeqësuar?	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Pa punë	6	40
Qera për vendbanim	3	20
Pa tokë bujqësore	6	40
Totali	15	100

Tabela 12. Përkeqësimi i gjendjes sociale

Gratë që pohuan një përkeqësim të situatës, shpjegojnë se megjithë përpjekjet e bëra për ndërmjetësim, jo vetëm kanë humbur shpresat për një pajtim të mundshëm, por tani kishin ngelur edhe pa punë e pa tokë bujqësore dhe me barrën për të paguar qera për shtëpinë ku ata banonin. Kjo gjë i bën ato të ndjehen të ngarkuara emocionalisht duke u bërë shkak për debate të vazhdueshme në familje. Ardhja në Bathore dhe në Shkodër nuk garanton sigurinë për jetën të personave në shënjestrën e gjakmarrjes. Gratë pohojnë se burrat janë të fshehur larg familjes, qëndrojnë të izoluar ose vuajnë dënimin në burg, por edhe për këta të fundit cikli i vrasjeve nuk është mbyllur.


➤ ***A ndiqni emisione televizive apo të radios?***

A ndiqni emisione televizive dhe të radios?	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Po	45	90
Jo	5	10
Totali	50	100

Tabela 13. Ndjekja e tv dhe radios

90 % e grave ndjekin emisione televizive dhe dëgjojnë transmetime të radios. Ato shpreheshin se për disa, ai mbetet miku i tyre më i mirë. Ndërsa disa të tjera nuk shihnin sepse nuk kishin kohë të mjaftueshme për të parë televizor ose nuk lejoheshin nga anëtarët e tjerë të familjes të ndiqnin ato emisione që u pëlqenin atyre.

➤ *Çfarë emisione ndiqni ?*



Grafiku 14 . Transmetimet që ndjekin

Grafiku tregon se çfarë e tërheq vëmendjen e grave në televizion dhe radio. Për gratë radio ishte më pak i preferuar, ndërsa nga programet televizive më të pëlqyerat për përqindjen më të madhe të të intervistuarave ishin lajmet, telenovelat, muzika e më pak emisionet e ndryshme. Këto të fundit ndiqeshin më pak duke mos pasur alternativë tjetër për të ndjekur

ose ishin të detyruara të ndiqnin ato emisione që shihnin burrat e shtëpisë. Lajmet ndiqeshin prej tyre në mënyrë që të qëndronin në koherencë me *çfarë ndodh vërdallë*. Muzika duket se ju jep një ndjenjë gëzimi. Ndërsa për preferencën në ndjekjen e telenovelave, të intervistuarat shprehen se ato u krijonin një gjendje më të mirë emocionale si dhe i shkëpusnin vëmendjen për pak kohë nga telashet e tyre të përditshme. Fundet e tyre të lumtura (*happy end*), tek një pjesë e tyre e veçanërisht tek më të rejat, krijonin ndjenjën e optimizmit dhe pse jo i bënin ato të ëndërronin. Historitë dhe heroinat e telenovelave bëheshin objekt i përditshëm i bisedave në grup, duke i ndihmuar ato që për pak kohë të shkëputeshin nga realiteti i hidhur në të cilin jetonin. Edhe pse virtual, ky realitet në një kuptim ndikonte pozitivisht në gjendjen e tyre emocionale dhe psikologjike.

➤ ***A jeni takuar ndonjëherë me ndonjë grua të famshme?***


Iu drejtuam grave këtë pyetje për të marrë një informacion mbi faktin se sa të interesuara kanë qenë gratë e politikës, të medias, të biznesit, apo të OJF të ndryshme që punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe të grave. Për këtë kategori grash iu drejtuam të intervistuarave pyetjen e thjeshtë *nëse kishin kontaktuar ndonjëherë me ndonjë grua të shquar?* Asnjëra prej grave dhe të rejave nuk kishte takuar ndonjë grua të shquar, asnjëra prej të intervistuarave nuk ishte pjesë në ndonjë forum politik ose social të grave. Ato nuk shprehnin ndonjë interes të vecantë për të pasur më shumë informacion mbi veprimtarinë e këtyre forumeve dhe u shprehën se rrallë *“shihnin ndonjë gjë në televizor për gratë në politikë dhe veprimtarinë e tyre...”*

A jeni takuar ndonjëherë me ndonjë grua të shquar	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Po	6	12
Jo	44	88
Totali	50	100

Tabela 14. Takimi me një grua të famshme

88 % e grave nuk janë takuar ndonjëherë me ndonjë grua të famshme duke pohuar se ndjehen të harruara. Ndërsa 12 % e tyre pohojnë se janë takuar me një grua të famshme, e cila ka qenë përgjithësisht drejtuese e organizatave që punojnë me grupe vulnerabël, organizata fetare, gra të politikës dhe gazetares.

➤ *Gjendja juaj psiko-emocionale e tanishme është:*



Grafiku 15. Gjendja psiko-emocionale

Nga të dhënat në këtë grafik, vihet re se të gjitha gratë në përgjigjet e tyre, pohojnë se gjendja e tyre emocionale e tanishme për përqindjen më të lartë të tyre është e pasigurt për të ardhmen e fëmijve të tyre. Ato ishin të stresuara për jetën dhe në ankth për të ardhmen e

tyre. Përveç frikës që pohuan, njëra prej tyre shfaqte shenja të dorëzimit, duke mos dashur të vazhdoj *jetën*.

➤ ***A e keni ndjerë mbështetjen psiko-emocionale të punonjësit social?***


Për to ishte krejtësisht i panjohur roli dhe funksioni i një punonjësi social. Shprehja “*të takosh një psikolog*” ishte tabu dhe kishte kuptimin se vetëm njerëzit me të meta mendore shkojnë tek psikologu. Tek to shfaqej një mungesë e theksuar shprese, që askush nuk e ka zgjidhjen për t’i ndihmuar apo për të lehtësuar sadopak stresin që ato përjetonin, vetëm nëse i nxjerrin nga situata e gjakmarrjes. Shumica e grave nuk kishin bërë ndonjë përpjekje për të kontaktuar me shoqata apo fondacione pajtimi mosmarrëveshjes dhe zgjidhje konfliktesh. Kjo për arsye të një mentaliteti të krijuar se të gjitha këto institucione ekzistojnë vetëm për të ngritur fonde e për t’u pasuruar për veten e tyre. Nuk kishin lidhje apo kontakte me punonjësit socialë të bashkisë së Shkodrës, Kamzës apo të kryeqytetit. Për vetë specifikën e këtyre familjeve në izolim, në pamundësi për të bërë vetë diçka, ndihma që kërkojnë për fëmijët e tyre janë në drejtim të arsimimit, kurseve gjithëpërfshirëse, përfshirje në aktivitete të ndryshme sociale dhe ofrim të një këshillimi të specializuar psikomjekësor.

➤ ***A mendoni se marrëdhëniet me fëmijët tuaj kanë ndryshuar për shkak të fenomenit të gjakmarrjes? Specifikoni ndryshimin.***

A kanë ndryshuar marrëdhëniet me fëmijët si rrjedhojë e gjakmarrjes?	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Po	24	48
Jo	11	22
Asnjë mendim	15	30
Totali	50	100

Tabela 15. Ndryshimi i marrëdhënieve si pasojë e gjakmarrjes

Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 35 prej grave, ndërsa të tjerat (15) u shprehën se *i kanë fëmijët të vegjël dhe nuk duan që t'iu fusin frikën për këtë problem*, duke u përpjekur që në sy të tyre të mos flasin asgjë. Ndërsa 24% pohojnë se gjakmarrja ka ndikuar në ndryshimin e marrëdhënieve të tyre me fëmijët. 11 % e grave mendojnë se ky fenomen nuk ka ndikuar në marrëdhënien e tyre as pozitivisht dhe as negativisht.




Grafiku 16. Ndryshimi i marrëdhënieve me djemtë

Nga përgjigjet që gratë dhanë se përse kanë ndryshuar marrëdhëniet e tyre me fëmijët e tyre, vërehet se shqetësimi kryesor janë fëmijët e tyre meshkuj, djemtë më të rritur. Shumica e përgjigjeve të dhëna nga gratë nëna të intervistuarat për djemtë e tyre shprehen se: *Djemtë janë më të ngarkuar se vajzat, sepse nuk flasin e mbyllen në vetvete. Kanë presion nga opinioni i të tjerëve për të marrë gjak ose rrinë brenda katër mureve të shtëpisë. Të gjitha lëvizjet i bëjnë në mënyrë të fshehtë nga frika se mos i vrasin dhe kështu nuk kanë një moment*

të qetë, por janë gjithë kohës të mërzhitur e të nevrikosur, e te tjera. Gjendja duket akoma më e rënduar në raportet mes tyre dhe djemve të cilët po kalonin fazën e adoleshencës. Sipas përshkrimit të grave nëna, ata jo vetëm që nuk ishin më nën kontrollin dhe autoritetin e tyre si prindër, por këta adoleshentë ishin gjithnjë e më shumë nën presionin edhe të shokëve apo të të afërmeve për të marrë hak. Gratë nëna, pohojnë të jenë në momente ankthi kur djemtë e tyre adoleshentë thyejnë rregullat e vendosura në shtëpi dhe dalin pa marrë parasysh rrezikun për jetën.

Në intervistat e hapura gratë tregojnë se: *“djalin unë e shoqëroj për në shkollë, madje edhe kur luan”*. Sipas pohimeve të tyre, fëmijë të shoqëruar janë fëmijë që ndjekin shkollën, ose fëmijë adolentë të cilët është e pamundur për t’u mbajtur mbyllur në shtëpi. Shoqërimi i tyre nga nëna mendohet si zgjidhja e vetme për momentin.

Gratë e intervistuar rrëfejnë se kishte raste të paraqitura edhe nga media vendase, veçanërisht në qarkun e Shkodrës, të djemve 10-12 vjeçarë të vrarë në pragun e shkollës, edhe pse sipas kanunit fëmijët nuk preken. Pyetjes se çfarë mendonin këto gra nëna për kohën kur këta fëmijë të rriten, ato shprehen se në këtë situatë të pasigurt për jetën, nuk i gëzoheshin rritjes së fëmijëve të tyre. *“Nëse nënat e tjera gëzohen, sepse mashkujt po rriten e po bëhen krah në shtëpi për të punuar, unë në çdo ditëlindje të djalit do doja që ai të zvogëlohej”* shprehet njëra prej tyre.




Grafiku 17. Ndryshimi i marrëdhënieve me vajzat

Sipas Grafikut 17, në përgjigjet rreth vajzave kemi një pamje tjetër. Vetëm gjysma e grave të ftuara në studim iu përgjigjën pyetjes së raporteve të tyre me vajzat. Një pjesë e të intervistuarave i kishin martuar vajzat dhe ato nuk prekeshin më drejtpërdrejt nga problemet e familjes prindërore. Një pjesë e tyre pohojnë se nuk kanë shumë kontakte ndërsa ato jetojnë larg me familjet e tyre; një pjesë e grave u shprehën se nuk kishin shqetësim të madh për to. Në lidhje me këtë qëndrim, njëra nga vetë vetë vajzat pjesëmarrëse në studim shprehet: *”Gjithmon jam rrit me faktin se vëllai është i zoti i shtëpisë dhe se unë kam lindur në derë të huaj, duhet me u martu se ka ardh koha.”*. Një tjetër pohim i grave ishte se vajzat nuk pyeten se çfarë mendojnë për gjendjen e familjes së tyre.

Pyetjes për të ardhmen e vajzave dhe se çfarë dëshirojnë ato, gratë shprehen se ; *”Dojnë me shku në shkollë, me dalë me shoqet, por më e mirë është martesë dhe bashkë me burrin të shkojnë jashtë shtetit”*. Nga këto pohime kuptojmë se dukuria e gjakmarrjes, jo vetëm që i lë një pjesë të fëmijëve të paarsimuar dhe veçanërisht vajzat, por ata mbeten të dëmtuar

psikologjikisht, karakterizohen nga të jetuarit me frikë, zemërim e urrejtje, dhunë psikologjike dhe nga mungesa e besimit në vetvetvete dhe tek të tjerët.

➤ ***A kanë ndryshuar marrëdhëniet brenda çiftit për shkak të ngujimit ?***




Grafiku 18. Ndryshimi i marrëdhënies në çift

Pyetja mbi ndryshimet në marrëdhëniet në çift merr përgjigje në grafikun 18. Na tregohet se një përqindje e vogël e grave pohojnë se asgjë nuk ka ndryshuar për shkak të ngujimit, Kjo kategori i përket grave që janë martuar ndërsa familja e bashkshortit ishte tashmë në gjak. Kategorizimi i përgjigjeve më frekuencë të lartë nxjerr se 29 nga gratë e martuara të intervistuar, pra përqindja me e madhe, jetojnë në grindje dhe të parespektuara nga partneri i tyre. Gratë shprehen se bashkëshortët e tyre bëhen xhelozë ndërsa janë të mbyllur brenda ose të larguar e të fshehur. Ata mendojnë se gratë kanë mundësi të dalin pavarësisht se për çfarë arsyes. Përgjigjet e të intervistuarave mbi ndryshimin e marrëdhënies në çift grupohen në; *Ai është xheloz e fanatik; unë jam xheloze; kemi zënka të shpeshta; më rreh, sidomos kur është i dehur; nuk më respekton; e të tjera*. Në këtë raport bashkëshortor të tyre,

megjithë diskriminimin që këto gra pohonin direkt apo indirekt, me zë apo me gjysëm zëri, ato shpesh përpiqeshin t'a justifikonin dhunën që burrat ushtronin ndaj tyre, duke u shprehur se “ në gjendjen që është ai unë mundohem mos me ba za; se gruaja duhet me ju bind burrit”.

➤ *Pyetjes jo të lehtë për to, se çfarë mund të thonë për marrëdhëniet e tyre intime bashkëshortore i janë përgjigjur si më poshtë:*



Grafiku 19. Marrëdhëniet seksuale

Pyetjes mbi marrëdhëniet seksuale në jetën bashkëshortore, një përqindje tejet e lartë e të intervistuarave nuk iu përgjigjën fare, duke u shprehur se është turp të flasësh për këtë temë. Një përqindje e vogël u përgjigjën me ‘mirë’. Relativisht përgjigjet lidhen me situatën në të cilat gratë e intervistuar ndodhen, ku një pjesë nuk i kanë burrat e tyre prezent në shtëpi, por mund të jenë duke vuajtur denim me burg, të fshehur larg shtëpisë ose në emigracion.

➤ *A janë marrëdhëniet në çift me ngarkesë emocionale?*

13. A ndjehesh e ngarkuar emocionalisht nga marrëdhënia në çift	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
a. Po	22	44
b. Jo	10	20
c. Asnjë mendim	18	36
Totali	50	100

Tabela 16. Ngarkesa emocionale në marrëdhënien në çift.

Në këtë rubrikë vërehet se ndihen të ngarkuara emocionalisht brenda marrëdhënies së tyre në çift përqindja më e madhe e grave (44 %), zgjedhin të mos japin asnjë mendim (36 %), shpreheshin për gjendje të tilla emocionale si: *e mërzhitur, në ankth 20 %, e mërzhitur, në ankth, shqetsohem për gjënë më të vogël, e mbyllur 98 %*. Një pjesë e tyre sqarojnë se nëse ato do të shfaqnin shenja nervozizmi askush nuk do të merakosej për to, madje mbi to do të bjerë i gjithë inati i mbledhur. Ato shprehen se *“kur është burri me nerva duhet me ba durim e mos me ba za, se përndryshe ma tregon vendin”*. Sipas përshkrimeve të të intervistuarave ato e shohin veten si paqebërëset në situata të vështira: *“Ne si gra duhet gjithmon me shujt zjarrin dhe nëse burri është keq, gruaja duhet me ba çmos ta qetësojë gjendjen.”*

➤ *A e ndjeni përkrahjen e fqinjëve?*

A ndjeni përkrahjen e fqinjëve	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Po	35	70
Jo	15	30
Totali	50	100

Tabela 17. Përkrahja e fqinjëve

Të pyetura për rolin e fqinjëve dhe përkrahjen ndaj tyre, nga tabela e mësipërme vëmë re se shumica e grave të intervistuar ndiheshin të përkrahura prej tyre (70 %), por përsëri është një përqindje e konsiderueshme (30 %), të cilat u shprehën se nuk ndiheshin të përkrahura nga fqinjët në situatën e tyre dhe kur kishin nevojë.

➤ **Lloji i përkrahjes së fqinjëve**

Nëse po kush dhe si ju ka ndihmuar	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Kur keni nevojë	19	50
Kërkoni ndihmë në momente të vështira	14	37
Nuk na bezdisin	5	13
Totali	38	100

Tabela 18. Lloji i përkrahjes së fqinjëve

Tabela 18 paraqet mbështetjen që gratë e intervistuar kanë nga fqinjësia e tyre dhe kryesisht bëhet fjalë për gratë fqinje, ku shumica prej tyre raporton se e gjen një lloj mbështetje tek to dhe që deri diku ndajnë me to disa nga problemet e tyre.

Përqindja më e madhe e grave shprehen se kërkojnë ndihmë në momente të vështira. Ajo që bie në sy është se marrëdhëniet e fqinjësisë funksionojnë. Kjo sipas shpjegimeve të grave, ndodh sepse shumica prej tyre janë edhe të afërt ose nga i njëjti fshat apo rreth, afërsia e zakoneve dhe e mentaliteteve me banorë të tjerë të ardhur nga zona të tjera, e sidomos nga ato veriore, bën që këto raporte të vendosen lehtësisht dhe të ruhen gjatë. Mbi lidhjet me fqinjësinë dhe marrëdhëniet e mira mes tyre njëra nga gratë e intervistuar shprehet:


-“*Kam shku shpesh dhe sa herë që shkoj më vështirë më duket situata e tyre. Nji ditë kur shkova, m’kujtohet sesa ngjendje t’keqe e kishte G. të shoqin, nuk mund të shihej me sy.*

Dukej që edhe kishte pi raki nga mërzija dhe gruen e tij nuk e duronte dot kur bante muhabet me mu. I biri i saj, një djal 13 vjeçar, dukej veçanrisht i trishtum, por që duke qenë akoma i vogël nuk e kuptonte taman situatën e frigen. Jeta me frikë nga hasmi e pa t'ardhuna që bajn ata nuk ka fjal me e përshkrue.”

Një pjesë e të intervistuarave pohojnë se kur fqinjët kanë origjinë nga zona të ndryshme nga ajo e tyre, është e vështirë që të krijojnë marrëdhënie me ta dhe se meshkujt e familjes janë më dyshues ndaj këtyre lidhjeve, sidomos kur fqinjët vijnë nga zonat urbane. 5 nga gratë e kanë parë si “bekim” që fqinjët nuk iu sjellin telashe, sepse në rastin e tyre ata iu frikësohen edhe ngjarjeve të tilla.

4.6. Çfarë ka ofruar ndryshimi i vendbanimit dhe pritshmëritë për të ardhmen

➤ *Zhvendosja në Shkodër dhe Bathore ka qenë vendim i:*




Grafiku 20. Vendimi për zhvendosjen

Për përqindjen më të madhe të grave vendimmarrja ka qenë e përbashkët e meshkujve të familjes dhe vetë gratë nuk janë të përfshira në të. Është bashkëshorti që vendos si dhe

anëtarët e tjerë të familjes, siç janë prindërit e bashkëshortit, në shumë raste edhe kunetërit, madje edhe xhaxhallarët e tij, kjo në rastet kur të gjithë këta jetojnë së bashku në një shtëpi. Djali i madh i familjes gjithashtu është pjesë e kësaj vendimmarrje, ndërsa vajzat e shtëpisë nuk mban asnjëherë këtë pozicion. 29 % janë përgjigjur për vendim personal të burrit si kryefamiljar dhe 3 % kanë vjehrrin si vendim-marrës të kësaj lëvizjeje. Vetëm në 2 raste gratë pohuan se vendimi ishte i tyre, sepse “*unë e nxita burrin të iknim*” dhe ato u dëgjuan për këtë arsye; ‘*ne jemi familje e vogël dhe nuk jetojmë me vjehrrin dhe vjehrrën*’.

➤ ***A u ndjetë e frikësuar fillimisht kur u zhvendoset nga vendi i origjinës?***



Grafiku 21. Ndjesia e frikës nga zhvendosja


Në këtë rubrikë fokusohemi tek frika e zhvendosjes nga vendi i origjinës. Vihet re se përqindja më e madhe e grave (65 %) pohojnë të kenë qënë të frikësuar për atë që do të gjenin në vendbanimin e ri. 35 % e tyre u shprehën se fakti që vendi i ri ishte më i madh dhe më i zhvilluar, u jepte atyre siguri dhe i bënte të ndjeheshin “*më afër shtetit*”.

Nëse po pse ?	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Pasiguri nga vendi i ri	14	52
Frikë nga gjakmarrja.	13	48
Pasiguri ekonomike	5	19
Totali	27	100

Tabela 19. Arsyet e frikës nga zhvendosja

Shqetësimi i grave për vendin e ri vinte nga *pasiguria* për atë që do të gjenin (52 %) në vendin ku do të shpërnguleshin, si edhe nga *frika e gjaksit* (48 %). Më pak (19 %) ia faturonin frikën *pasigurisë ekonomike*.

➤ ***A jeni identifikuar nga shteti si një familje në gjakmarrje ?***



Grafiku 22. Identifikimi nga shteti si familje në gjakmarrje

Të dhënat e këtij grafiku pasqyrojnë se 32 % e grave u përgjigjën se shteti nuk di asgjë për to. Një numër i vogël grash (10 %) u përgjigjën se nuk kishin informacion për këtë gjë, 58% e grave pohuan dijeninë e shtetit për situatën e tyre dhe një përqindje e vogël pohojnë se kanë të afërm në burg ose që shteti i kërkon. Por pavarësisht kësaj, 97 % e këtyre grave pohuan se shteti nuk ka bërë asgjë për familjet e tyre. Shumica e të intervistuarave shprehet se familjet e tyre fshihen dhe nuk duan të jenë të identifikueshme për arsye sigurie për jetën, si dhe nuk besojnë se duke iu drejtuar organeve qeverisëse ata do të bëjnë dicka për të zgjidhur problemin e tyre. Përgjigjet e dhëna rezultojnë të përkojnë edhe me të dhënat nga Policia e Shtetit, e cila raporton se në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë janë të identifikuar vetëm 8 raste të familjeve të prekura nga gjakmarrja. Prej këtyre një familje është nga Tirana dhe të tjerat kanë migruar në Tiranë e përkatësisht 2 familje nga Tropoja, 2

nga qarku i Shkodrës, 1 nga Kukësi, 1 nga Mirdita dhe 1 nga Dibra. Ky fakt na lë të kuptojmë se numri i familjeve të ngujuara në rrethinat e qyteteve të mëdha, si janë Tirana, Durrësi apo Shkodra, duhet të jetë më i lartë nga sa raportohet në të dhënat zyrtare.

➤ ***A mendoni se për fenomenin e gjakmarrjes është e drejtë të zbatohet:***

Për fenomenin e gjakmarrjes është e drejtë të zbatohet	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Ligji	33	66
Kanuni	5	10
Te dyja	10	20
Asnjë mendim	2	4
Totali	50	100

Tabela 20. Instrumentat ligjor për gjakmarrjen

Sipas pasqyrimin të përgjigjeve në Tabelën 20, vërehet se një përqindje e lartë e grave të intervistuar (66 %) janë përgjigjur në favor të ligjit, sepse sipas tyre *atë që nuk e ban kanuni e ban ligji*. Ndërsa një pjesë jo e vogël e të intervistuarave, prej 20 % e sheh zgjidhjen e situatës të kanuni dhe ligji. 10 % e tyre mendonin që duhet të zbatohet kanuni. Gratë sqarojnë se shpresonin një mundësi për pajtim tek zbatimi i kanunit, gjë që ligji nuk t'a krijonte, sepse sipas tyre *ligji e dënon atë që vret dhe deri tani nuk ka bërë asgjë*. Të pyetura nëse kishin dijeni mbi ligjin për ndërmjetësim, ato shprehen se nuk kanë dijeni. Ndërkohë, një pjesë shumë e vogël e grave zgjedhën opsionin se nuk kanë asnjë mendim, duke shpjeguar se *nuk kanë shpresë as tek ligji dhe as tek kanuni*.

➤ ***Çfarë mund të ndikojë në zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes?***

Në tabelën 21 më poshtë, pasqyrohet opinioni i grave të intervistuar mbi zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë përgjigjur duke zgjedhur

më shumë se një opsion. Gratë e intervistuar bashkohen në mendimin që ndërhyrja e shtetit dhe e shoqatave fetare është një faktor i mundshëm për zgjidhjen e situatës së tyre apo të zbutjes së fenomenit të gjakmarrjes në tërësi. 22 % e tyre rendisin në opsionet e zgjidhjes si një faktor që do të ndikojë në zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes edhe komunitetin ku ato ishin vendosur. Një numër i vogël pranonë alternativën e pleqësisë dhe iniciativës së tyre personale, duke pohuar në përgjithësi se gruaja është tolerante dhe ka rol në mosnxitjen për të marrë hak, por nuk ishin të bindura nëse ky rol mund të ishte i rëndësishëm. Vetëm njëra nga gratë e shihte si faktor ndikues shkollimin e fëmijëve.


Në zbutjen e fenomenit mund të ndikojë	Denduria Absolute	Denduria Relative në %
Iniciativa juaj personale	7	14
Komuniteti ku u zhvendoset	11	22
Shteti	47	94
OJF/shoqata fetare	31	62
Zoti	6	12
Pleqesia	7	14
Grupim	1	2
Edukimi i femijeve	1	2

Tabela 21. Faktorët që ndikojnë në zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes

➤ ***Si e mendoni të ardhmen tuaj dhe të fëmijëve tuaj?***

Grafiku 23, tregon përgjigjet e grave të anketuara rreth planeve, qëllimeve dhe shpresave të tyre për të ardhmen. Në këtë anketim u përdorën pyetjet e hapura me qëllim motivimin e tyre apo për të shprehur lirisht mendimet e tyre. Duke qënë se përgjigjet ishin në një variacion të lartë, klasifikimi i tyre u bë sipas shpeshtësisë. Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, kuptojmë se përqindja më e madhe e grave shprehnin frikë për të ardhmen (42 %), një pjesë e mendonte të keqe dhe të vështirë (30 %), një pjesë (14 %) shpresonte në sigurinë

që vjen nëse ndodh pajtimi i gjakut. Ato nuk u shprehën për asnjë plan apo qëllim personal për të ndryshuar situatën, megjithëse jetonin me shqetësimin e madh të së ardhmes jo për veten e tyre, por për jetën e fëmijëve të tyre. Përgjigjet treguan se gratë jo vetëm që nuk tentonin të gjenin një rrugëdalje, por edhe se nuk kishin ndonjë besim se mund të bënin ndonjë gjë dhe ndiheshin krejt të pafuqishme në këtë aspekt.



Grafiku 23. Shpresa për të ardhmen

Ndërsa kishte edhe nga ato që rrefuzonin të mendonin për të ardhmen dhe disa të tjera që e shihnin zgjidhjen “*larg Shqipërisë*”. Një karakteristikë e dytë e përbashkët e përgjigjeve të tyre ishte frika dhe mungesa e shpresës, e thënë ndryshe në një sintezë duket se gratë e familjeve të ngujuara në Shkodër dhe Bathore jetojnë sikur të mos jenë.

4.7. Përmbledhje e rezultateve të intervistimit.

Intervistimi u krye me 50 gra të familjeve që ndodhen në situatë gjakmarrjeje. Pjesa më e madhe e grave të intervistuar janë në moshën 36-45 vjeçe dhe karakterizohen nga një nivel i ulët arsimor. Në më të shumtën e rasteve gratë janë të martuara, por ka edhe gra që janë kryefamiljare për shkak se burrat e tyre kanë humbur jetën nga gjakmarrja. Familjet janë me

4-7 anëtarë në pjesën më të madhe të tyre dhe numri i djemve është më i madh se ai i vajzave. Këto familje janë zhvendosur kryesisht nga Dukagjini, Tropoja e Kukësi dhe kanë marrë me vete edhe situatën e tyre të vështirë ekonomike nga vendet e origjinës. Kjo gjendje e vështirë vjen për shkak të ngujimit të kryefamiljarëve dhe djemve në moshë për punë. Gjithashtu, niveli i ulët arsimor i grave si dhe mungesa e një profesioni është faktor përgjegjës për gjendjen në të cilën ndodhen. Të ardhurat e qëndrueshme të tyre vijnë kryesisht nga ndihma sociale që shteti siguron për to si të papuna dhe prej pensionit që ndonjë nga fëmijët merr për shkak të humbjes së kryefamiljarit. Vetëm pak gra punojnë në një punë të qëndrueshme, përgjithësisht në fasoneri dhe ndër to ka edhe të pasiguruara. Mungesa e punës e vështirëson tej mase jetën e tyre, duke mos siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe duke i bërë këto familje të jetojnë me shpresë se dikush tjetër do të vijë t'i ndihmojë. Kjo gjë i mbush me frikë e pasiguri për të ardhmen dhe nuk iu lë hapësirë për një jetë normale.

Familjet e këtyre grave janë në ngujim në pjesën më të madhe të rasteve që prej 6-10 vjetësh, por nga ana tjetër, ka gra që i kanë familjet e tyre të ngujuara që prej më shumë se 15 vjetësh. Por veç kësaj, ka edhe gra që familjet e tyre sapo janë ngjuar. Kjo shpërndarje flet për një vazhdimësi të fenomenit të gjakmarrjes, pavarësisht vendbanimit të tyre të ri. Kjo tregon se mjedisi nuk është përcaktues (edhe pse nuk mund të mohohet roli i tij) në vazhdimësinë e fenomenit. Shkak për ngujimin e këtyre familjeve kanë qenë vrasje të kryera nga bashkëshorti dhe rrethi i ngushtë i familjes (kunati, xhaxhai i burrit, vjehri).

Gjakmarrja shkakton tek këto gra efekte negative të shumfishta siç janë: ngarkesë në gjendjen e tyre social-ekonomike, psikosociale, marrëdhëniet e tyre në çift, me fëmijët dhe me komunitetin. Këto gra i gëzohen ardhjes në vendbanimin e ri për shkak të shtimit të

numrit dhe spektrit të shërbimeve publike dhe e vlerësojnë faktin që ato vetë mund të bëjnë pazarin dhe që mund të kryejnë nevoja të tjera që ka familja jashtë mureve të shtëpisë. Ato e shohin këtë si një mundësi për të dal nga izolimi e për të harruar për një moment realitetin e ngujimit të familjes së tyre.

Nga ana tjetër, ato vuajnë faktin se ardhja në vendbanimin e ri kërkon më shumë të ardhura për të përballuar jetesën dhe kërkesat në rritje të fëmijëve, ndërkohë që ato vuajnë nga niveli i lartë i papunësisë. Ato e ndjejnë veten të harruar nga shteti dhe në mes të së gjithë kësaj, duket se kanë gjetur si të vetmin mjet argëtimi telenovelat, muzikën dhe lajmet.


Në gjendjen e tyre psiko-emocionale gratë karakterizohen nga stresi, frika dhe pasiguria për të ardhmen e familjes së tyre. Ndërsa flasin për të ardhmen ato ndjehen të pasigurta, pa shpresë dhe me frikë. Ato e shohin veten të pafuqishme për të ndikuar në situatën e tyre dhe gjithë fuqinë dhe kompetencat për të zbutur fenomenin ato ia faturojnë shtetit dhe zbatimit të ligjit në më të shumtën e rasteve. Emigrimi jashtë Shqipërisë ishte gjithashtu një alternativë e mundshme për të ardhmen e fëmijëve të tyre.

4.8. Pyetësi Nr. 2 për historinë e traumës

4.8.1. Analiza e të dhënave të pyetësit për historinë e traumës.

THQ - Për të evidentuar traumën të cilën gratë kanë përjetuar kemi përdorur pyetësin e historisë së traumës (Trauma History Questionary, THQ, Green 1996) versionin e shkurtuar për qëllim të këtij studimi. Në vijim, janë një seri pyetjesh rreth ngjarjeve jetësore serioze dhe traumatike. Këto lloj ngjarjesh në fakt ndodhin me një farë rregulli, edhe pse do të donim të besonim që janë të rralla dhe që ato ndikojnë rreth mënyrës sesi njerëzit u ndjenë, si reagues, dhe nëse menduan për gjërat më pas. Duke ditur që gjëra të tilla ndodhin dhe duke njohur reagimin ndaj tyre, do të na ndihmojë të zhvillojmë programe për parandalim, edukim dhe shërbime të tjera. Pyetësi është i ndarë në pyetje që mbulojnë eksperiencat e traumës dhe pyetje për fatkeqësi të përgjithshme të traumës. Më poshtë, po i klasifikojmë dhe komentojmë ngjarjet ndaj të cilave gratë janë ekspozuar në të kaluarën e tyre. Gjithashtu, duhet të mbajmë ndër mend se përveç ngjarjes së madhe traumatike, këto gra janë nën një frikë dhe presion të vazhdueshëm për jetën dhe sigurinë e bashkëshortëve dhe të fëmijëve të tyre djem, duke qenë se ata janë të kërcënuar nga gjakmarrja. Edhe një zile telefoni në orë të vona mund të jetë për to një sinjal që ju kujton traumën që ka ndodhur në të shkuarën, ose që ngjall një frikë të brendshme për shkak të pasigurisë që shkakton ky fenomen.

4.8.2. Ngjarje të lidhura me krimin



Grafiku 24. Ngjarje të lidhura me krimin

Ishte vetëm njëra nga gratë e intervistuar që konfirmoi një rast, kur mbi të ishte ushtruar dhunë nga dikush, që po përpiqej t'a grabsite.

Asnjëra nga të intervistuarat nuk kishte kaluar situata grabitjesh të sendeve personale apo të hyrjes me dhunë në shtëpi, kur ato kanë qenë apo nuk kanë qenë prezente.

4.8.3. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma

Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma	Po	Jo
A keni pasur ndonjëherë një aksident serioz në punë?	5	45
A keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi natyrore?	20	30
A keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi të shkaktuar nga dora e njeriut?	0	50
A jeni ekspozuar ndonjëherë ndaj kimikateve të rrezikshme ose radioaktive?	0	50
Keni qënë ndonjëherë në një situatë tjetër gjatë së cilës ju u lënduat rëndë?	2	48
A keni qënë ndonjëherë në një situatë gjatë së cilës ju patët frikë se mund t'ju vrisnin ose mund të lëndoheshit rëndë ?	10	40
A keni parë ndonjëherë dikë të lënduar rëndë ose të vrarë ?	50	0

Tabela 22. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma (1)

Në tabelë janë paraqitur përgjigjet e grave në vlera absolute përsa i përket përjetimeve të fatkeqësive të përgjithshme dhe traumave.

- *A keni pasur ndonjëherë një aksident serioz në punë, me makinë ose diku tjetër? (Nëse po, ju lutem specifikoni më poshtë).*

5 nga gratë u përgjigjën se kishin pasur raste kur kishin pësuar aksidente në punë (3) dhe me makinë (2), ndërsa 45 prej tyre nuk kishin kaluar asnjë gjë të tillë.

- *A keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi natyrore si tornado, stuhi, përmbytje ose tërmet të rëndë, etj, ku ndjetë se ju ose ndonjë nga të dashurit tuaj ishte në rrezik për jetën ose për t'u lënduar?*

20 gra kanë kaluar të paktën një përmbytje të shtëpisë dhe tokës rreth saj.

- Pyetjes nëse *“keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi të shkaktuar nga dora e njeriut si psh. përplasje treni, shembje ndërtese, vjedhje në bankë, zjarr e të tjera, ku ndjetë se ju ose ndonjë nga të dashurit tuaj ishte në rrezik për jetën ose për t’u lënduar?”*

Gratë u përgjigjën se nuk kishin asnjë rast të tillë dhe as nuk ishin gjendur të ekspozuara ndonjëherë ndaj kimikateve të rrezikshme ose radioaktive, të cilat mund të kërcënonin shëndetin e tyre?

- *Keni qënë ndonjëherë në një situatë tjetër gjatë së cilës ju u lënduat rëndë? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë).*

2 gra kanë kaluar një situatë lëndimi të rëndë në jetën e tyre, ato rrëfejnë se kanë qënë plagosur me armë zjarri.

- *A keni qënë ndonjëherë në një situatë gjatë së cilës ju patët frikë se mund t’ju vrisnin ose mund të lëndoheshit rëndë?*

10 gra kanë kaluar në situata në të cilat ato kanë pasur frikë se do t’i vrisnin.

Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma	Po	Jo
A keni parë ndonjëherë trupa të vdekur	35	15
A ju është vrarë ndonjëherë një mik i afërt ose anëtar i familjes, ose ju është vrarë nga një shofer i pirë?	39	11
A keni pasur ndonjëherë një bashkëshort, partner romantik ose fëmijë që ju ka vdekur?	15	35
A keni pasur ju ndonjëherë një sëmundje të rëndë	3	47
A keni marrë ndonjëherë një lajm për një lëndim të rëndë, një sëmundje që ka rrezikuar jetën, ose vdekje e papritur e një të afërmit tuaj ?	50	0
A ju është dashur të angazhohen në luftime për shërbimin ushtarak në një luftë?	0	50

Tabela 23. Fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma (2)

- *A keni parë ndonjëherë dikë të lënduar rëndë ose të vrarë?*

Të gjitha pranuan se kishin parë të paktën një të vrarë gjatë jetës së tyre. Në tabelën e mësipërme gratë vazhdojnë t'iu përgjigjen pyetjeve për fatkeqësi të përgjithshme dhe trauma.

- *A keni parë ndonjëherë trupa të vdekur (përveç rasteve të funeraleve) ose jeni përballur me trupa të vdekur për ndonjë arsye tjetër?*

35 gra treguan se kanë parë trupa të personave të vrarë.

- *A ju është vrarë ndonjëherë një mik i afërt apo anëtar i familjes, ose është vrarë nga një aksident me makinë që ngitej nga një shofer i pirë?*

39 gra kishin përjetuar humbjen e një mikut të afërt ose anëtar të familjes së tyre.

- *A keni pasur ndonjëherë një bashkëshort, të afërm ose fëmijë që ju ka vdekur?*

15 gra kanë përjetuar një humbje të bashkëshortit ose edhe të fëmijës.

- *A keni pasur ju ndonjëherë një sëmundje të rëndë që ju ka rrezikuar jetën?*

3 gra pohojnë se janë duke vuajtur nga tumori.

- *A keni marrë ndonjëherë një lajm për një lëndim të rëndë, një sëmundje që ka rrezikuar jetën, ose vdekje e papritur e një të afërmi tuaj?*

Të gjitha kanë marrë të paktën një herë një lajm për lëndim të rëndë, sëmundjen ose vdekjen e të një prej tëafërmeve të tyre.

- *A ju është dashur të angazhoheni në luftime për shërbimin ushtarak në një luftë të një zone zyrtare ose jozyrtare?*

Asnjë nga gratë nuk kanë qënë ndonjëherë të angazhuara në luftime për shërbimin ushtarak.

4.8.4 Përmbledhje e rezultateve të pyetësorit për historinë e traumës

Nga sa më sipër, duke parë edhe nga grafikët dhe të dhënat që kemi paraqitur në tabelë, të gjitha gratë që janë pjesë e kampionit tonë kanë përjetuar në të shkuarën e tyre së paku një ngjarje të rëndë traumatike. Ky fakt, është një nga kriteret kryesore që i bën këto gra të jenë vulnerabël ndaj çrregullimit të stresit post traumatik. Gjithashtu, një nga arsyet pse kemi paraqitur më sipër të gjitha pyetjet e pyetësorit me të gjitha përgjigjet e grave, është edhe që të kuptojmë më shumë natyrën dhe intesitetin e traumës me të cilën këto gra janë përballur. Edhe pse gra të ndryshme janë përballur gjatë jetës së tyre me trauma të ndryshme dhe jo me të njëjtin numër traumash, ato kanë diçka të përbashkët që është e shfaqur edhe në këtë pyetësor.

Trauma më e madhe me të cilën të gjitha gratë janë përballur është shkaktuar nga fenomeni i gjakmarjes ose nga një vrasje që ka qenë shkak për futjen e familjes së tyre në këtë cikël vrasjesh, vetëgjyqësie dhe vetëmohim lirie.

Pra, qëllimi për përdorimin e pyetësorit të traumës nuk ishte vetëm të shikonim nëse këto gra ishin përballur në jetën e tyre me një ngjarje traumatike, por gjithashtu edhe të shikonim nëse kjo ngjarje traumatike ka lidhje të drejtpërdrejtë ose indirekte me fenomenin e gjakmarrjes.

4.9. Rezultatet e pyetësorit PSS-i

Në fillim u zhvillua matja e besueshmërisë së pyetësorit. Për këtë qëllim, u zhvillua testi i Cronbach alfa (α), vlera e të cilit ishte .860. Kjo vlerë është mjaft e lartë dhe tregon që ky test është mjaft i besueshëm për të kryer vazhdimin e hulumtimit.

Në tabelat në vazhdim janë paraqitur mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për secilin artikull, për secilën shkallë si dhe për vlerën totale të çrregullimit të stresit post traumatik.

➤ *Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për ripërjetimin*

Artikujt për ripërjetimin	MA	DS
A keni pasur ne mënyrë të përsëritur mendime të bezdisshme të dhimbshme ose kujtime rreth traumës	2.46	.71
A keni pasur ne mënyrë të përsëritur ëndrra të këqija ose ankth rreth traumës	2.10	.79
A keni pasur eksperiencë sikur papritur po rijetoni traumën, parafytyrime veprime ose ndjenjë sikur po rindodh?	1.78	.76
A keni qenë në mënyrë intensive emocionalisht e mërzhitur kur kujtoni traumën?	2.88	.33
A keni pasur reagime fizike intensive kur keni kujtuar traumën?	1.90	.71

Tabela 24. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për ripërjetimin

Vlerat e prezantuara në tabelën e mësipërme janë më të larta për mënyrën intensive të së ndjerit emocionalisht e mërzhitur, kur kujtohet trauma (2.88) dhe për mënyrën e përsëritur të mendimeve të bezdisshme të dhimbshme ose kujtimet rreth traumës (2.46). Vlerat në tabelë janë të ulta për prezencën e reagimeve fizike intensive, kur është kujtuar trauma dhe vlerat më të ulta shënohen për eksperiencat sikur papritur rijetohet trauma, përmes parafytyrimeve, veprimeve ose ndjenjave sikur po rindodh.

➤ **Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shmangien**

Artikujt për shmangie	MA	DS
A jeni përpjekur në mënyrë të vazhdueshme për të shmangur mendimet ose ndjenjat që lidhen me traumën	2.40	.86
A jeni përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të shmangni aktivitete, situata ose vende që ju kujtojnë traumën	1.96	.86
A ka ndonjë aspekt të rëndësishëm të traumës që ju akoma nuk mund ta tregoni	.29	.61
A keni humbur dukshëm interes për aktivitetet në kohë të lirë që kur ka ndodhur trauma	2.20	.97
A jeni ndjerë të shkëputur apo të ndarë nga të tjerët rreth teje që kur ka ndodhur trauma	1.86	.88
A keni ndjerë që aftësia juaj për të përjetuar të gjitha emocionet është dobësuar	1.71	.91
A keni ndjerë që ndonjë plan ose shpresë për të ardhmen kanë ndryshuar për shkak të ngjarjes	2.58	.785

Tabela 25. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shmangien

Ndjesia që ndonjë plan ose shpresë për të ardhmen ka ndryshuar për shkak të ngjarjes ka rezultuar në (2.58) dhe përpjekja në mënyrë të vazhdueshme për të shmangur mendimet ose ndjenjat që lidhen me traumën ka rezultuar në (2.40). Këto të dyja kanë fituar vlerat më të larta të mesatares aritmetike. Ndër vlerat më të ulta renditet pyetja: A jeni ndjerë të shkëputur apo të ndarë nga të tjerët rreth teje që kur ka ndodhur trauma, e cila ka shënuar vlerat (1.86), si dhe pyetja: “A keni ndjerë që aftësia juaj për të përjetuar të gjitha emocionet është dobësuar”, e cila ka paraqitur vlerën (1.71). Me interes është artikulli: “A ka ndonjë aspekt të rëndësishëm të traumës që ju akoma nuk mund ta tregoni?” dhe është treguar me vlerat (.29). Kjo rubrikë ka treguar vlerat më të ulta nga të gjithë artikujt e tjerë të pyetësorit.

➤ **Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për hiperzgjimin**

Artikujt për hiperzgjim	MA	DS
A keni patur vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë	2.38	.67
A keni qenë vazhdimisht të irrituar ose keni patur shpërthime inati	1.59	.91
A keni patur vështirësi të vazhdueshme për t'u përqendruar	2.29	.71
A jeni ju tepër alert që nga trauma	2.28	.73
A keni qenëtë nevrikosur dhe që trembeni menjëherë që nga trauma	1.90	.74

Tabela 26. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për hiperzgjimin

Prezantimi i artikujve për hiperzgjimin tregon që vlerat më të larta janë fituar për vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë, e përfaqësuar me vlerën (2.38); vështirësi të vazhdueshme për t'u përqendruar, me vlerën (2.29) dhe të qenit më tepër alert që nga trauma shënon vlerën (2.28). Vlera të ulta të këtyre artikujve janë për pyetjen: A keni qenë të nevrikosur dhe që trembeni menjëherë që nga trauma, e cila ka shënuar vlerën (1.90), si dhe artikulli i pyetjes: A keni qenë vazhdimisht të irrituara ose keni pasur shpërthime inati, ka shënuar vlerën më të ulët të simptomave të hiperzgjimit vlerën (1.59).

4.9.1. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shkallët e PSS-I

Shkallët	MA	DS
Ripërjetimi	10.90	2.80
Shmangia	12.54	4.14
Hiperzgjimi	10.00	2.93
Total PTSD	33.50	8.67

Tabela 27. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shkallët e PSS – I

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, mund të kemi një përfundim më të qartë, ku vlerat më të larta të mesatares aritmetike janë prezantuar për sjelljet shmangëse me vlerën (12.54), ndërkohë që sjelljet e ripërjetimit (10.90) dhe sjelljet e hiperzgjimit (10.00) janë pothuajse të përbashkëta, me një ndryshim të vogël për sjelljet e hiperzgjimit që kanë shënuar vlerat më të ulëta në këtë pyetsor. Vlerat totale të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik janë paraqitur në mesatare 33.50, që do të thotë se, po të kemi parasysh vlerat maksimale të fituara nga PSS-I (51), vlera e fituar nga pjesmarrëset në hulumtimin tonë, mund të konsiderohet si shfaqje me tendencë ashpërsie të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik.

Kategoria e popullsisë që ne po studiojmë nuk është e madhe në numër dhe për rrjedhojë edhe kampioni që ne kemi zgjedhur nuk është shumë i madh, por është përfaqësues për këtë grup. Për shkak të numrit të vogël të pjesmarrëseve në këtë hulumtim ne zhvilluam korrelacionin e Spearman-it, kjo për të zbuluar lidhshmërinë që kanë shkallët e çrregullimit të stresit post traumatik ndërmjet tyre si dhe me vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik. Vlerat korrelative të fituara janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme. Siç shihet nga tabela, të gjitha shkallët kanë një lidhje të fortë pozitive me njëra-tjetrën, e cila është e rëndësisë statistikore, duke variuar në vlerat -.534 - .895.

Koeficientët e korrelacionit ndërmjet shkallëve

Spearman's rho	PTSD totale	Hiperzgjimi	Shmangia	Ri - perjetimi
rhoCoefficient	1.000	.778**	.895**	.845**
Sig. (2-tailed)	.	.000	.000	.000
rhoCoefficient	.778**	1.000	.534**	.634**
Sig. (2-tailed)	.000	.	.000	.000
rhoCoefficient	.895**	.534**	1.000	.624**
Sig. (2-tailed)	.000	.000	.	.000
rhoCoefficient	.845**	.634**	.624**	1.000
Sig. (2-tailed)	.000	.000	.000	.
N	50	50	50	50

** . Korrelacioni është significant në nivelin 0.01 (2-tailed).

Tabela 28. Koeficientët e korrelacionit ndërmjet shkallëve

Për të parë dallimet në shkallët e veçanta të çrregullimit të stresit post traumatik dhe në pikët totale të saj, për sa i përket ndryshoreve demografike, të tilla si niveli i arsimimit, punësimi, profesioni, statusi civil, statusi ekonomik i familjes etj, ne kemi zhvilluar analizën ANOVA. Si analizë post hoc kemi përdorur Bonferronin. Anova një kahëshe për shkallën e depresionit total me moshën e pjesmarrëseve nuk ka gjetur ndryshime signifikante në variancën e depresionit përmes moshave të pjesmarrëseve të përfshira në këtë hulumtim ($F(27) = 1.130$, $p = .388$;) (figura në vijim).




Figura 1. Mesatarja e çrregullimit të stresit post traumatik totale sipas moshës së pjesmarrëseve.

Nuk mund të themi të njëjtën gjë për analizën e Anova-s një kahëshe për shkallën e ripërjetimit, pasi vlerat e fituara të analizës tregojnë që pjesmarrëset me moshë të ndryshme, kanë nivel të ndryshëm në shkallën e ripërjetimit ($F(27) = 2.110$, $p = .039$;) (figura në vijim).




Figura 2. Mesatarja e ripërjetimit sipas moshës së pjesmarrëseve

Analiza e Anova-s një kahëshe për shkallën e shmangies nuk tregoi dallime të rëndësishme statistikore në varësi të moshës së pjesmarrëseve. Vlerat e fituara të analizës janë: ($F(27) = .933$, $p = .572$) (figura në vijim).




Figura 3. Mesatarja e shmangies sipas moshës së pjesmarrëseve

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për analizën e Anova-s një kahëshe për shkallën e hiperzgjimit, e cila nuk tregoi dallime të rëndësishme statistikore në varësi të moshës së pjesmarrëseve. Vlerat e fituara të analizës janë: ($F(27) = 1.041$, $p = .466$;) (figura në vijim).




Figura 4. Mesatarja e hiperzgjimit sipas moshës së pjesmarrëseve

Anova një kahëshe për shkallën e depresionit total për statusin civil të pjesmarrëseve, nuk ka gjetur ndryshime domethënëse në variancën e depresionit, pavarësisht nëse janë të martuara, të divorcuara apo beqare pjesmarrëset e përfshira në këtë hulumtim. Vlerat e

fituara nga Anova janë: për ripërjetimin ($F_{2(47)} = 1.084, p = .347$); për shmangien ($F_{2(47)} = 1.0344, p = .364$); për hiperzgjimin ($F_{2(47)} = .936, p = .399$) dhe për vlerat totale të depresionit ($F_{2(47)} = .991, p = .379$).

Figurat në vazhdim tregojnë vlerat e prezantuara për secilën shkallë. Figurat tregojnë që në ripërjetim, shmangie dhe vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik, vlerat më të larta janë paraqitur nga pjesmarrëset që janë të veja.




Figura 5. Mesatarja e ripërjetimit sipas statusit të pjesmarrëseve.




Figura 6. Mesatarja e shmangies sipas statusit të pjesmarrëseve




Figura 7. Mesatarja e hiperzgjimit sipas statusit të pjesmarrëseve




Figura 8. Mesatarja e çrregullimit të stresit post traumatik totale, sipas statusit të pjesmarrëseve

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e fituara për të tre shkallët e pyetësorit si dhe për vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik. Për të parë dallimet e mundshme u zhvillua ANOVA një kahëshe dhe rezultatet treguan që nuk ka dallime të rëndësishme statistikore ndërmjet pjesmarrëseve në hulumtim, pavarësisht nivelit të tyre të arsimimit,

përsa i përket shkallës së ripërjetimit, shkallës së shmangies, shkallës së hiperzgjimit apo edhe vlerave totale të çrregullimit të stresit post traumatik.




Figura 9. Vlerat për shkallët e çrregullimit të stresit post traumatik dhe vlera totale, sipas nivelit të arsimit.

Tabela në vazhdim paraqet vlerat e shkallëve dhe të çrregullimit të stresit post traumatik sipas numrit të fëmijëve të pjesëmarrëseve në hulumtim.

Numri i fëmijëve	Riperjetimi	Shmangia	Hiperzgjimi	PTSD totale
	3	3	3	3
MA	8.00	7.67	9.00	24.67
Std. Deviation	5.196	2.517	1.732	7.095
	8	8	8	8
MA	10.25	10.75	10.38	31.38
Std. Deviation	4.334	5.258	4.596	13.362
	15	15	15	15
MA	11.07	13.13	10.27	34.73
Std. Deviation	2.187	4.324	3.173	7.968
	10	10	10	10
MA	12.20	13.70	10.60	36.50
Std. Deviation	1.619	1.947	1.265	3.837
	5	5	5	5
MA	11.00	15.20	9.60	35.80
Std. Deviation	1.581	3.114	2.191	5.891
	3	3	3	3
MA	12.33	14.33	10.33	37.00
Std. Deviation	1.528	4.041	1.155	6.557


Tabela 29. Mesatarja aritmetike dhe devijimi standard për shkallët e PSSI sipas numrit të fëmijëve

Për të parë dallimet e mundshme në nivelin e të tre shkallëve, si dhe të vlerës totale të çrregullimit të stresit post traumatik tek pjesmarrëset tona, në varësi të numrit të fëmijëve që kanë, ne zhvilluam analizën e ANOVA-s me post hoc test Bonferroni. Rezultatet e kësaj analize janë të paraqitura më poshtë. Siç është evidente, ka dallime mjaft të vogla të rëndësisë statistikore në të gjitha shkallët si edhe në vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik në pjesmarrëset, në varësi të numrit të fëmijëve që kanë.

	Shuma e katrorëve	Shkallët e lirisë	Mean Square	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	51.209	5	10.242	1.339	.269
Me grupet	290.700	38	7.650		
Total	341.909	43			
Ndërmjet grupeve	158.261	5	31.652	2.097	.087
Me grupet	573.467	38	15.091		
Total	731.727	43			
Ndërmjet grupeve	8.084	5	1.617	.186	.966
Me grupet	331.075	38	8.713		
Total	339.159	43			
Ndërmjet grupeve	429.657	5	85.931	1.257	.302
Me grupet	2596.775	38	68.336		
Total	3026.432	43			

Tabela 30. Vlerat e ANOVA-s për shkallët e PSS I dhe PTSD totale sipas numrit të fëmijëve

Se si janë të shpërndara këto vlera në mënyrë grafike, na i tregon grafiku më poshtë.



Grafiku 25. Vlerat për shkallët e PTSD dhe PTSD totale, sipas numrit të fëmijëve

Punoni ne sektorin:	MA	DS	Gabimi Std. MA
Privat	35.00	8.287	3.132
Publik	28.50	9.327	4.664
Privat	11.43	2.299	.869
Publik	11.25	2.062	1.031
Privat	12.43	4.276	1.616
Publik	9.25	5.058	2.529
Privat	11.14	3.237	1.223
Publik	8.00	2.944	1.472

Tabela 31. Vlerat e MA dhe DS për shkallët e PSS I dhe PTSD totale sipas vendit të punësimit

Më sipër, në tabelën 40 kemi paraqitur të dhënat në mesatare aritmetike të vlerave dhe devijim standard për dallimet në nivelin e shkallëve të çrregullimit të stresit post traumatik tek pjesëmarrëset që punojnë në sektorin publik dhe ato që punojnë në sektorin privat.


Vlerat e T-testit për punësimin në të tre shkallët dhe në vlerën totale të PTSD.

	t	df	Sig. (2-tailed)	MA Difference	Gabimi Std. Difference
PTSD totale	1.199	9	.261	6.500	5.420
Riperjetimi	.128	9	.901	.179	1.393
Shmangia	1.114	9	.294	3.179	2.853
Hiperzgjimi	1.596	9	.145	3.143	1.969

Tabela 32. Vlerat e T-testit për punësimin në të tre shkallët dhe në vlerën totale të PTSD.

T-testi për grupe të pavarura nuk tregoi dallime të rëndësishë statistikore. Vlerat e t-testit janë të paraqitura në tabelën më poshtë. Kjo do të thotë që, si pjesmarrëset që punojnë në sektorin publik, ashtu edhe pjesmarrëset në hulumtim që punojnë në sektorin privat, nuk kanë dallime ndërmjet tyre në nivelin e përjetimit të shkallëve të PTSD si dhe në vlerat totale të saj.

Grafiku më poshtë paraqet vlerat sipas sektorit të punësimit.



Grafiku 26. Vlerat për shkallët e PTSD dhe PTSD totale, sipas sektorit të punësimit

Për të përcaktuar dallimet ndërmjet statusit të punësimit në momentin kur e kanë plotësuar pyetësonin, me vlerat e shkallëve dhe vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik, ne zhvilluam analizën ANOVA.

Vlerat e MA dhe DS për shkallët e PSS I dhe PTSD totale sipas statusit të punësimit

	Ri - perjetimi	Shmangia	Hiperzgjimi	PTSD totale
	8	8	8	8
MA	11.50	11.75	10.50	33.75
Std. Devijimi	2.507	3.919	3.207	8.447
	35	35	35	35
MA	10.80	12.43	9.91	33.23
Std. Devijimi	3.085	4.401	2.944	9.274
	6	6	6	6
MA	10.67	14.67	9.83	35.17
Std. Devijimi	1.633	2.582	3.189	6.795

Tabela 33. Vlerat e MA dhe DS për shkallët e PSS I dhe PTSD totale sipas statusit të punësimit

Anova një kahëshe për shkallën e depresionit total për statusin e punësimit aktual të pjesëmarrëseve nuk ka gjetur ndryshime signifikante në variancën e çrregullimit të stresit post traumatik, pavarësisht nëse janë të punësuar në punë të rregullta, të papunësuar apo të punësuar në punë të rastësishme. Vlerat e fituara nga Anova janë: për ripërjetimin ($F_{2(46)} = 1.778, p = .803$); për shmangien ($F_{2(46)} = .933, p = .401$); për hiperzgjimin ($F_{2(46)} = .134, p = .875$) dhe për vlerat totale të PTSD ($F_{2(46)} = .123, p = .884$). Figurat e më poshtme paraqesin edhe vlerat përkatëse.




Figura 10. Mesatarja e PTSD totale sipas statusit të punësimit




Figura 11. Mesatarja e hiperzgjimit sipas statusit të punësimit




Figura 12. Mesatarja e shmangies sipas statusit të punësimit




Figura 13. Mesatarja e përjetimit sipas statusit të punësimit.

Për të zbuluar ndikimin e variablave të ndryshme në çrregullimin e stresit post traumatik, ne përdorëm analizën regressive. Në rastet kur si variabla predikatore u vendosën niveli i arsimimit, statusi civil, numri i anëtarëve të familjes, niveli i të ardhurave në familje, statusi aktual i punësimit, punësimi në sektorin publik apo privat, apo vitet në ngujim, vlerat e fituara nga analiza nuk treguan rëndësi statistikore. Kjo do të thotë që asnjë nga variablat e lartpërmendura nuk janë variabla predikatore për vlerat e çrregullimit të stresit post traumatik.

Kur në ekuacionin regresiv çrregullimi i stresit post traumatik u përcaktua si variabël e varur, ndërkohë që mosha e pjesëmarrëseve u përcaktua si variabël e pavarur (prediktive), fillimisht, është parë shkalla e korrelacionit në mes vlerave të të dy ndryshoreve. Korrelacioni është pozitiv dhe tregon një lidhshmëri të moderuar ndërmjet variablave ($r = .361$). Ekuacioni i regresionit tregoi vlerë të rëndësishme statistikore $F(1,48) = 7.190$ $p = .010$, me masë të fuqisë shpjeguese $R^2 = 13\%$. Rezultatet treguan që 13 % e shkallës së çrregullimit të stresit post

traumatik mund të shpjegohen nga mosha e pjesmarrëseve, ndërkohë që përqindja tjetër mund të shpjegohet nga faktorë të tjerë.

Ekuacioni i dytë regresiv: Çrregullimi i stresit post traumatik u përcaktua si variabël e varur, ndërkohë që numri i fëmijëve të pjesmarrëseve u përcaktua si variabël e pavarur (prediktive). Shkalla e korrelacionit në mes vlerave të të dy ndryshoreve tregoi që korrelacioni është pozitiv dhe tregon një lidhshmëri të dobët ndërmjet variablave ($r = .279$). Ekuacioni i regresionit tregoi vlerën statistikore $F(1,42) = 3.972$ $p = .053$, me masë të fuqisë shpjeguese prej vetëm $R^2 = 8.6\%$. Ky rezultat 8.6% , do të thotë që vetëm kjo përqindje e shkallës së çrregullimit të stresit post traumatik mund të shpjegohet nga numri i fëmijëve që kanë pjesmarrëset tona, ndërkohë që përqindja tjetër mund të shpjegohet nga faktorë të tjerë.

4.10. Përmbledhja e rezultateve të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik

Gratë në këtë studim shënuan vlera mjaft të larta për shmangien e mendimeve dhe ndjenjave lidhur me traumën. Vlera të tjera të larta të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik u shënuan në lidhje me ndryshimin e planeve dhe me mungesën e shpresës për të ardhmen. Gratë kanë qenë të hapura dhe janë përpjekur që të flasin e t'iu tregojnë edhe të tjerëve çdo aspekt të traumës. Me shumë mundësi kjo ka qenë një nga mënyrat sesi gratë kanë kërkuar ndihmë nga njerëzit e tyre të afërt për mbështetje mbas ngjarjes traumatike. Në një farë mënyre duke folur aspektet e traumës dhe mënyra sesi ato janë ndjerë, ato kanë ndihmuar edhe veten e tyre për shërim.

Këtu mund të vërtetohet edhe teoria që parashtruam më sipër, që edhe pse gratë kanë predispozita më të larta se sa burrat për t'u prekur nga çrregullimi i stresit post traumatik,

ato janë më të mira dhe iu vjen më natyrshëm domosdoshmëria në kërkimin e ndihmës dhe mbështetjes pas traumës.

Të intervistuarat në studim kanë shënuar vlera të larta në rubrikën e hipervigjilencës dhe veçanërisht në vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë.

Në të gjithë këtë pyetësor vlerat më të larta të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik janë për sjelljet shmangëse, ndërsa në dy rubrikat e tjera, atë të ripërjetimit dhe të hipervigjilencës, vlerat e shfaqura ishin të ngjashme. Kishin vetëm një diferencë të vogël, duke shënuar më ulët sjelljet e hipervigjilencës.

Duke ditur që vlera totale e çrregullimit të stresit post traumatik është 33.50 nga 51 vlera maksimale të mundshme, kjo tregon që pjesmarrëset në hulumtimin tonë kanë shfaqur me intensitet të lartë simptomat e çrregullimit të stresit post traumatik dhe madje me një tendencë ashpërsie.

Nga studimi i bërë është arritur në përfundimin që mosha e pjesmarrëseve nuk tregoi dallime me rëndësi statistikore për simptomat e çrregullimit të stresit post traumatik.

Statusi civil i pjesmarrëseve nuk ka shfaqur ndryshime domethënëse në variancën e depresionit, pavarësisht nëse gratë janë të martuara, të divorcuara, të veja apo beqare. Megjithatë vlerat më të larta të ripërjetimit, shmangies dhe vlerave totale të çrregullimit të stresit post traumatik janë paraqitur më të larta nga pjesmarrëset që janë të veja. Pjesmarrëset në studim nuk kanë shënuar dallime të rëndësishme statistikore mes nivelit të arsimimit të tyre dhe shkallës së ripërjetimit, hiperzgjimit, shmangies, apo vlerave totale të çrregullimit të stresit post traumatik.

Gjenden dallime mjaft të vogla të rëndësisë statistikore në të gjitha shkallët dhe në vlerat totale të çrregullimit të stresit post traumatik të pjesmarrëseve tona, në varësi të numrit të fëmijëve që kanë.

Punësimi gjithashtu nuk është një variabël që ndikon në shfaqjen e simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik. Kjo do të thotë që si pjesmarrëset që punojnë në sektorin publik, po ashtu edhe ato që punojnë në sektorin privat nuk kanë dallime ndërmjet tyre në përjetimet e shkallëve të çrregullimit të stresit post traumatik.

Gjithashtu statistikatat nuk kanë treguar ndryshime domethënëse në variancën e çrregullimit të stresit post traumatik, pavarësisht nëse janë të punësuar në punë të rregullta, të papunësuar apo të punësuar në punë të rastësishme. Në praktikë kjo gjë duket e pabesueshme, por fakti që statistika në studimin tonë nuk tregon ndryshim të madh, mund të jetë për shkak se pjesa më e madhe e grave në studim janë të papunësuar dhe raporti i krahasimit është i pabalancuar.

Për të treguar lidhjen mes variablave, morëm si variabla predikatore nivelin e arsimit, statusin civil, numrin e anëtarëve të familjes, nivelin e të ardhurave të familjes, statusin aktual të punësimit, sektorin e punësimit dhe vitet në ngujim. Këto variabla nuk janë predikatore për çrregullimin e stresit post traumatik.

Korrelacioni mes variablës së varur që është çrregullimi i stresit post traumatik dhe variablës së pavarur që është mosha e pjesmarrëseve, është pozitiv dhe tregon një lidhshmëri të moderuar ndërmjet dy variablave. Masa e fuqisë shpjeguese ishte 13 %. Këto rezultate

tregojnë se 13 % e shkallës së çrregullimit të stresit post traumatik mund të shpjegohet nga mosha e pjesëmarrëseve, ndërkohë që pjesa tjetër e përqindjes shpjegohet nga faktorë të tjerë.

Në ekuacionin e dytë regresiv ku çrregullimi i stresit post traumatik u përcaktua si variabël e varur dhe numri i fëmijëve të pjesëmarrëseve u përcaktua si variabël e pavarur, shkalla e korrelacionit tregoi që kjo lidhje është positive , por vetëm me një lidhshmëri të dobët me masë të fuqisë shpjeguese vetëm 8.6 %. Kjo do të thotë që vetëm 8.6% e shkallës së çrregullimit të stresit post traumatik mund të shpjegohet nga numri i fëmijëve që kanë gratë në studim. Ndërkohë që përqindja tjetër mund të tregohet nga faktorë të tjerë të marrë në studim.

4.11. Analiza e intervistave të hapura dhe e fokus grupeve

Në studimin tonë, përveç pyetsorëve standart që u plotësuan nga të gjitha gratë pjesë e kampionit, kemi zgjedhur që të paraqesim më poshtë 6 nga 10 intervistat e grave që ishin të hapura për të treguar më shumë rreth historisë së tyre. E bëmë këtë me qëllim për të kuptuar aspekte të tjera të cilat mund të kenë mbetur të paidentuara nga pyetësi, si dhe për të pasur një ide më të qartë rreth mënyrës sesi këto gra jetojnë. Çdo person pasi u informua për qëllimin dhe formën e përdorimit të materialit, u intervistua personalisht pa prezencën e dikujt tjetër. Pas intervistave kemi paraqitur edhe materialin e marrë nga dy fokus grupet, njëri i bërë në qytetin e Shkodrës dhe tjetri në Bathore. Të dy këto fokus grupe u mblodhën në ambjentet e dy fondacioneve humanitare që janë shumë aktive në ndihmën e familjeve të ngujuara në zonat përkatëse. Në fund të intervistave dhe fokus grupeve kemi përmbledhur faktorët social dhe psikologjik që evidentohen në çdo rast.

4.11.1. Intervistat individuale

Katër nga gjashtë intervistat e para janë historitë e jetës së 4 personave që vuajnë fenomenin e gjakmarrjes. Dy intervistat e tjera janë dhënë nga persona të cilët nuk vuajnë fenomenin, por që njohin dikë të ngjuar. Kjo është bërë për të parë sesa shumë empatizoheshin këto të fundit me shoqet e tyre, familjet e të cilave janë të ngjuara.

Intervista nr. 1

Në intervistën e parë kemi marrë në pyetje A, mosha e së cilës është 46 vjeçe. Ajo është një grua e ve dhe ka një vajzë 13 vjeçe. A ka lëvizur në Tiranë nga vendbanimi i saj i mëparshëm Burreli, që në vitin 1995. Në profesionin e saj është infermiere, por në Tiranë e ka të vështirë për të gjetur një punë të qëndrueshme prandaj të ardhurat e saj vijnë kryesisht nga punët sezonale që ajo bën dhe nga një përkrahje sociale që ajo merr. Ishte viti 1996 kur ajo e gjeti burrin e saj të vrarë në derën e shtëpisë. A. thotë: *"Dita më e vështirë e jetës time ka qënë ajo ditë dhe asnjëherë nuk kam për ta harruar kur e gjeta burrin tim, njeriun me të cilin kam ndarë pjesën më të madhe të jetës si të mirat ashtu edhe të këqijat, të mbuluar në gjak në derën e shtëpisë. Unë ngela tashmë fillikat vetëm pa asnjë njeri përkrah pasi edhe njerëzit e mi i kam larg. Pamjen e mjerueshme të asaj dite dhe shpërfytyrimin e bashkëshortit tim të vrarë e kam të ngulitur në kokë dhe kurrë nuk kam për ta harruar"*.

Atë mëngjes, një ditë e ftohtë dhjetori, kisha një lloj shtrëngimi brenda vetes e ndoshta ajo mund të këtë qënë edhe një parandjenjë e asaj që do të vinte më pas. Mendoja se jeta ime do të ndryshonte shumë për më mirë duk qënë se erdhëm në Tiranë. Tashmë ishim larg syve të gjaksëve dhe në një vend më të madh. Por vrasja e tim shoq ndryshoi cdo mendim që unë

kisha për jetën time aty. *Ma vranë burrin për të larë gjakun e dikujt që vrau xhaxhai i tij, sepse nga anët tona –thotë ajo- ky është zakoni, jemi gjaknxehtë dhe nuk kemi logjikë në situata të tilla.*

Jeta e tanishme më duket e pashpresë dhe e frikshme. Jam fillikat e vetme dhe më një vajzë që rritet dita ditës. E mora vesh pas disa kohësh se kush m'a kishte vranë burrin tim, por kam frikë dhe ndihem e pafuqishme për të bërë diçka, jo vetem për veten por edhe për jetën e vajzës sime të vetme. Jetoj tani vetëm për të dhe t'i krijoj asaj një të ardhme më të mirë se timen. Askush nuk ka bërë ndonjëherë dicka për mua. Shpresat më kanë humbur. Unë jam e papunë me një vajzë në shkollë dhe me një ndihmë sociale qesharake nga shteti, që nuk më dalin as për të paguar drita dhe ujë. Gjendja në të cilën ndodhem nuk më jep kurajo për të ecur përpara. Por është ky fëmijë që më mban gjallë, e vetëm për të unë do të mbijetoj. E tregoj historinë time sepse shpresoj që dikush do të më dëgjojë dhe do të më ndihmojë në situatën në të cilën ndodhem. Vajza e di çfarë i ka ndodhur të atit dhe vazhdimisht më pyet për të dhe më ka pyetur edhe për personin që i ka marrë jetën babait të saj. Më kanë ikur fjalët dhe e kam pasur shumë të vështirë për t'ia shpjeguar. E rritur në një kohë tjetër nga ajo e mëparshmja ajo nuk arrin ta kuptojë se sa lehtë mund të merret jeta këtu në Shqipëri.

Edhe pse realiteti që atë e rrethon është i hidhur, të dyja të vetme në këtë botë dhe pa asnjë mbështetje, përsëri për të shpresa se jeta ka edhe gjëra të bukura, koha që ajo kalon në shkollë me shoqet dhe shokët, e bëjnë të jetojë çdo ditë. Pavarësisht të gjithave, kthimi në shtëpi dhe përballja me fytyrën time të heshtur e të trishtuar i tregon asaj realitetin në të cilin ndodhemi, edhe pse unë mundohem që të hiqem sikur jam e lumtur dhe se i kam gjerat nën kontroll.

”Dita më e vështirë e jetës time ka qënë ajo ditë dhe asnjëherë nuk kam për ta harruar kur e gjeta burrin tim, njeriun me të cilin kam ndarë pjesën më të madhe të jetës si të mirat ashtu edhe të këqijat, të mbuluar në gjak në derën e shtëpisë.” “Por është ky fëmijë që më mban gjallë, e vetëm për të unë do të mbijetoj. Mundohem që të qesh dhe të bëj sikur jetoj”.

Këto shprehje të shkëputura nga intervista e mësipërme janë një tregues i qartë i gjendjes psikologjike të kësaj gruaje. Mungesa e shpresës shoqërohet me faktin se jeta për të është thjesht një detyrë që ajo duhet ta jetoj për vajzën e saj. Pra në këtë moshë të re ajo është bërë e padukshme jo vetëm për njerëzit që e rrethojnë, por edhe për veten e saj.

Intervista nr. 2

Në intervistën nr. 2 kemi L. një grua 30 - vjeçare e martuar dhe me dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë. Është shpërngulur nga vendbanimi i saj i mëparshëm Mirdita drejt Tiranës në vitin 2005. Që përpara se të vinim këtu ishim në gjak – tregon grua. Një histori gjakmarrjeje e cila fillon për një copë tokë.

“Një nga komshinjtë që kishim atëherë shtynte gardhin e shtëpisë duke na zënë tokën tonë. Vjehrrin im doli një ditë dhe bëri fjalë me të dhe kjo arsye e bëri komshiun të vriste vjehrrin. Më pas burri im vrau komshiun. Burri dhe djali m'u ngujuan, por bashkë me ta edhe jeta ime morri fund, tanimë jetoja në një ferr të vërtetë. Duke shpresuar për një jetë më të mirë për ne e sidomos për djalin tonë, vendosëm që të zhvendosemi në Bathore. Menduam që të paktën këtu djali nuk do ta kalonte jetën i ngjuar, Brenda katër mureve të shtëpisë dhe pa shkollë. Por asgjë nuk qe aq e lehtë me shpërnguljen tonë. Këtu u përballëm me

kushte shumë të vështira dhe me papunësi. Nëse më parë kishim shtëpi e tokë që punonim, këtu jemi pa tokë e pa punë dhe jemi duke jetuar në një kasolle. Djali shkon vetëm në shkollë e askund tjetër, gjithmonë i shoqëruar nga ne, ndërsa burri rrallë herë del. Vështirësitë janë të mëdha. E di që kështu nuk mund të shtyhet jeta, jemi vetëm me një pension të vjehrrës dhe unë ndonjëherë qëndis me hak. Nuk e shikoj dot burrin tek rri në shtëpi i ngrysur dhe në sytë e tij shoh gjithmonë të qënurin pa shpresë. E di, jeta nuk shtyhet kështu, por nuk kam çfarë të bëj. Të ardhmen e shoh pa shpresë dhe gjëja që më mundon më shumë është e ardhmja e fëmijëve të mi dhe veçanërisht e djalit tim. Ai tashmë po rritet dhe po i kupton gjërat shumë mirë, por të mos jetuarit të jetës ashtu siç e dëshiron, e bën atë akoma dhe më të mërziur.

Në këtë intervistë kemi një identifikim që gruaja bën si e ngujuar bashkë me burrin, duke e quajtur këtë ngujim një ferr. Mungesa e shpresës për të ardhmen është evidente edhe tek kjo grua. Kjo grua gjithashtu nuk e llogarit jetën e vet, ndihet e pafuqishme për t'i ndryshuar gjërat dhe është e mbushur plot me frikë për jetën e burrit dhe të djalit të saj.

Intervista nr. 3

Në intervistën nr. 3 kemi Margaritën, një vajzë 18 - vjeçare e cila ka mbaruar shkollën 8-vjeçare dhe familja e së cilës është në gjak. Nuk e ka vazhduar shkollën e lartë edhe pse kishte shumë dëshirë, por mungesat dhe vështirësitë financiare e kanë ndaluar. Është motra e madhe dhe jeton në shtëpi me 2 motrat e tjera dhe vëllain i cili është 15 vjeç.

-Më përshkruaj një ditë tënden!

M - *“Përgjithësisht bëj punët e shtëpisë dhe ngelem gjithë ditën pastaj në televizor. Ndonjëherë dal për të bërë pazarin me nënën dhe rrallë herë blej ndonjë rrobë. Më pëlqen shumë të vishem bukur dhe kaloj shumë kohë duke i veshur rrobat që kam vetëm për t’u parë para pasqyrës. Shumicat e tyre m’i kanë dhuruar të tjerët, shoqet ose komshijtë, m’i falin mua kur nuk ju duhen më,”* tregon ajo.

- Çfarë mendoni kur shikoni mamanë tuaj kaq të preokupuar për këtë situatën në të cilën ndodhet familja juaj?

“Më dhimbset në shpirt, por s’kam çfarë t’i bëj” - thotë M: *“Kur ajo qan më trishton shumë dhe më bën edhe mua për të qarë. Ka plot raste që qaj vetëm, fshehurazi në krevatin tim para se të fle gjumë. Nëna pikëllohet shumë dhe është në zi të vazhdueshme për vëllain tim të madh që nuk jeton më, duket sikur as ajo nuk po jeton më. Është si hije në shtëpi, hije e gjallë”*.

-Kur nëna thotë që vajzat janë “të huaja në shtëpinë e tyre” dhe gjithmonë flet për djemtë, ti si ndihesh?

M- *“Unë e di dhe jam rritur me idenë që vëllai është i zoti i shtëpisë dhe se unë bashkë me motrat e mia të tjera duhet me u martu dhe me shku tek shtëpia e burrit, e kuptoj dhe nuk më vjen keq kur e dëgjoj të flasë ashtu. Mua biles më ka ardhur koha për t’u martuar”*.

-Si ndiheni me situatën që ndodhet familja juaj?

M - *“Më frikëson ideja që mund të ndodhi një vrasje, rrëmbim apo ndoshta marrje peng. Kam frikë edhe të rri në shtëpi vetëm”*.

-A mund të pajtoheni me një gjendje të tillë?

M- *“Nuk kam çtë bëj tjetër, do ta pranoj e do pajtohem edhe pse është shumë e vështirë me jetu kështu e me pranë që vllain e madh e kam të shtrir n’dhe e jo gjall në shpi.”*

-Si mendoni, a ka shpresë për ndryshim të situatës në të ardhmen?

M- *“Mendoj se po, do të ketë ndryshim dhe gjërat duhet të përmisohen. Nuk shtyhet e gjithë jeta kështu.”*

-Më trego për dëshirat dhe shpreasat që ti ke për të ardhmen?

M- *“Dëshira ma e madhe asht me shku në shkollë, me pas mundsi me dal më shoqet e që një dit kur të martohem të mund të jetoj jashtë shtetit bashkë me burrin tim”.*

-Si mendoni, a mund të bëhet pajtimi i gjaqeve dhe të falni familjen tjetër?

M – *“Shteti ska ba gja për ne në situatën në të cilën jemi. E nëse shteti nuk ka bërë asgjë si mund ta fal unë gjakun? Do ta marr unë vet gjakun e do ta vras vrasësin e vllait tim. Ndoshta kjo është zgjidhja më e mirë e situatës se kështu nuk jetohe më, nuk shtyhet më kjo gjendje.”*

-Nuk ke frikë se po të vrasësh dikë do të marrin gjak dhe do të vrasin vëllain e vetëm që ke?

M- *“Me të nuk kan pun se jam unë që do t’i vras, nuk do i vras vllai . Po qenë trima le të më vrasin mua. Fundja më mir vdekur e me nder sesa kjo jetë mizerje.”*

-Si mendon a është më mirë të praktikohet kanuni apo të zbatohet ligji shqiptar?

M – *“Të praktikohet kanuni ma mir. Me ligjin policia i fut vrasësit në burg dhe pas pak kohësh ata paguajnë lek dhe dalin prej burgut pa e bërë dënimin e merituar. Nuk është e lehtë me vra njerin. Shteti me ligj nuk vret, kurse me kanunin ata që vrasin vriten.”*

-A e ke lexuar ndonjëherë Kanunin?

M – *“Nuk e kam lexu asnjëherë, vetëm kam degju kur flasin të shpisë për të.”*

- Nëse nuk e ke lexuar ndonjëherë kanunin, atëherë pse mendon që praktikimi i tij është një zgjidhje më e mirë sesa zbatimi i ligjit ?

M- *“As vetë s’e di, dua thjesht të vendos drejtësinë në vend dhe të vras vrasësin e vllait tim. Kaq du, asgjë tjetër.”*

Ndërsa bënim intervistën me M situata ishte shumë e ngarkuar psikologjikisht. Ndërsa fliste kishte momente që qante dhe qeshte në të njëjtën kohë. Për shkak të moshës së saj të re, ndryshe nga intervistat më sipër, kjo vajzë kishte shpresë se e ardhmja do të ishte më e mirë. Vihet re një luhatje e madhe e humorit dhe e gjendjes psikologjike. Në një moment ndjen frikë saqë nuk mundet as të qëndrojë në shtëpi e vetme dhe në një moment tjetër kërkon të vrasë dhe të jetë e hapur që ta vrasin të tjerët. Gjithashtu kërkon të zbatohet kanuni edhe pse nuk e njeh fare atë. Kush vret do të vritet, kjo është gjithçka që i interesonte.

Interviste nr. 4

Në intervistën nr. 4 kemi paraqitur historinë e një gruaje 34 vjeçare, nënë e dy fëmijëve me vendbanim në Tropojë. e me dy fëmijë dhe me vendbanim në Tropojë. Është në burg duke kryer dënimin për një vrasje që ka bërë. (Historia e E tregohet nga një shoqe e saj D, familja e së cilës nuk është në gjak).

Në fillim E jetonte familjarisht në Tropojë. Vëllezërit e saj dhe i shoqi shkonin shumë mirë me njëri tjerin dhe punonin gjithë kohën bashkë në ndërtim. Shpresat për një jetë më të mirë

ishin të mëdha sepse burri punonte dhe sillte të ardhura të mira në shtëpi. Menduan se me kalimin e kohës do të mund të ndryshonin shtëpi, e se do të largoheshin nga ajo barangë në të cilën kishin jetuar për aq shumë kohë, që kur ishin martuar. Por këto mbetën thjesht shpresa dhe dëshira që kurrë nuk u realizuan. Ngjarja ndodhi në një natë të ftohtë dhjetori, E. po merrej me fëmijët e vegjël dhe po përpiquej t'i vinte në gjumë. Kohë më parë ajo kishte dëgjuar për një ngatresë të vjetër të vjehrrit të saj me komshinë për çështje toke. Por ngaqë kishte kaluar shumë kohë që atëherë dhe gjërat dukeshin sikur ishin qetësuar nuk e mendonin kurrë atë që ngjau. Fëmijët e hasmit ishin larguar jashtë shtetit dhe për një moment ata menduan e të gjitha gjërat e shkuara ishin harruar. Derisa një ditë djali i hasmit u kthye nga jashtë dhe i vrau jo vetëm bashkëshortin, por edhe vëllezërit e saj. E. kishte një urrejtje të pakontrollueshme ndaj tyre. Dhe kjo urrejtje kaq e madhe nuk e lejoi që të mendonte më gjatë për të mirën e fëmijëve të saj, djalit dhe vajzës, por e nxiti drejt marrjes së gjakut dhe vrasjes së hasmit. Duke e ditur që askush nuk mund ta merrte gjakun përveç saj dhe duke ia ditur shtëpinë “hasmit”, vendosi një ditë të shkonte dhe të merrte gjakun e të dashurve të saj duke vrarë burrin dhe djalin e familjes së tyre. Fëmijët e saj mbetën jetimë, por sipas saj kjo ishte gjëja e duhur, pasi ata do të rriteshin me nder dhe të qetë sepse personi që i morri jetën babit të tyre nuk jeton më. Pasi bëri vrasjen dhe morri gjakun, ajo shkoi dhe u paraqit vetë në rajonin e policisë.

Në këtë intervistë është e dukshme forca e këtij fenomeni social. Kjo grua ishte gati të linte fëmijët jetim e të futej në burg, vetëm që gjaku i vëllezërve dhe i burrit të saj të shlyhej me gjak. Vihet re varfëria e madhe që e shoqëronte këtë familje. Gjithashtu i fortë është edhe besimi që për fëmijët është më mirë të jetonin jetim e të qetë sepse

gjaku i babait të tyre u shlye, sesa të jetonin me nënën e tyre dhe me ndërgjegje të vrarë sepse hasmi është gjallë. Mund të kuptohen problemet e tjera psikologjike që shkaktohen në zinxhir si tek kjo grua që vuan dënimin, ashtu edhe tek ata fëmijë që rriten pa praninë e asnjërit prej prindërve.

-Më poshtë janë vendosur intervistat e marra nga dy gra familjet e të cilave nuk janë të ngujuara dhe as të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes. I kemi marrë këto intervista për të kuptuar se sa të solidarizuara janë familjet e paprekura nga gjakmarrja dhe si e kuptojnë ato gjendjen në të cilën ndodhen shoqet e tyre, familjet e të cilave janë të ngujuara. A kanë këto familje ndjeshmëri ndaj tyre?

Intervista nr. 5

Në intervistën nr. 5 kemi G. 28 vjeçe e cila është e martuar dhe ka 2 fëmijë. Është shpërngulur në Tiranë që prej vitit 1997 nga një fshat i thellë i Kukësit.

-A keni rënë ndonjëherë në kontakt me ndonjë familje që vuan gjakmarrjen?

Sh- *“Jo vetëm që kam rënë në kontakt, por kam disa familje që njoh dhe njërën prej tyre e kam shoqe të mirë dhe të afërt dhe më dhimbset në shpirt. Me të thanë të drejtën janë disa që njoh dhe që kur i shoh m’vjen aq keq për ta. Asht pothujse e pamujtun me kuptu se sa të vështirë e kanë me jetu në këto kushte që kanë ata njerëz.”*

-A e vizitoni shpesh shoqen tuaj të ngushtë?

Sh- *“Kam shku shpesh dhe sa herë që shkoj më vështirë më duket situata e tyre. Nji ditë kur shkova, m’kujtohet sesa ngjendje t’keqe e kishte G. të shoqin, nuk mund të shihej me sy. Dukej që edhe kishte pi raki nga mërzija dhe gruen e tij nuk e duronte dot kur bante muhabet*

me mu. I biri i saj, një djal 13 vjeçar dukej veçanrisht i trishtum por që duke qënë akoma i vogël nuk e kuptonte taman situatën e frigen. Jeta me frikë nga hasmi e pa t'ardhuna që bajn ata nuk ka fjal me e përshkrue.”

-Si janë kushtet e jetesës suaj?

Sh- “Nuk e kam të lehtë jetën as vetë, por t'pakten nuk kam frikën e gjakmarrjes, se dikush do t'më vrasë dikë nga mashkujt e shpisë time. Kam borxhe për të larë e halle boll, por shyqyr jetoj e qetë.”

- Çfarë mendoni për këtë situatë dhe për fenomenin e gjakmarrjes?

Sh- “Është duke u shu djelmnia për një fjalë goje dhe jan tu u vra fmijt për hiç gjë. Jena tu pa ditë të zeza. Duhet patjetër me nderhy shteti në kto punë e me e ndal këtë gjakmarrje. Nuk jetohet me hasmin mbi kry, por edhe shteti duhet me dhënë dënimin e merituar dhe me vu drejtsinë në vend.”

-Nëse ju vetë do të ishit në një situatë të tillë, çfarë zgjidhje do ti jepnit?

Sh- “Mos e thashtë Zoti me ndodh kurrë. Më kap frika vetëm kur kujtoj shogën time dhe jo më ta kem në familjen time. Mos i raftë as hasmit ky problem, kaq i vshir dhe i pazgjidhshëm është.”

- Çfarë mendoni, a ka një zgjidhje për fenomenin e gjakmarrjes, a është e mundur pajtimi i familjeve në konflikt ?

Sh - “Kur shikon e dëgjon nëpër lajme për gjithë këta njerëz që vriten asht shumë e vështir. Edhe kur sipas kanunit merret gjaku dhe ti mendon se duhet të ndalet vrasja, ata vazhdojnë

prap dhe nuk e lënë barazim gjakun me gjak. Kanë fillu me pre në bes e po vrasin gjithkënd. Nuk di çka me thanë, s'ka qenë kurrë kshtu."

Intervista nr. 6

Në intervistën nr. 6 kemi L. një vajzë 17 - vjeçare. Ajo është shpërngulur prej Laçit në Tiranë së bashku me familjen e saj në vitin 2003. Tani ajo është gjimnaziste në shkollën e mesme në Kamëz.

-A keni rënë ndonjëherë në kontakt me ndonjë familje ose shoqe që vuan gjakmarrjen?

L- *"Sapo më pyete më solle në mend shoqen time F. Ajo jeton me familjen e saj në Bathore që prej 10 vitesh. Kur familja e saj erdhi në Bathore, vëllai i saj u zu me një nga djemtë e shtëpisë ngjiur. Pas grindjeve të shumta që patën ata ia vranë vëllain e madh e që atëherë familja e saj është në gjak, por jo të ngjuar. Familja tjetër është e ngjuar dhe familja e shoqes sime kërkon të marri gjakun e vllait të saj."*

-A e vizitoni shpesh shoqen tuaj?

L- *"Po, i kam vizituar disa herë. Gjendja që është ajo familje është pothuajse e papërshkrueshme.. Kur kam vajtur në shtëpinë e saj shihja fytyrat e trishtuara të të gjithëve, nëna e saj e mbuluar në zi vetëm qante e kujtonte djalin e saj të humbur, një baba e një vëlla të cilët me padurim prisnin rastin të çonin në vend nderin e humbur dhe të lanin gjakun e djalit të tyre. Shoqja ime F. qante sa herë që fliste për këtë situatë."*

-Si janë kushtet e jetesës suaj?

L- *"Nuk jetoj në mirëqenie dhe në kushte shumë të mira. Ka papunësi të madhe dhe e gjithë shtëpia mbahet me ato pak të ardhura që sjell babai nga punë të rastësishme. Kam edhe 2*

motra më të vogla e vështirësitë janë të ndryshme, por jam e lumtur kur mendoj që familja ime është e lirë dhe nuk druhet kur del jashtë pragut të shtëpisë. Shpeshherë kur dëgjoj histori të tilla, ndihem mirë që nuk kam vëlla dhe që jemi vetëm tri motra, edhe pse shpesh i dëgjoj të gjithë të thonë që djali të trashëgon dhe është shtylla e shtëpisë. Nuk ndihem mirë kur i degjoj këto sepse mendoj që të gjithë fëmijët duhet të trajtohen njësoj, qofshin vajza apo djem.

- Çfarë mendoni për këtë situatë dhe për fenomenin e gjakmarrjes?

L- “Nuk di çfarë të mendosh. Mos na raft kurrë ajo situatë. Është e dhimbshme të jetosh me frikën se një ditë mund të vritesh për gjëra krejt banale. Sot jetojmë në shekullin e XXI dhe gjakmarrja duhet të marrë fund. Është turp me na njoft bota për kesi makabërish ku vllai vret vëllanë vetëm se e ka humbur arsyen dhe durimin. Gjithë gjaknxehtësia zgjat pesë minuta dhe më pas pendohen, por çfarë vlere ka kur ka marrë jetën e tjetrit kot.”

-Nëse ju vetë do të ishit në një situatë të tillë, çfarë zgjidhje do ti jepnit?

L- “Nuk e kaloj dot nëpër mend nëse familja ime do të kishte një problem të tillë. Do të ishte një jetë e vështirë, pa të nesërme dhe pa shpresë.”

- Çfarë mendoni, a ka një zgjidhje për fenomenin e gjakmarrjes, a është e mundur pajtimi i familjeve në konflikt ?

L- “Këtu ku ne jetojmë dëgjojmë ngjarje konfliktuale që ndodhin përditë, por edhe në lajme çfarë nuk po na dëgjojnë veshët me vrasje që po ndodhin çdo ditë. në Bathore ku ne jetojmë është bërë shumë problem, por nga çfarë kam dëgjuar në televizor dhe në gazeta di që ngjarje të tilla ndodhin përditë. Sigurisht që do ishte mirë që ti jepej fund njëherë e

përgjihmon vrasjeve të pafajshme për gjakmarrje. Pse duhet të vritet një njeri i pafajshëm për krimin që ka bërë xhaxhai apo edhe baba? Duhet të vendoset drejtësia me ligj dhe jo me kanun. I ka ikur koha knunit. Ai ishte i mirë për kohën kur nuk kishte ligj, por jo për ditët e sotme. Edhe pse shpresoj shumë që të mund të gjendet një zgjidhje për këto familje dhe për këtë fenomen, kam frikë që kjo gjë do të jetë e pamundur edhe për shumë kohë.”

Në të dyja këto intervista kuptohet deri në njëfarë mase që personat e intervistuar mund të kuptojnë gjendjen e shoqeve të tyre dhe se sa i tmerrshëm është fenomeni i gjakmarrjes. Është interesant krahasimi i dy vajzave moshatare në këto intervista. E para që vuan presionin e fenomenit kërkon që të zbatohet kanuni. E dyta që nuk është pre e tij kërkon që ky fenomen të marrë fund sa më shpejt të jetë e mundur. Edhe pse gjendja ekonomike e këtyre dy të fundit mund të jetë e ngjashme me të parat, ato shikonin me keqardhje mbi shoqet e tyre që vuajnë prej fenomenit. Gjithashtu në rastin e shoqes në intervistën e fundit shohim që migrimi i popullsisë ka bërë që fenomeni të praktikohet edhe në zona të Shqipërisë që nuk ka qenë aplikuar kurrë më parë.

4.12. Përfundimet dhe analiza e intervistave individuale

Nëse lexojmë me vëmendje intervistat individuale të të intervistuarave mund të identifikojmë disa faktorë të përbashkët tek të gjitha gratë.

Prania e një *frike të tejshtuar*, jo vetëm për jetën e tyre, por edhe të familjarëve të tyre, është e pranishme në çdo intervistë. Madje, edhe gratë që nuk vuanin fenomenin e gjakmarrjes, kur përmendej ky term dukej se i kaplonte një frikë e pashpjegueshme. Prezenca e kësaj frike

tek gratë që vuajnë fenomenin, mund të jetë një ndër faktorët kryesor për çrregullimin e stresit post-traumatik

Mungesa e shpresës për të ardhmen është një faktor tjetër i përbashkët që i shoqëron intervistat. Edhe pse në moshë të re dhe me shumë vite fizike për të jetuar, duket që shpresa ka vdekur tek këto gra. Ato kanë rreshtur së jetuari për veten e tyre dhe i vetmi motiv për jetën janë fëmijët. Duket se jeta e tyre ka rreshtur që në momentin e ngujimit. Të jetuarit është kthyer si detyrë dhe si një borxh që ato ia kanë brezit pasardhës. Kjo lidhet ngushtë me një faktor tjetër që është:

Pafuqia për të ndryshuar realitetin në të cilin ndodhen. Një nga përgjigjet instiktive psikologjike të individëve të gjendur përpara situatave kërcënuese dhe të rrezikshme është mekanizmi ‘lufto ose vrapo’. Në rastin tonë, ky mekanizëm duket sikur është paralizuar, pasi si zgjidhje të vetme familjet ëndërrojnë emigrimin jashtë vendit si e vetmja mundësi e sigurt për shpëtimin e tyre, por që e dinë që kjo gjë është e pamundur për ta. Të luftosh nën një fenomen të tillë duket se i përkeqëson më shumë gjërat e në këtë mënyrë familjet kanë zgjedhur të fshihen e të ngujohen në shtëpitë e tyre. Kjo gjë na drejton tek faktori tjetër.

Akuzimi i vazhdueshëm i instancave shtetërore për indiferencën e treguar ndaj këtij fenomeni e ndaj këtyre familjeve. Pafuqia për të bërë vetë diçka për situatën të drejton ndaj akuzës së një pale të tretë që ka fuqinë të bëjë diçka për gjendjen e tyre. Në shumë raste akuza është e padrejtë pasi pjesa më e madhe e familjeve nuk e kanë denoncuar rastin e tyre dhe kërcënimin që iu kanoset në policinë e vendit ku banojnë. Kjo bëhet për dy arsye:

Së pari, sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, denoncimi konsiderohet si dobësi dhe si mungesë trimërie. Fakti që një familje shkon në polici, sipas kanunit përkethehet që meshkujt e asaj familje s'janë në gjendje dhe të fortë mjaftueshëm që të zgjidhin konfliktin vetë e të bëjnë vetë-drejtësi.

Së dyti, ata nuk e regjistrojnë veten si familje në ngujim, pasi nuk kanë besim fare tek shteti shqiptar, që mund të bëjë ndonjë gjë për gjendjen e tyre. Madje, kanë frikë që informacionet që mund të jepen në policinë e shtetit mund të jenë lehtësisht të aksesueshme nga gjaksi dhe në këtë rast ata ndihen më të ekspozuar për t'u vrarë dhe jo më të mbrojtur. Ky faktor na drejton në hallkën tjetër që është dëshira që kanë familjet e prekura nga gjakmarrja për *Legalizimin e Kanunit*.

Mungesa e besimit në instancat shtetërore i shtyn këto familje që të aktivizojnë e të besojnë më shumë në kanun, pasi kanuni sipas arsytimit të tyre, iu jep të drejtën që të marrin gjakun me duart e tyre dhe ta lajnë gjakun me një gjak tjetër dhe jo me një dënim me burg siç do të bënin gjykatat e Shqipërisë. Por edhe kjo ka shkuar shumë larg dhe nuk ka lidhje fare me kanunin, pasi siç konstatuam edhe më sipër, pjesa më e madhe e familjeve nuk e kanë lexuar kurrë dhe nuk e kanë idenë se çfarë shkruhet në kanun, gjë që ka çuar në deformime masive të këtij kodi zakonor që me praktikën e sotme duket më shumë si një ligj xhungles dhe mbijetese. Shkon kaq larg sa një nënë është gati të lërë fëmijët e saj të rriten në jetimore, pa praninë e asnjërit prind, vetëm e vetëm që instikti i saj për hakmarrje të kënaqet dhe ndergjegja e saj të jetë e qetë me vetëgjyqësinë që ajo ka zgjedhur të bëjë, gjë që nuk thuhet kurrë në kanun.

Eshte interesant fakti se si lidhen të gjithë këta faktorë si një zinxhir i hekurt që i mban të lidhura këto familje në mentalitetin primitiv të vetëgjyqësisë. *Varfëria ekstreme* që i karakterizon të gjitha këto familje si dhe *zhgënjimi* nga pritshmëritë që vendi i ri ku migruan do të ishte më i mirë se vendi që lanë pas dhe do ia u bënte jetën më të lehtë, janë hallka të tjera të këtij zinxhiri.

4.13. Analiza e fokus grupeve

Më poshtë, kemi paraqitur materialin e mbledhur nga dy fokus grupe. Për t'a bërë edhe këtë pjesë të studimit sa më gjithëpërfshirëse, kemi zgjedhur që një fokus grup të jetë në Bathore dhe tjetri në qytetin e Shkodrës. I kemi shkruar bisedat në dialektin përkatës të secilës grua, në atë mënyrë siç ato kanë folur. Qëllimi kryesor i vendosjes së informacionit të mbledhur nga këto grupe është që lexuesi dhe studiuesi të ketë një pamje më të qartë të mentalitetit të përgjithshëm që e shoqëron këtë komunitet. Nuk kam nxjerrë përfundime dhe nuk kam bërë analiza në këtë pjesë të studimit, pasi janë shumë të ngjashme me analizën e intervistave individuale në rubrikën e mësipërme. Janë të dhëna parësore që secili studiues mund t'iu përqaset nga këndvështrime të ndryshme.

Në krijimin e këtij fokus grupi kishim pjesmarrjen e grave të moshave dhe statuseve të ndryshme sociale dhe familjare. Grupi përbëhej nga 8 gra dhe asnjëra prej tyre nuk kishte qenë pjesë e intervistave të mësipërme individuale. Diversiteti dhe përbërja e grupit ishte një vlerë e shtuar pasi secila prej pjesëmarrëseve solli individualitetin e vet, shpresat, dëshirat dhe ëndërrat që ato mbanin brenda vetes.

Gratë u lajmëruan që më përpara dhe u mblodhën të gjitha në ambjentet e marra me qera nga një organizatë humanitare që ka më shumë se 10 vjet që është aktive në zonën e Bathores. Pjesmarrja e një vajze 16 vjeçare ishte kuptimplotë, sepse fjalët e saj qenë njëfarë apeli për këto gra dhe lotët e saj treguan se shpresa nuk do të mbetej e mbyllur në kullën e ftohtë, por ajo do të përpiqej ta jetonte jetën .

➤ ***Më përshkruani një ditë tuajën të zakonshme! (Secila bëri një përshkrim të zakonshëm të ditës së vet)***

U dalluan tri grupe pa ndryshime të mëdha, por që kishin të bënë vetëm me statusin familjar.

- **Gra me fëmijë të vegjël**, që kishin si përfaqësuese K. dhe mënyra se si ajo e kalonte ditën ishte:

“Dita ime fillon në mëngjes herët, rreth orës 5.00 çohem nga gjumi dhe pi kafën me burrin, kujdesem për fëmijët që të bëjnë gjithë adetet e mëngjesit, i bëj gati për në shkollë e kujdesem për të vocren të cilën e kam 1 vjeç e gjysëm. I përcjell fëmijët deri në shkollë e pastaj bëj punët e shtëpisë, mbruj buken, gatuaj drekën, laj teshat, pastroj shtëpinë,” dhe pastaj shton që: “Ikën gjithë dita me këto punë e lodhesh e këputesh pa nxjerr gjë në dritë. Burri rri tërë ditën mbyllur brenda katër murreve të shtëpisë e sillet vërdallë e nuk di çtë bëj. Ai ma shton mërzinë kur e shoh t’ngujum në shpi të vet.”

- **Grupi tjetër ishin gra me fëmijët me moshë mbi 15 – vjeçar**, që kishin përfaqësuese F. dhe mënyra se si ajo e kalonte ditën ishte:

“Kur zgjohem në mëngjes kam më shumë kohë sepse i kam rritur fëmijët dhe kujdesen më së shumti vetë për punët e tyre. Kujdesem për veten time dhe pastaj e gjatë ditë merrem me punët e shtëpisë dhe duke bërë për të ngrënë për të gjithë familjen. Kështu me punë kalon dita,” – tregon ajo.

- **Grupi tjetër ishin gra të veja,** me përfaqësuese SH, dita e së cilës kalonte kështu:

“Në mëngjes zgjohem me nge, bëj gjërat e mia personale, i bëj kafën vjehërrit, bëj ushqimin gadi për fëmijët me çfarë të më gjendet në shtëpi dhe bëj pastrimin e shtëpisë. Kur i mbaroj të gjitha këto marr keqecë nga fabrika dhe qep për më shumë se 10 orë. Është e vetmja e ardhur që nxjerr vetë për të mbajtur veten dhe familjen time. Atë pak pension që merr vjehërrit i duhet për ilaçe dhe për punët e veta se është plak dhe ka nevoja të ndryshme.”

- **Çfarë ndjeni dhe çfarë pozicioni mbani ju kur degjoni ngjarje të ndryshme të familjeve të tjera që janë të ngjashme me situatën tuaj, si i gjykoni ato nga ana juaj?**

Një pjesë e përgjigjeve të grave ishin këto:

“Mos e provoftë kush, vetëm ai të cilit i asht djeg shpirti e kupton se çfarë do të thotë” shprehet L, djali i së cilës është vrarë.

“Ja që vjen dita me të trokit edhe ty në derë e njëjta gja” - thotë T.

“Sot s’ka ma besë e duhet me u rujt gjithkund e prej gjithkujt. Bejnë sikur ta falin gjakun e prap të vrasin,” – thotë N.

Diskutimi rreth një ngjarjeje, ku një grua, për të marrë gjakun e vëllait të saj kishte vrarë një fëmijë, gjeti miratim dhe mbështetje nga një pjesë e grave edhe pse në të njëjtën kohë ishte dhe keqardhja që ndjenin për fëmijën.

- ***A keni armë për vetëmbrojtje në shtëpitë tuaja? (Në fillim gratë u stepën për t'iu përgjigjur kësaj pyetje).***

Nga gratë që bënin pjesë, dy treguan se nuk mbanin armë të fshehura.

Përgjigjja e A ishte: “*Nuk ka si të lejosh armë në shtëpi se sado ta fshehesh është frika se e gjejnë fëmijët, se janë të vegjël e ju duket lodër. Kam dëgjuar që ka ndodh që fëmija e ka gjet armen e ka shtënë pa dashje mbi robt e shtëpisë, është shumë e rrezikshme me mbajt armë në shtëpi.*”

Një pjesë e tyre treguan se i kishin çuar vetë me duart e tyre armët në komisariatit e policisë, në momentin e grumbullimit të tyre masiv.

“*Veç mos iu shkoftë mendja se kush do me vra nuk e ka të vështirë që ta gjej edhe armën në ditët e sotit,*” thotë K.

- ***A mendoni se njerëzit duhet të jenë më tolerant me njëri tjetrin? (Në përgjigjen e kësaj pyetje gratë ishin të gjitha në një mendje).***

“*Gruaja asht ajo që shuan gjakrat. Qetëson edhe burrin kur ai ndodhet në situata të vështira.*”

- ***A mendoni se gruaja mund të luajë rolin e ndërnjësueses për faljen e gjakut?***

B. thotë: “*Askush nuk i përfshin gratë në muhabete dhe vendime të tilla në veri.*”

Ndërsa disa të tjera thanë: “*Punët janë përkeqësuar kur kanë futur hundët femrat në situata dhe në çështje të tilla, këto janë punë burrash dhe nuk bëhet lojna me fjalë.*”

“*Karshi mashkujve të shtëpisë ne ndihena të pafuqishme. Ne s'ka ndodh me na marr mendim kush për punëra më të zakonshme jo ma për kësi gjërash,*” - thotë T.

“Gruaja nuk asht baraz me mashkujt. Me fol ajo e me dasht me ndërhy e me dal ma e meçme se burri ha dru e s’duhet me ba za, ” - pohuan dy prej këtyre grave.

“Në kanunin tonë gruaja quhet ‘calik me mbajtë’. Me mbajt dru, me mbajt fëmijë, shtëpi e katandi e asgja tjetër mas me ba.”

Kurse mendimi i L është: *“Influenca e gruas varet edhe nga masa që familja ka. Kur familja asht e përbërë me shumë kurorë, kryefamiljari asht vjehri e pas tij mashkujt e tjerë të shtëpisë, e n’kto raste gruaja nuk përfshihet. Kurse kur familja asht e vogël gjërat janë ndryshe dhe komunikimi në çift është më i lehtë. Gruaja e gjen një formë a mënyrë për të dhënë mendimin e saj.”*

➤ ***A e keni çuar ndonjëherë nëpër mend të ndaheni prej bashkëshortit?***

Tre nga këto gra u përgjigjën: *“Asnjëherë, sepse e di që nuk kam zgjidhje ku të shkoj. Familja ime nuk më pret dhe nuk më mbështet sado të vështirë ta kem jetën këtu, sepse do ishte marre për ta nëse unë divorcohem. Pastaj ba me u kthy te gjinia, hyn në gjak familja jonë, e jo vetëm kaq. Ba me e ba diçka të tillë çfarë kanë me thanë të tjerët pastaj. Korrisim jo vetëm burrin dhe prindërit tanë, por edhe fëmijët tanë korriten përjetë. Duhet me duru se ky ishte fati ynë.”*

Deri më tani mund të shohim që këto gra nuk bëjnë dot qoftë edhe një përpjekje të vetme për të menduar diçka ndryshe dhe më të mirë për veten e tyre dhe për fëmijët e tyre, por e pranojnë realitetin në të cilin ndodhen dhe i qëndrojnë “besnike” mentalitetit dhe traditave të vjetra kanunore. Për të përmendur këtu vlen edhe gjendja e tyre ekonomike dhe varësia që ato kanë ndaj burrit në këtë aspekt dhe jo vetëm.

➤ ***Si e konsideroni lidhjen dhe marrëdhënien mes anëtarëve të familjes?***

Disa prej grave ndanin këtë mendim: *“Për sa kohë që ne të jemi skllëvër të mentaliteteve dhe traditave të së shkuarës, dhe për sa kohë që do të vazhdojmë të zbatojmë kanunin si zgjidhjen e situatave tona lidhja mes anëtarëve të familjes dhe fisit do të jetë e madhe. Domosdo që do t’i mbash lidhjet se çohet e bën një sherr kunati apo djali i kunatit dhe e vuan ti tek fëmija dhe tek burri yt.”*

➤ ***Në lidhje me mentalitetin që vazhdon të trashëgohet nga njëri brez tek tjetri çfarë do të thoshit?***

Përgjigjet e tyre na lanë të kuptojmë që ato jetojnë me pleq në shtëpi gjë e cila ndikonte shumë tek familja dhe tek fëmijët. *“Pleqtë nxisin fëmijët që të marrin gjakun edhe pse ne përpiqemi që atyre të mos ua shtijmë ndërmend.”* Pastaj kur shteti ynë është i pafuqishëm dhe rrobi im qëndron i vdekur kurse vrasësi jeton jetën e tij për qejf, në këto raste më mirë të vazhdoj kanuni. Kur nuk behet drejtësi nga ata që duhet me e bë, atëherë unë do ta bëj vetë drejtësinë për rrobin tim”.

➤ ***A mendoni se është mirë kështu?***

Përgjigjja e tyre ishte: *“Sigurisht që jo!”*

“Por çfarë kena me ba se ne nuk dalim dot kundër.”

➤ ***A mendoni se është e drejtë që vajzat tuaja të arsimohen dhe pse, sipas jush, kur ato kalojnë të 15 vjetët janë në moshë për martesë?***

M. njëra nga gratë më të vjetra tha:

“Ato nuk duan vetë të dalin.”

S. rreth 16 vjeç tha:

“Sigurisht që dua të arsimohem dhe për mua është e vështirë. Të martohem? Më vjen keq që e gjithë jeta ime të mbetet kështu e të mbetem skllave e burrit ashtu siç është edhe mamaja ime, skllave e tim eti.”

➤ ***A mendoni se përbën problem gjakmarrja për vajzat që janë në moshë për t’u martuar?***

N. thotë: *“Martesa është problem për vajzat sepse ato e kanë të vështirë për të dalë dhe nëse do të bëhet martesë, ka raste që edhe dhëndri mund të hyjë në gjak, nëse familja e vajzës e ka për zemër dhe e quan si djalë e shtëpisë.”*

Fokus Grupi 2

Grupi u krijua me pjesëmarrjen e 8 grave që vinin nga krahina të ndryshme nga veriu i vendit dhe ishin të ndryshme në moshë dhe status. Katër prej tyre nuk vuanin problemin e gjakmarrjes në familjet e tyre, ndërsa 4 të tjerat kanë familjet në gjak. Pasi u lajmëruan për këtë takim, secila prej tyre erdhi së paku 10 minuta para orës në të cilën ishte caktuar takimi. Ky fokus grup u zhvillua në Shkodër në ambjentet e fondacionit “Jo gjakmarrjes-Po jetës”. Çdo grua mbarte mbi vete një histori për të treguar dhe gratë që nuk vuanin fenomenin e gjakmarrjes njihnin ose kishin të afërm të ngjuar. Edhe këto të fundit u përpoqën të shprehnin empatizimin dhe vlerësimin e shoqeve të tyre që vuanin pasojat e fenomenit. Deri diku opinionet u ndanë në dy grupe të ndryshme, në bazë edhe të përbërjes së fokus grupit nga dy kategori të ndryshme grash. U munduam të moderonim bisedën mbi disa çështje që u shtruan më parë.

➤ ***Sa të ndërgjegjshme jeni ju për fenomenin e gjakmarrjes?***

S. njëra prej 4 grave familjet e të cilave nuk janë të ngjuara thotë:

“Përveç problemeve dhe vuajtjet që heqin të rriturit nga frika se mos vriten, nuk ka hall më të madh të shikosh fëmijët të mbyllur brenda katër mureve të shtëpisë, duke pasur frikë të kalojnë pragun e derës. Duket një problem i madh që i ka rezistuar kohës dhe sikur askush nuk ka forcë ta ndaloj.”

G. e cila vuan problemin e gjakmarrjes thotë:

“Nuk ka fjalë me shpjegu gjendjen që ndodhet familja e ngjueme, kurrë mos e provofshi. S’ka hall më të madh sesa me pa djelmt që të bëhen burra dhe frigoresh për jetën e tyne.”

L. që nuk e vuan fenomenin e gjakmarrjes:

“S’ka hall më t’madh. Në varfëri jena të gjithë, por varfërisë i gjindet zgjidhja kur je i lirë. Kur je në gjak i ke tana të zezat e nuk ke shpresë për ditët për me dal i lirë.”

➤ ***Çfarë ndjeni kur dëgjoni dhe shihni ngjarje të tilla?***

K. grua e cila nuk e vuan fenomenin e gjakmarrjes thotë:

“Kam dhembshuri e më vjen keq për to.”

L. familja e së cilës është në gjak thotë:

“Ai që ka me marr gjak i fiksohet n’tru dhe mendon t’a marri gjakun në çdo moment.”

S. thotë: *“Fëmijët nuk dinë se çfarë kanë ba gjyshërit në zonën e veriut, por kur familja ka vetëm një djalë, marrin më shumë gjak, për me e shujt familjen ma kollaj.”*

➤ **A njihni ndonjë grua të tillë?**

F. grua familja e së cilës nuk është në gjak thotë:

“Historina të tilla diplot dhe në lagjen ku banoj unë ka 6 gra të tilla.”

“Kemi dëgjuar shumë historina të tilla.” - u përgjigjën.

➤ **A e pranoni këtë situatë?**

L. njëra prej grave të paprekura nga fenomeni thotë:

“Përmes televizorit çfarë s’po na dëgjojnë veshët, histori vrasjesh për çdo ditë. Hidhërohem për momentin kur i dëgjojmë, por vazhdojmë jetën me sfidat tona dhe shpesh harrojmë që këto familje vazhdojnë të qëndrojnë të ngujuara. Kujt I ka rënë për hise e vuan shumë.”

➤ **Kur vjen tek ti për vizitë si ndiheni?**

B. njëra prej grave të paprekura nga fenomeni thotë:

“ Më vjen gjynah për të, më duket se me trup e me pamje është në shtëpinë time, por me mend dhe zemër edhe ajo është e ngjuar bashkë me familjen e vet. Është hall mos me pas fuqi me ndryshue situatat e dhimbshme për njerëzit e tu më të dashur. ”

K. grua nga një familje e ngjuar thotë: *”Kam një shoqe që familja e saj ka qenë e përfshirë në këtë fenomen prej shumë vitesh. Kur shkoj dhe e vizitoj gjithmonë e gjej derën me kanatet e hapura. Të gjithë mashkujt e shtëpisë janë vrarë dhe ska mbet kush tjetër veç gra të veja e fëmijë. Gjakkarrja të bën gjëmën e të than zemrën. Kuku medet, vetëm hidhënim sheh në atë familje. Nënata të mbuluara në zi, fëmijë të vegjël pa bab. Kur jam lut me e marr nusen e shtëpisë për me e nxjerr për kafe, nuk ma la vjehërra e saj, por edhe ajo nuk desht. Këto gra*

përveç se vujnë për vdekjen e burrave të tyre, as mujt me e mendu që të dalin qe me e kalusado pak mërzitjen e trishtimin.”

➤ ***Çfarë mendoni se duhet të behet për t'a shuar këtë fenomen?***

F. grua familja e së cilës nuk është në gjak thotë:

“Kur kam shku me taku nja do familje në lagje për t’iu treguar për studimin që po bënit ju për këtë dukuri, nusja e njëres prej familjeve që iu kanë vrarë dy djemtë, ndërsa vishte djalin e vogël filloi të qante. E të mendosh që mashkujt e asaj shtëpie janë vrarë për një fjalë goje.”

B. grua e paprekur nga fenomeni thotë: *“Duhet që dikush të bëjë diçka për këta njerëz, shoqata dhe kisha katolike duhet me ndihmu per me ndërmjetsu për pajtim e me shu konfliktet.”*

L. grua e prekur nga gjakmarrja thotë: *“ Askush nuk e din se sa e pamundur është me e ndal këtë plagë. Nuk e ndali dot kush për 500 vjet me ligj e me krah të hekurt, jo më ta heq ky shtet i korruptuar që mendon vetëm si me mbush xhepat e vet e me u pasurue. Pastaj edhe nëse ia mbush mendjen rinisë me fal dhe me vazhdu jetën përpara, nuk I mbuset mendja pleqnisë. Ia u lënë djemve me amanet që të marrin gjak. Prej plakut e prej plakës janë vra gjithë ajo djelmni.”*

B. thotë përsëri: *“ Familjet e ngujueme janë familjet më të varfëra në të gjithë Shqipërinë dhe fondacione të ndryshme i ndihmojnë me ushqime dhe mirë bëjnë. Por ushqimet nuk janë zgjidhja. Duhet shteti me ndërhy e me vu dorë për me iu dhënë liri këtyre njerëzve.”*

Grave të cilat nuk vuajnë nga fenomeni i gjakmarrjes iu bë kjo pyetje:

Duke qenë se jetoni në të njëjtin komunitet me disa familje të prekura nga gjakmarrja, a është e ngjashme dita juaj me ditën e grave të këtyre familjeve?

S. shprehet: “*Dita e grave shqiptare e sidomos atyre fshatare në përgjithësi është pothuajse e njëjtë, me punët e përditshme dhe kujdesin ndaj familjes që ato tregojnë. Ajo që është ndryshe tek këto gra është se i shtynë ditët e jetës së tyre të pushtuara nga dhimbja që kanë nga humbja e një njeriu të dashur të tyre. Ato kanë frikë për fëmijët e tyre dhe nuk e dinë nëse e nesërmja do të jetë njësoj.*”

Edhe nga këto të dhëna, kuptojmë që deri diku gratë empatizohen me njëra tjetrën dhe arrijnë të kuptojnë vështirësitë dhe pafuqinë për ta ndryshuar këtë realitet. Ato presin në mënyrë pasive që një palë e tretë të ndërhyjë dhe të bëjë diçka për të ndryshuar realitetin e tyre.

KAPITULLI V

DISKUTIMI I GJETJEVE

Përmes rezultateve dhe gjetjeve të këtij studimi kemi synuar të japim një kontribut të veçantë e modest në fushën e gjerë të psikologjisë sociale. Gjithë ecuria e punimit është fokusuar kryesisht në vlerësimin psiko-social të dukurisë së grave të ngujuara, në gjetjen e marrëdhënieve mes tre koncepteve kryesore të parashtruara në fillim të punimit siç janë: ***ngujimi i grave, gjakmarrja dhe faktorët që e stimulojnë dhe e mbajnë gjallë atë, pasojat e përjetimit psikologjik të dukurisë së gjakmarrjes nga gratë e ngujuara.***

Përmes gjetjeve të këtij studimi synojmë të zgjerojmë rrethin e njohurive tona rreth kësaj teme, duke identifikuar dhe qartësuar problemet sociale e psikologjike që shkakton fenomeni i gjakmarrjes, si dhe gjetjen e rrugëve apo mënyrave si mund të reduktohet apo të mënjanohet ngujimi e gjakmarrja. Për këtë, në vazhdim të shtjellimeve tona do të paraqitet diskutimi i rezultateve apo gjetjeve, duke u bazuar në teoritë dhe hulumtimet e zhvilluara në këtë fushë, në gjetjet tona në realitetin social shqiptar si dhe përputhja e tyre me qëllimin, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e shtruara në kapitullin Hyrje të këtij punimi.

5.1. Gjetje në burimet e literaturës dhe diskutimi i tyre

Fillimisht, duhet të theksojmë se rezultatet e arritura në hulumtimet e tjera në literaturën që ne kemi përdorur për këtë studim, shërbyen si udhëzues për gjetjet tona rreth pyetjeve kërkimore e hipotezave të ngritura, duke aplikuar instrumente që janë përdorur për kërkime në këtë fushë nga studiues të tjerë. Për këtë, mendojmë se në përfundim të punës sonë është

arritur në gjetjen e të dhënave të rëndësishme lidhur realizimin e qëllimit së bashku me objektivat e këtij studimit të kryer nga ana jonë.

Historikisht, fenomeni i gjakmarrjes është hasur që në mesjetë, por ndoshta edhe më herët. Sipas të dhënave që kemi mundur të sigurojmë vihet re se, përgjithësisht, ky fenomen ka qenë i pranishëm ndër popujt e Mesdheut, sidomos në territoret shqiptare, në Italinë jugore, në Korsikë dhe në pjesët Europiane të Turqisë së sotme (Valentini, 2005; pg. 666-667, 670-672). Nga këta popuj, fillimisht gjakmarrja konceptohej si një sanksion, por me kalimin e kohës kuptimi i saj u zgjerua dhe sot ajo shihet më tepër si një *praktikë zakonore, një ligj shoqëror ose fetar, ligj i pashkruar, hakmarrje e thjeshtë ose kombinim i tyre* (Mile, 2007:7). E vërteta është se, ndryshe nga shumë popuj të Europës, ku praktikat e tjera zakonore edhe gjakmarrja u harruan me kalimin e kohës, ***shqiptarët kanë bashkëjetuar më gjatë me të dyja këto dukuri, të cilat kanë kaluar më vonë edhe në të drejtën shtetërore***. Po si shpjegohet një gjetje e tillë në burimet e shkruara që i referohet realitetit shqiptar?

Së pari, e shkruar në Kanunin e Lek Dukagjinit, e kaluar dikur gojë më gojë dhe me qëllimin e mirë për të ruajtur rregullin e jetën në një vend, ku shteti ishte larg shtetasve të vet, gjakmarrja u transmetua nga njëri brez në tjetrin, deri sa mbërriti deri në ditët e sotme. Sipas studiuesve tanë, disa nga faktorët që e bënë më jetëgjatë Kanunin dhe gjakmarrjen për shqiptarët janë: *qeverisja kanunore gjatë pushtimit shekullor osman, vonesa në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe të gjykatave shtetërore, dobësitë e qeverisjeve të ndryshme dhe mungesa e strategjive kombëtare në luftën kundër saj, interesim dhe i nivel i ulët arsimor, zhvillimi i ulët ekonomik, si dhe jeta e izoluar në vende ku mungon infrastruktura*.

Së dyti, shumë vrasje sot nuk justifikohen dot me Kanunin, por mund të cilësohen më tepër si vrasje për vetëgjyqësi. Kështu, mjaft njerëz, të cilët nuk e kanë lexuar kurrë kanunin, e përdorin atë vetëm si një nocion referimi për të justifikuar veprimet e tyre përpara një shoqërie që e legjitimon kanunin, por jo vetëgjyqësinë ndaj njerëzve të pafajshëm. Në shumë nga këto raste, edhe pse mungon baza kanonike, familjet fshihen ose ngujohen, dërgojnë ndërmjetës që të bisedojnë për falje, duke e futur kështu veten automatikisht në situatë gjakmarrje. Mendojmë se kjo vjen nga frika e pasojave të ashpra që sjell gjaknxehtësia, vetëgjyqësia dhe gjakmarrja, jo vetëm në jetën e një personi, por të një fisi apo të një komuniteti të tërë.

Së treti, dukuria e gjakmarrjes ka qenë e pranishme edhe në periudha historike kur shqiptarët kishin shtetin e tyre. Të dhëna historike, etnografike, dëshmitë e ndryshme të studiuesve vendas dhe të huaj që kanë vizituar Shqipërinë deri në fillimet e shekullit XX, flasin qartë për përmasat e mëdha që kishte kjo plagë shoqërore, veçanërisht në viset Veriore e Verilindore të Shqipërisë. Kështu psh. në kohën kur Zogu dekretoi me ligj heqjen e gjakmarrjes (Vickers, 2008: 123), kjo ndikoi në uljen e numrit të vrasjeve, por megjithatë, statistikat tregojnë se në shkallë vendi në vitet 1930 - 1938 janë kryer për gjakmarrje rreth 46 % e vrasjeve. Pra, gjakmarrje ka patur edhe në kohën kur shqiptarët u bënë me shtet, duke e menduar këtë si rregullator të jetës sociale. Po kështu, pas Luftës së Dytë botërore, kur në Shqipëri u vendos regjimi totalitar dhe aplikoheshin dënime me vdekje për autorët e vrasjeve, ndëshkimi ligjor ngushtoi me shpejtësi hapësirën e veprimit të Kanunit dhe çoi në uljen e numrit të vrasjeve për gjakmarrje. Kështu, sipas të dhënave statistikore këto vrasje zinin 17% të totalit të vrasjeve në vitet 1946-1950. Kjo shifër zbret në 13,5 % në vitet 1951-1955 dhe

është shumë më e ulët nga vitet 1956 deri në vitin 1982. Për më tepër, pas këtij viti, deri në 1990, kjo shifër ishte zero vrasje për gjakmarrje. Nisur nga ky fakt, u arrit në përfundimin se kjo dukuri i mbeti historisë apo së të kaluarës, por fatkeqësisht, e vërteta ishte se ky nuk ishte fundi i saj.

Me rënien e komunizmit në vitet 1990 dhe për shkak të trazirave që e shoqëruan Shqipërinë, gjakmarrja u zgjua më e egër dhe më e deformuar se kurrë më parë. Madje, u zgjuan edhe hasmëri të vjetra të dhjetra e dhjetëra viteve më parë. Liria për demokraci e zhvillim u kuptua si liri për veprime të gjithanshme, duke përfshirë edhe vendosjen me dhunë të drejtësisë së munguar. Mjaft subjekte të kësaj kategorie sociale thirrën në ndihmë kujtesën dhe me dëshirën për të vendosur drejtësi për paraardhësit e tyre të sakrifikuar, rifilluan marrjen e gjakut.

Pra, në këndvështrimin tonë, duhet theksuar se në vitet e tranzicionit dukuria e gjakmarrjes u rigjallërua. Ajo shkakton tek këto gra efekte negative të shumfishta siç janë: ngarkesë në gjendjen e tyre social-ekonomike dhe në atë psiko-sociale, probleme në marrëdhëniet e tyre në çift brenda familjes, me fëmijët e tyre si dhe në marrëdhënie me komunitetin. Por, krahas kësaj prirjeje, mendoj se kjo periudhë historike që kalon vendi ynë ***ka krijuar edhe kushte apo mundësi të tjera që hapin dritën jeshile për zgjidhje afatgjata të kësaj dukurie.***

5.2. Gjetje lidhur me aspekte sociale të jetesës së grave të ngujuara

Siç u përmend edhe në kapitujt e parë, prania e ngujimit dhe e gjakmarrjes në realitetin aktual shqiptar na prezanton një problematikë sociale tepër interesante, që bazohet në mjaft koncepte e mendësi të ngurta, jo sociale dhe ku janë të pranishme paragjykime sociale, doke e zakone, të cilat transmetohen ndër breza dhe e bëjnë të vështirë ekzistencën apo jetesën e

kësaj kategorie të familjes shqiptare. Kjo problematikë nuk është e re tek ne, por në vitet e tranzicionit që po kalon shoqëria shqiptare ajo ka marrë ngjyresa të reja e theks të veçantë. Në këtë vështrim, gjetjet e këtij studimi lidhen me përpjekjen tonë për t'i dhënë përgjigje Pyetjes së parë: *Si ndikon aktualisht fenomeni i gjakmarrjes në aspektet themelore të jetës sociale të grave të ngujuara?*

Duke u përpjekur për të gjetur të veçantën e këtij realiteti social, disa prej aspekteve kryesore të jetesës së grave të ngujuara që ne u përpoqëm të matim apo të evidentonim gjatë kryerjes së këtij studimit ishin: niveli i gjendjes ekonomike tek familjet e grave të ngujuara, niveli i punësimit të tyre, marrëdhëniet e grave të ngujuara brenda familjes, marrëdhëniet e tyre me mjedisin rrethues, e të tjera. Duke u bazuar në analizën dhe përpunimin e të dhënave, gjetjet tona do t'i përmbledhnim si më poshtë:

- Familjet e këtyre grave jetojnë në ngujim në pjesën më të madhe të rasteve që prej 6 deri 10 vjetësh, por nga ana tjetër, ka gra që i kanë familjet e tyre të ngujuara prej më shumë se 15 vjetësh. Për më tepër, ka edhe gra të tjera që familjet e tyre sapo janë ngjuar. Një situatë e tillë flet për vazhdimësi të fenomenit të gjakmarrjes, pavarësisht vendbanimit të tyre, të vjetër apo të ri. Familjet e zhvendosura në vitet e tranzicionit janë kryesisht nga zona të tilla si Dukagjini, Tropoja e Kukësi. Ato janë zhvendosur, duke qenë në kërkim të një jete më të mirë, por kudo ku kanë shkuar, kanë marrë me vete situatën e tyre të vështirë ekonomike. Kjo tregon se mjedisi dhe ndryshimi i tij, aktualisht, nuk janë përcaktues në ruajtjen e vazhdimësisë së fenomenit të gjakmarrjes, edhe pse nuk mund të mohohet plotësisht roli i tij ndikues.

- U hasën vështirësi në të kuptuarin e plotë të gjendjes financiare dhe situatës ekonomike të grave të familjeve të ngujuara. Për më tepër sot, këto gra janë bërë disi të padukshme edhe për shoqërinë? Sipas statistikave (që paraqiten në Tabelën 7), rreth 72 % e këtyre grave janë të papuna (vetëm 16 % pohuan punësimin e tyre të rregullt), nuk kanë asnjë burim të qëndrueshëm të ardhurash. Këto familje përballojnë jetesën me të ardhura nga punë të rastësishme dhe, më së shumti, përmes punimit dhe mbjelljes së tokës në vendbanimin e tyre; disa prej grave bënin punë dore dhe punime të vogla artizanale, por edhe me këto punë nuk fitonin shumë pasi nuk kishte interes për blerje. Vetëm 14 % e familjeve pohojnë se kanë 2 burime të ardhurash dhe këto janë familje që kanë një të punësuar dhe një pension ose ndihmë sociale nga shteti.

Një gjendje e tillë ka si shkak disa faktorë, të cilët kanë dalë në pah edhe në këtë studim, por ndër faktorët kryesor që kushtëzojnë këtë gjendje janë: *niveli arsimor* (pjesa më e madhe me arsim 8-vjeçar), *mungesa e një profesioni, përshtatje e ngadaltë me jetesën në vendbanimin e ri*, pasi pothuajse të gjitha gratë vijnë nga fshatra të zonës së Veriut.

- Në vitet e tranzicionit vihet re ***dukuria e migrimit të brendshëm*** e familjeve të grave të ngujuara. Këtij fakti mund t'i shtohet edhe ***emigracioni jashtë vendit*** i disa familjeve të tjera. Edhe pse kokretisht kanë migruar, një nga problemet e mëdha të familjeve që janë në situatë gjakmarrje është se, një pjesë e tyre, akoma nuk ka bërë zhvendosje të rregullt për në vendbanimin e ri të gjendjes së tyre civile. Sipas të dhënave tona, kjo për shkak të nevojës për t'u fshehur nga gjakësi, por duke shmangur edhe pagesat ndaj shërbimeve publike. Kështu, sipas të dhënave që mundëm të siguronim, vihet re se 69 % e grave pohojnë se lëvizja për në vendbanimin e ri nuk e ka përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike ose e ka

përkeqësuar atë, duke i bërë këto familje të zhgënjyera nga lëvizja për të gjetur një jetë më të mirë. Të ndodhura në një situatë tillë zhgënjyese, gratë e pyetura u shprehën se ishin të pashpresa për ndonjë zgjidhje të mundshme të situatës, pasi përpjekjet e njëpasnjëshme për pajtim kishin dështuar. Tani kishin ngelur jo vetëm pa punë e pa tokë bujqësore, por dhe me barrën e shtuar për të paguar edhe qera për shtëpinë ku ato banonin. Këto fakte e rrethana të reja bëjnë që ato të ndjehen edhe më tepër të ngarkuara emocionalisht, pasi janë shtuar debatet e tensionet brenda familjes. Por në këtë realitet të ri ato e ndjejnë veten gjithnjë e më të harruara nga shteti dhe, duke u ndeshur me një realitet të tillë të pashpresë, duket se kanë gjetur si të vetmin mjet argëtimi telenovelat, muzikën dhe lajmet.

▪ ***Vlerësimi në aspektin gjinor.*** Familjet e grave të ngujuara janë me 4-7 anëtarë në pjesën më të madhe të tyre. Bie në sy fakti se në këto familje numuri i djemve të lindur është tepër më i madh se ai i vajzave. Sipas të dhënave statistikore (që jepen në Grafikon 3), vihet re se ***djemtë janë 61 % e numrit të fëmijëve të lindur nga gratë e ngujuara.*** Mendoj se kjo nuk është rastësi dhe do të donte kohë të mjaftueshme për ta trajtuar si temë më vete, por në kënvështrimin e temës sonë kjo dukuri ndodh për një sërë arsyes. Kështu po mundohem të veçoj disa prej tyre. Tashmë është i njohur fakti që gjakmarrja prek më drejtpërdrejt seksin mashkull, burrat e djemtë, dhe dukuria e lindjes së meshkujve në numër më të madh sesa femrat duket se është një ndikim nga stereotipet gjinore, që janë mjaft të theksuara në këtë komunitet. Prejardhja familjare dhe jetesa në vendet ku traditat janë trashëguar brez pas brezi, qofshin ato të mira apo jo, i ka bërë këto gra të nënshtrohen pa kushte dhe në të gjitha vendimet t’iu binden burrave dhe djemve të shtëpisë deri edhe në ato më skllavërueset për gruan. Prejardhja i ka mësuar t’u lënë vendin e parë djemve dhe burrave për gjithçka e në

çdo gjë. Një fakt i tillë e ka fuqizuar instinktin e nënës për të treguar më tepër kujdes e dashuri ndaj krijesës mashkull edhe për faktin se të jetuarit në mjedisin e tyre, ky seks është vzhdimisht në shënjestër të goditjes që jep marrja e gjakut.

▪ ***Gratë e ngujuara nuk martohen përsëri nëse burri është vvarë.*** Nga kërkimi ynë u vu re se në rrethin e grave të ngujuara ka edhe gra që janë kryefamiljare për shkak se kanë humbur burrat e tyre nga gjakmarrja. Sipas të dhënave të paraqitura në Grafikun 1 të këtij punimi, nga gjithë popullsia e grave të përfshira në studim, 22 % e tyre rezulton se kishin humbur bashkëshortin dhe, pas kësaj, asnjëra nuk ishte martuar rishtaz. Kjo gjetje shpjegohet me faktin se gratë e ngujuara rriten me mendësinë e nënshtrimit ndaj fatkeqësisë, me forcën e zakonit për t'u treguar e duruar në fatkeqësi familjare dhe për ta përballur fatkeqësinë në heshtje duke pranuar që ky ishte 'fati' i tyre.

▪ ***Dukuria e gjakmarrjes është e pranueshme në lidhjet e reja martesore.*** Në lidhjet e reja martesore, kuptuam se gratë e reja nuk dinin të flisnin në detaje për historinë e përfshirjes së familjes në gjakmarrje. Madje disa prej tyre nuk kishin dijeni që djali që po ju kërkonte dorën për martesë vuante fenomenin para se ata të martoheshin. Gjithsesi ato deklaruan që edhe nëse do kishin dijeni, përsëri do të martoheshin me ta. Kjo mënyrë reagimi duket disi e pabesueshme dhe e çuditshme në ditët e sotme. Por, megjithatë kështu ndodh, dmth të pranosh vullnetarisht e me dëshirë të jetosh në një ambient të tillë ku siguria është gjëja e fundit që mund të pretendohet. Duket sikur jeta e mbushur me ankth e stres është një lloj normaliteti i veçantë për këtë rreth familjesh.

▪ Në kërkimin tonë për të gjetur arsyet e vrasjeve fillestare të ndodhura, shkaktare për përfshirjen e familjeve në gjakmarrje, na ndihmuan shumë të dhënat nga fokus grupet. Këto vrasje mund të ndahen në dy kategori:

- Duket se një pjesë e vrasjeve kanë në themel **faktorë ekonomikë**. Pra, rreth 30 % e këtyre konflikteve janë të lidhur me problemet për pasuritë e paluajtshme, për kanalet vaditëse në tokat bujqësore, si dhe për toka e kullota, e të tjera.
- Ndërsa pjesa më e madhe e vrasjeve ka në themel faktorë të tjerë dhe marrin shkas nga **prekje në çështje nderi, nga zënka, rrahje, grindje e fyerje të çastit e të tjera**.

Sigurisht, në këtë vështrim, nuk mund të mohohet ndikimi i kanunit në vrasje, por ai nuk duhet absolutizuar. Në këtë përfundim të çon edhe fakti që në vrasje janë të përfshirë edhe shumë të rinj, të cilët nuk e kanë njohur kanunin, por vetëm e përdorin atë për të mbuluar dëshirën e tyre për hakmarrje dhe vetë-gjyqësi. Madje disa prej grave u shprehën *se të rinjtë e sotëm i kanë deformuar rregullat e kanunit dhe po vrasin gra, fëmijë dhe klerik. Vrasja e kësaj kategorie njerëzish është e ndaluar dhe dënohet rreptësisht nga ligjet e kanunit. Madje sot kleri nuk ka më fuqinë dhe pushtetin e përcaktuar në kanun, Besa nuk mbart më të njëjtën peshë, dhe procesi i ndërmjetësimit me pleqtë dhe bajraktarët, nuk respektohet më si më parë.*

Nga të dhënat (në Tabelën 10) kuptojmë se njerëzit që kanë bërë vrasjen fillestare janë kryesisht anëtarë të afërt të familjes: burri, kunati, xhaxhai i burrit, kushëri i afërt, por përfshihen edhe lidhjet e krushqisë (vjehtë apo vjehtëra), por dhe lidhje të tjera fisnore. Edhe pse këto familje kanë migruar dhe disa prej tyre janë në distancë gjeografike larg familjarëve të tyre, ata vazhdojnë të ruajnë marrëdhënie të ngushta me ta dhe ndikimi i tyre është i

pashmangshëm pavarësisht largimit. Gjithashtu pavarësisht migrimit në zona ku më parë nuk ka ekzistuar gjakmarrja, këto familje i kanë mbartur me vete këto probleme edhe në vendbanimin e ri

Nga të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorve si dhe nga historitë e jetës së tyre nuk rezultoi ndonjë grua që të ishte e përfshirë drejtpërsëdrejti në vrasje fillestare apo në marrje gjaku. Kur në një prej fokus grupeve hodhëm në diskutim një shembull të tillë të trajtuar në shtypin e përditshëm, ku një grua lan gjakun e vëllait të saj duke vrarë një fëmijë, disa prej grave u empatizuan me të dhe deri diku e mirëkuptonin gjestin e saj. Madje, disa prej tyre e justifikuan krimin e kryer.

Nga gjithë shtjellimet e bëra më sipër arrijmë në përfundimin se vërtetohet Hipoteza 1 e shtruar në fillim të punimit. Dmth. *fenomeni i gjakmarrjes ka ndikim të drejtpërdrejtë në shumë aspekte të jetës sociale të grave të familjeve të ngujuara* kudo që ato gjenden.

5.3. Gjetje lidhur me këndvështrimin psikologjik të grave të ngujuara

Në vështrimin tonë, duhet vlerësuar aspekti psikologjik, pasi deri tani nuk është vlerësuar dhe nuk ka studime të kësaj natyre tek ne. Ky vlerësim bëhet duke marrë për bazë faktin se ***gratë e ngujuara kanë përjetuar trauma psikike*** (kanë qenë të pranishme në vrasje). Këto ngjarje përjetojnë thellë emocionalisht dhe emocionet e forta, kanë lenë gjurmë të forta apo të pashlyeshme në memorien e tyre dhe këto kujtime e shoqërojnë personin gjatë gjithë jetës. Në vështrimin psikologjik kjo do të thotë se ***gratë e ngujuara kanë probleme lidhur me shëndetin e tyre mendor***, bëjnë jetë të stresuar, jetojnë në ankth dhe frikë dhe pikërisht për këtë arsye kanë nevojë edhe për shërbime psikologjike.

Në gjendjen e tyre psiko-emocionale gratë karakterizohen nga stresi, frika dhe pasiguria për të ardhmen e tyre dhe të familjes së tyre. Ndërsa flasin për të ardhmen ato ndjehen të pasigurta, pa shpresë dhe me ankth e frikë. Ato e shohin veten të pafuqishme për të ndikuar në situatën e tyre dhe gjithë fuqinë dhe kompetencat për të zbutur fenomenin ato ia faturojnë shtetit dhe zbatimit të ligjit në më të shumtën e rasteve.

Nisur nga fakti se gratë e ngujuara bëjnë një jetë të stresuar, për këtë arsye në kërkimin tonë përdorim qëllimisht një instrument për të parë praninë e simptomave të Çrregullimit të stresit post traumatik dhe cili është niveli i shfaqjes së tyre tek kjo kategori gravsh. Nga analiza e të dhënave është arritur në përfundimin se të gjitha gratë që janë pjesë e kampionit tonë kanë përjetuar në të shkuarën e tyre së paku një ngjarje të rëndë traumatike. Ky fakt është një nga kriteret kryesore vlerësuese, që i bën këto gra të jenë të predispozuar ndaj çrregullimit të stresit post traumatik. Për këtë:

- Nga kërkimi ynë është gjetur se vlerat totale të Çrregullimit të Stresit Post Traumatik, janë paraqitur në mesatare 33.50, po të kemi parasysh vlerat maksimale të fituara nga PSS-I (51), vlerat e fituara nga pjesëmarrëset në hulumtimin tregojnë ***për një shfaqje me tendencë ashpërsie të simptomave të Çrregullimi i Stresit Post Traumatik.***
- Gratë në këtë studim shënuan vlera mjaft të larta për shmangien e mendimeve dhe ndjenjave lidhur me traumën. Po kështu, vlera të tjera të larta të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik u shënuan në lidhje me ndryshimin e planeve dhe me mungesën e shpresës për të ardhmen. Gratë kanë qenë të hapura dhe janë përpjekur që të flasin e t'iu tregojnë edhe të tjerëve çdo aspekt të traumës. Me shumë mundësi kjo ka qenë një nga mënyrat sesi gratë kanë kërkuar ndihmë nga njerëzit e tyre të afërt për

mbështetje mbas ngjarjes traumatike. Në një farë mënyre, duke folur për përjetimin e traumës, për mbresat, për mënyrat sesi janë ndjerë, duke u shprehur ato kanë ndihmuar edhe veten për të gjetur një farë qetësie dhe mbështetje nga të afërmit e tyre.

- Këtu vërtetohet edhe teoria që parashtruar më sipër, që edhe pse gratë kanë predispozita më të larta se sa burrat për t'u prekur nga çrregullimi i stresit post traumatik, ato janë më të mira dhe iu vjen më natyrshëm domosdoshmëria në kërkimin e ndihmës dhe suportit pas traumës.
- Të intervistuarat në studim kanë shënuar vlera të larta në rubrikën e hipervigjilencës dhe veçanërisht në vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë.

Këto gjetje besojmë se japin përgjigje për **Pyetjen numer 2**. *Si ndikon aktualisht gjakmarrja në gjendjen psikologjike të grave të ngujuara?*

Instrumenti për praninë e simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik na tregon jo vetëm prezencën, por edhe intesitetin e këtyre simptomave në jetën e përditshme të këtyre grave. Tregon gjithashtu se fenomeni i gjakmarrjes rrit mundësinë që gratë e familjeve të ngujuara të vuajnë nga çrregullimi i stresit post traumatik për një kohë të gjatë. Pra, fenomeni i ngujimit shoqërohet me një jetë tepër stresante dhe me prani të simptomave të çrregullimit të stresit post traumatik tek këto gra, të cilat zgjasin në kohë dhe i shoqërojnë ato gjatë gjithë jetës. Duket sikur ato mësohen me një jetë të tillë dhe e kanë të vështirë të shpëputen prej saj. Edhe pse gra të ndryshme janë përballur gjatë jetës së tyre me trauma të ndryshme dhe jo me të njëjtin numër traumash, ato kanë diçka të përbashkët. Trauma më e madhe me të cilën të gjitha gratë janë përballur është shkaktuar nga fenomeni i gjakmarrjes ose nga një vrasje që ka qenë shkak për futjen e familjes së tyre në këtë cikël vrasjesh,

vetëgjyqësie dhe vetëmohim lirie. Këto gjetje vërtetojnë Hipotezën 2: *Fenomeni i gjakmarrjes ka impakt negativ afatgjatë në psikologjinë e grave të ngujuara*. Por kjo vërtetohet edhe me gjetje të tjera:

- Prania e një **frike të tejshtuar**, jo vetëm për jetën e tyre, por edhe të familjarëve të tyre. Madje, edhe gratë që nuk vuanin fenomenin e gjakmarrjes, kur përmendej ky term dukej se i kaplonte një frikë e pashpjegueshme. Prezenca e kësaj frike tek gratë që vuajnë fenomenin, mund të jetë një ndër faktorët kryesor për çrregullimin e stresit post-traumatik.
- **Mungesa e shpresës për të ardhmen** është një faktor tjetër i përbashkët që u vu re në të gjitha intervistat e kryera me grtë e ngujuara. Edhe pse janë në moshë të re dhe me shumë vite fizike për të jetuar, duket sikur shpresa ka vdekur tek këto gra. Ato kanë rreshtur së jetuari për veten e tyre dhe i vetmi motiv për jetën janë fëmijët. Duket se jeta e tyre ka rreshtur që në momentin e ngujimit. Të jetuarit është kthyer si detyrë dhe si një borxh që ato ia kanë brezit pasardhës.
- **Pafuqia për të ndryshuar realitetin në të cilin ndodhen**. Një nga përgjigjet instiktive psikologjike të individëve të gjendur përpara situatave kërcënuese dhe të rrezikshme është mekanizmi “*lufto ose vrapo*”. Në rastin tonë, ky mekanizëm duket sikur është paralizuar, pasi si zgjidhje të vetme familjet ëndërrojnë emigrimin jashtë vendit, duke e parë këtë si e vetmja mundësi e sigurt për shpëtimin e tyre, por e kanë kuptuar që kjo gjë është e pamundur dhe në këtë mënyrë familjet kanë zgjedhur të fshihen e të ngujohen në shtëpitë e tyre duke mos bërë më asnjë përpjekje për të dalë nga situata e ngujimit.

- ***Akuzimi i vazhdueshëm i palëve të treta*** dhe më saktë i instancave shtetërore për indiferencën e treguar ndaj këtij fenomeni e ndaj këtyre familjeve. Mendoj se në shumë raste kjo akuzë është e padrejtë, pasi pjesa më e madhe e familjeve nuk e kanë denoncuar në polici rastin apo kërcënimin që iu kanoset. Kjo bëhet për dy arsye:

Së pari, sipas kanunit të Lekë Dukagjinit, denoncimi konsiderohet si dobësi dhe si mungesë trimërie. Fakti që një familje shkon në polici, sipas kanunit përkethehet që meshkujt e asaj familje s'janë në gjendje dhe të fortë mjaftueshëm që të zgjidhin konfliktin vetë e të bëjnë vetë-drejtësi, por e kërkojnë këtë ndihmë nga shteti.

Së dyti, ata nuk e regjistrojnë veten si familje në ngujim, pasi nuk kanë besim fare tek shteti shqiptar, që mund të bëjë ndonjë gjë për gjendjen e tyre. Madje, kanë frikë që informacionet që mund të jepen në policinë e shtetit mund të jenë lehtësisht të aksesueshme nga gjaksi dhe në këtë rast ata ndihen më të ekspozuar për t'u vrarë dhe jo më të mbrojtur. Ky faktor na drejton në hallkën tjetër që është dëshira që kanë familjet e prekura nga gjakmarrja për *Legalizimin e Kanunit*.

Mungesa e besimit në instancat shtetërore i shtyn këto familje që të aktivizojnë e të besojnë më shumë në kanun, pasi kanuni sipas arsytimit të tyre, u jep të drejtën që të marrin gjakun me duart e tyre dhe t'a lajnë gjakun me një gjak tjetër dhe jo me një dënim me burg, siç do të bënin gjykatat e Shqipërisë.

Por edhe kjo ka shkuar shumë larg dhe nuk ka lidhje fare me kanunin, pasi siç konstatuam edhe më sipër, pjesa më e madhe e familjeve nuk e kanë lexuar kurrë dhe nuk e kanë idenë

se çfarë shkruhet në kanun, gjë që ka çuar në deformime masive të këtij kodi zakonor që me praktikat e sotme duket më shumë si një ligj xhungle dhe mbijetese.

Është interesant fakti se si lidhen të gjithë këta faktorë si një zinxhir që i mban të lidhura këto familje në mentalitetin primitiv të vetëgjyqësisë. *Varfëria ekstreme* që i karakterizon të gjitha këto familje si dhe *zhgënjimi* nga pritshmëritë që vendi i ri ku migruan do të ishte më i mirë se vendi që lanë pas dhe do ia u bënte jetën më të lehtë, janë hallka të tjera të këtij zinxhiri.

Trajtimi i kësaj teme edhe në vështtrimin psikologjik mendoj se e bën më të plotë njohjen e këtij realiteti. Për rrjedhojë, kjo do të sillte një kontribut real jo vetëm për njohje më të thelluara, por do të ishte edhe një ndihmesë më efikase në gjetjen e rrugëve apo mënyrave për të shkuar drejt reduktimit apo kapërcimit të rasteve me konflikte të tilla sociale, që aktualisht janë të pranishme në realitetin shqiptar.

KAPITULLI VI

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij studimi të kryer nga ana jonë po bëjmë fillimisht një përmbledhje të rezultateve e gjetjeve, të cilat mendojmë se mund të jenë të vlefshme për të tërhequr vëmendjen e të gjithë aktorëve që kanë mundësi të ndikojnë për zgjidhjen e problematikave me të cilat përballen gratë e ngujuara në vendin tonë. Më pas, do të prezantojmë edhe disa rekomandime e sugjerime përmes të cilave synojmë të jemi sado pak kontribues në këtë fushë kërkimi për të ndihmuar sado pak në reduktimin e fenomenit të gjakmarrjes dhe sidomos të pasojave të saj.

6.1. Konkluzione të përgjithshme

Përmes këtij studimi u arrit në përfundimin se gjakmarrja është një dukuri sociale dhe që është e pranishme në realitetin shqiptar edhe sot në kohët moderne. Ajo ndikon negativisht mbi gratë e familjeve të ngujuara si në aspektin social, ashtu edhe në atë psikologjik.

Konkluzioni i parë lidhet me faktin se gjetjet dhe konkluzionet e arritura janë në përputhje me qëllimin e punës sonë. Besojmë se në tërësi ato u japin përgjigje dy pyetjeve kryesore kërkimore si dhe vërtetojnë hipotezat e parashtruara në kapitullin e parë si dhe në kapitullin mbi metodologjinë e kërkimit.

Gjakmarrja si dukuri sociale është më e pranishme në ditët e sotme në disa komunitete veriore të territorit shqiptar. Duhet theksuar se gjakmarrja në realitetin e sotëm ka një ndryshim të madh në raport me gjakmarrjen mesjetare të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Sot ajo

paraqitet më tepër si një formë vetëgjyqësie e individëve dhe familjeve të lënduara, të cilat janë të pafuqishme të mbajnë nën kontroll etjen e vazhduar për hakmarrje e vrasje.

Në të gjithë tranzicionin e tejzgjatur që ka kaluar vendi ynë, qeverisja vendore dhe lokale nuk ka mundur të mbajë nën kontroll këtë fenomen, sidomos dimensionin kriminal të tij. Arsye e mundshme për këtë mund të jetë edhe mosfunksionimi si duhet i shtetit në tranzicionin e tejzgjatur që kombi ynë ka kaluar dhe po vazhdon të kalojë.

Lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë e mbartën dukurinë e gjakmarrjes edhe në zona të tjera të vendit, ku ajo nuk njihej më parë, si psh. në zonat e Tiranës, Durrësit e të tjera. Gjithashtu, një nga pasojat e kësaj lëvizjeje është mbipopullimi i disa zonave, që në një mënyrë u bë edhe premisë e favorshme për mbajtjen gjallë të këtij fenomeni si dhe të krijimit të rasteve të reja të gjakmarrjes.

Studimi në Bathore dhe në Shkodër tregon se, jo vetëm në zonat e lokalizuara ku gjakmarrja ka patur një përhapje më të madhe, por edhe në zona të tjera të populluara në vitet e tranzicionit, kjo dukuri është mbartur dhe janë krijuar grupe sociale të familjarëve të ngjuar. Pjesë e këtij grupi janë gratë, burrat dhe fëmijët, të cilët pavarësisht nga zhvendosja vazhdojnë të vuajnë dramën tragjike të gjakmarrjes. Ata janë të fshehur jo vetëm nga shënjestra e hasmit, por edhe nga syri dhe kujdesi i shtetit dhe i shoqërisë.

Aktualisht, gratë dhe familjet e tyre që vuajnë fenomenin e gjakmarrjes duhet domosdoshmërisht të jenë në vëmendjen e shtetit shqiptar dhe të së gjithë shoqërisë duke iu ofruar atyre suport ligjor, psiko-social dhe ekonomik.

Një ndër aspektet sociale ku ky fenomen ndikon drejtpërdrejtë është gjendja ekonomike si dhe pamundësia për punësim e këtyre familjeve. Vihet re se këto familje janë në varfëri të plotë, pasi burrat që janë gjallë e kanë të pamundur punësimin, jo vetëm për shkak të frikës nga hasmi, por edhe për faktin tjetër se punëdhënësit nuk i marrin në punë, nëse e dinë që ata janë target i gjakmarrjes. Shumica e grave, nga ana tjetër, janë të paarsimuara dhe të pakualifikuara për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Për këtë, ato janë më të impenjuara me kërkesat për t'u kujdesur për familjen, e cila jeton në kushte jonormale.

Në studimin tonë vihet re se ka një lidhje të ndërsjelltë mes varfërisë dhe gjakmarrjes. Pra, një ndër faktorët që mund të nxisë konflikte të reja dhe shkaqe për fillimin e një hasmërie është varfëria. Por, shpesh ndodh edhe e anasjellta, që gjakmarrja shkakton dhe bëhet burim i varfërisë. Shumica e grave të intervistuar në këtë studim jetojnë në varfëri të plotë.

Fenomeni i gjakmarrjes ka ndikim të fortë në marrëdhëniet që këto gra përjetojnë brenda familjes së tyre. Fakti që burrat janë gjithë ditën në shtëpi, nën presionin e frikës së vdekjes, i bën ata të stresuar dhe shpesh të mbipërdorin alkolin për të mos menduar për realitetin në të cilin ndodhen. Shpesh, ata përdorin dhunë ndaj grave duke shfaqur shenja fanatizmi dhe xhelozie për faktin se gratë duhet të dalin jashtë mureve të shtëpisë për të kryer shërbime dhe në këtë mënyrë ato janë jashtë kontrollit të burrave të tyre të ngujuar.

Gratë dëshmojnë se marrëdhëniet bashkëshortore dhe marrëdhëniet me fëmijët janë më të tensionuara dhe më të përkeqësuar për shkak të gjakmarrjes. Marrëdhëniet me djemtë ndërlikohen, kur nënat u kërkojnë të rrinë brenda në shtëpi ose të kenë kujdes kur dalin.

Ky fenomen ndikon negativisht edhe në marrëdhëniet e grave me komunitetin dhe me mjedisin rrethues. Fqinjët janë më të stepur për t'i vizituar këto familje e sidomos nëse janë nga një zonë tjetër origjine. Vizita e tyre shoqërohet me dyshim e mosbesim nga familja e ngjuar. Pra, gratë e familjeve të ngjuara fizikisht janë të lira, por kohën e tyre të lirë e kalojnë brenda me familjen e tyre dhe nuk ndërveprojnë shumë me komunitetin. Pra, në një farë mënyre duket se ato janë fizikisht të lira, por nuk janë të lira në të vërtetë.

Jetesa e këtyre grave me familjarë të ngjuar, shkëputja nga zhvillimet sociale, jetesa në varfëri dhe izolim të plotë ka sjellë dhe vazhdon të sjellë pasoja për gjendjen e tyre psikologjike. Kjo situatë është premisë që favorizon gjendje emocionale negative tek gratë, dëshirën për hakmarrje, kalimin e traumave tek fëmijët e tyre, duke e bërë këtë fenomen një zinxhir të pathyeshëm, madje as nga koha.

Gratë e ngjuara shfaqën simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik, të cilat u evidentuan se ishin prezente tek to në një formë mjaft agresive. Gratë në këtë studim shënuan vlera mjaft të larta për shmangien e mendimeve dhe ndjenjave lidhur me traumën. Vlera të tjera të larta të simptomave të çrregullimit të stresit post-traumatik u shënuan në lidhje me ndryshimin e planeve dhe mungesë të shpresës për të ardhmen.

Të intervistuarat në studim kanë shënuar vlera të larta në rubrikën e hipervigjilencës e veçanërisht janë në vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë. Në të gjithë pyetësin, vlera më të larta të simptomave të çrregullimit të stresit post-traumatik janë shënuar në sjelljet shmangëse, ndërsa në dy rubrikat e tjera, në atë të ripërjetimit dhe të hipervigjilencës vlerat e shfaqura janë të ngjashme.

Në varësi të numrit të fëmijëve që kanë, tek gratë e ngujuara u shfaq një korrelacion mjaft i dobët pozitiv dhe dallime të vogla të rëndësisë statistikore në të gjitha shkallët si dhe në vlerat totale të çrregullimit të stresit post-traumatik.

Për të treguar lidhjen mes variablave, morëm si variabla predikatore nivelin e arsimit, statusin civil, numrin e anëtarëve të familjes, nivelin e të ardhurave të familjes, statusin aktual të punësimit, sektorin e punësimit dhe vitet në ngujim. Këto variabla nuk janë predikatore për çrregullimin e stresit post-traumatik.

Korrelacioni mes variablës së varur që është çrregullimi i stresit post-traumatik dhe variablës së pavarur që është mosha e pjesëmarrëseve është pozitiv dhe tregon një lidhshmëri të moderuar ndërmjet dy variablave. Masa e fuqisë shpjeguese është 13 %. Këto rezultate tregojnë se 13% e shkallës së çrregullimit të stresit post-traumatik mund të shpjegohet nga mosha e pjesëmarrëseve, ndërkohë që pjesa tjetër e përqindjes shpjegohet nga faktorë të tjerë.

Ndërsa kemi studiuar gjendjen sociale dhe psikologjike të këtyre grave vëmë re se ato karakterizohen nga një mungesë e theksuar iniciative për të bërë diçka duke ndryshuar kështu gjendjen që ato dhe familjet e tyre ndodhen. Ato kanë një nënshtrim të heshtur ndaj gjendjes në të cilën ndodhen, të mbushura plot me frikë, ankth dhe pa shpresë për të ardhmen. Gra që vuajnë mungesën e partnerëve të tyre, të cilët edhe pse janë gjallë, duket sikur s'janë, kjo nisur edhe nga fakti që ata janë kandidatë për t'u vrarë dhe target i gjakmarrjes. Këto nëna nuk iu gëzohen rritjes së fëmijëve të tyre, pasi edhe ata me rritjen mund të plotësojnë kushtet për t'u bërë target i gjakmarrjes.

Fëmijët e këtyre familjeve jetojnë në një mjedis të deformuar dhe kjo mund të jetë premisë për krijimin e personaliteteve të deformuar asocialë. Edhe fëmijët rriten me frikë dhe pa ëndërra për të ardhmen e tyre.

Familjet e ngujuara, gratë dhe fëmijët e tyre mund të identifikohen si një grup vulnerabël të cilët pa mbështetjen ligjore, ekonomike e sociale të shtetit dhe të së gjithë shoqërisë, mbetet të mbijetojnë me vështirësi që sjell fenomenin e gjakmarrjes. Ky fenomen sot është mjaft kompleks, dhe lufta kundër tij kërkon angazhimin e të gjithë shoqërisë shqiptare me në qendër instancat shtetërore.

6.2. Rekomandime e sugjerime

Duke u marrë konkretisht me studimin e problematikës së grave të ngujuara, mendoj se nuk mjafton vetëm të analizosh situatën e tyre, të njohësh gjendjen sociale e psikologjike me të cilën ato përballen çdo ditë. Për këtë, sugjeroj se duhet të njihen konkretisht edhe rrugët apo mënyrat si kanë vepruar vendet e zhvilluara për të reduktuar dhe për ta mënjanuar nga realiteti i tyre këtë dukuri.

Për t'i bërë sa më efektive përpjekjet për parandalimin e dukurisë së gjakmarrjes, kryesisht në zonat Veriore dhe Verilindore të Shqipërisë, politikbërësit duhet të vlerësojnë me përgjegjshmëri problematikën e këtij target grupi, të cilët ende jetojnë me të njëjtat mendësi e zakone si të dhjetëra e qindra viteve më parë. Për këtë, duhen ndërtuar strategji të qëllimshme për të prekur më nga afër jo vetëm në teori, por edhe në praktikë këtë realitet të dhimbshëm.

Aktualisht përpjekjet për intergrimin e vendit në Bashkimin Europian, përpjekja për pastrimin dhe luftën kundër korrupsionit në sistemin shqiptar të drejtësisë, lëvizja e lirë e njerëzve, e të tjera, kanë krijuar mundësi, në favor të reduktimit të dukurië së gjakmarrjes, por këto mundësi e rrethana nuk vlerësohen siç duhet. Rekomandojmë se krahas vlerësimit të realitetit, duhen hartuar edhe plane e strategji afatgjata nga institucionet shtetërore qendrore dhe ato lokale. Pra, për momentin ka ardhur koha që krahas evidentimit sa më të shpejtë të familjeve të prekura nga gjakmarrja, është mëse e nevojshme të ndërtohen edhe politika nxitëse që sjellin siguri dhe ngjallin shpresa për të ardhmen e këtyre familjeve.

Gratë dhe fëmijët e këtyre familjeve përbëjnë një grup vulnerabël që kërkon domosdoshmërisht mbështetjen ligjore, ekonomike dhe sociale jo vetëm të shtetit, por dhe të së gjithë shoqërisë. Në këtë vështrim, është e nevojshme që këto gra të bëhen të dukshme për veten e tyre dhe për shoqërinë.

Rezultatet e këtij studimi mund të përdoren nga grupe të ndryshme të interesit me qëllim për t'i ardhur në ndihmë këtij grupi vulnerabël. Studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale duhet të konsiderojnë evidentimin e situatave të këtyre kategorive sociale, dukurinë e gjakmarrjes dhe pasojat e saj për zhvillimet e ardhshme sociale. Ata kanë një mundësi që të zbulojnë dhe të analizojnë fakte sociologjike, të kryejnë studime të ndryshme, por edhe të ndikojnë në rritjen e ndjeshmërisë së politikbërësve.

Gjakmarrja shoqërohet pashmangshmërisht me varfëri. Në shumicën e rasteve ajo është jo vetëm pasojë e varfërisë, por edhe burim për të. Pjesa më e madhe e subjekteve të studimit tonë është evidentuar që jetojnë në varfëri të plotë, prandaj sugjerohet se punësimi i kësaj

kategorie të grave duhet të jetë prioritar dhe fokus i shtetit dhe i organizmave të tjerë publik dhe jo publik. Është e nevojshme që të ndërtohen politika për zhvillimin ekonomik të këtij komuniteti.

Duke qenë se një familje përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, nën dritën e rezultateve të nxjerra nga ky studim, mund të kuptojmë kushtet në të cilat rriten këta fëmijë. Rekomandohet që në të ardhmen të bëhen studime të ngjashme edhe me fëmijët e këtij grupi në mënyrë që të ndihmohet familja me të gjithë elementët dhe në tërësinë e saj.

Rekomandohet që planet mësimore dhe mësuesit e shkollave që kanë një kontigjent të tillë fëmijësh, t'iu kushtojnë një vëmendje të veçantë dhe shpesh të përfshijnë edhe psikologun për një ndihmë më të specializuar ndaj tyre.

Ky grup i veçantë duket se është edhe jashtë vëmendjes së aktorëve të tjerë social si përfaqësuesit e pushtetit vendor, mësuesve të zonës, veprimtarëve socialë, OJF-ve, veçanërisht shoqatave të grave dhe grupeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Rekomandohet që instancat përkatëse shtetërore së bashku me OJF-të e ndryshme që punojnë në terren me këtë grup, të lënë mënjane statistikave të tyre individuale dhe të bashkëpunojnë për të bërë një regjistrim dhe evidentim më të saktë dhe të përbashkët të të gjitha këtyre familjeve. Siç pamë edhe në këtë studim, pjesa më e madhe e familjeve janë të pa evidentuara nga policia, pasi denoncimi në polici në mentalitetin e këtij komuniteti përket në dobësi dhe frikë ndaj familjes tjetër.

Një sugjerim del edhe për ligjvënësit lidhur me përmirësimin e legjislacionit aktual për personat që kryejnë vrasje për gjakmarrje. Sugjeroj që për një periudhë të pacaktuar kohore

të hiqet masa e lehtësimit me uljen e 1 / 3 së dënimit për vrasësit që gjatë seancave gjyqësore pranojnë që vrasjen e kanë bërë për qëllim gjakmarrje. Përveç kësaj, duhet të zbatohet ligji me përpikmëri duke shpresuar që zbatimi i tij mbi disa individë, do të bëhet shembull dhe do të parandalojë krime në të ardhmen nga individë të tjerë.

Sygjeroj që të caktohet një ditë kombëtare kundër gjakmarrjes, në mënyrë që e gjithë shoqëria civile, njerëzit që e vuajnë fenomenin dhe palët e interesuara për këtë kategori njerëzish, të kenë mundësi dhe hapësirat mediatike për të lobuar pro jetës. Deri tani, përveç rasteve të rralla, këto mundësi janë fituar me jetën e humbur të personit të radhës, duke u bërë një kronikë lajmesh dhe një statistikë në listën e vrasjeve për gjakmarrje.

6.3. Sugjerime për kërkime të tjera

- Duke qenë se një familje e ngjuar përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, nën dritën e rezultateve të nxjerra nga ky studim, mund të kuptojmë më mirë kushtet në të cilat rriten këta fëmijë. Nisur nga ky fakt, sugjerojmë që në të ardhmen të bëhen studime të ngjashme edhe me fëmijët e këtij grupi social, në mënyrë që të ndihmohet familja në të gjithë elementët e saj.
- Jemi të vetëdijshëm që traumat e përjetuara në të shkuarën mund të ndikojë në gjendjen psikologjike të individëve dhe t'i shoqërojnë ata në situatat që vijnë pas. Por objekt i temës sonë është problematika sociale dhe ajo psikologjike e grave të ngjuara, prandaj jemi fokusuar në këtë vështrim. Në punime të mëtejshme mund të bëhet një studim më i zgjeruar, duke përfshirë edhe traumat që këto gra kanë kaluar në fëmijëri. Shërbimet e sotme psikologjike i vlerësojnë tej mase traumat e fëmijërisë, pasi ato rrinë të fjetura në pavetëdijen e individit dhe mund të aktivizohen edhe në mosha të rritura.

Leo Buscaglia në librin e tij “Të jetosh, të dashurosh e të kuptohesh” thotë se:

‘Vdekja na mëson se jeta ka një kufi’. Por nuk ka ndodhur kështu me këto gra. Vdekja që kanë përjetuar ka bërë që ato të humbasin jo vetëm njeriun e dashur të zemrës, por edhe dëshirën për të jetuar, për të gëzuar dhe për të shpresuar. Ato kanë humbur veten dhe egzistencën e tyre. Duke parë ndikimin që këto gra kanë në rritjen e fëmijëve të tyre, ato e transmetojnë këtë gjendje edhe tek ata. Por ka shpresë. Thirrja e njërës prej vajzave tek intervistat e fokus grupeve ishte: “Unë dua të shkoj në shkollë! Unë dua të dal! Unë dua të qesh! Unë dua të gëzoj! Unë dua të jetoj!” Kjo është një thirrje për ndihmë, prandaj le të behemi të gjithë së bashku për t’iu përgjigjur kësaj thirrje duke mos harruar që: Vdekja, përveç të keqes së madhe që shkakton, ka edhe diçka positive. Ajo na mëson se jeta ka një kufi dhe se koha jonë në këtë tokë është e limituar. Fatkeqësia më e madhe e njeriut është të shkoj në prag të vdekjes për të kuptuar që s’ka jetuar kurrë’.

Le të përpiqemi, të shpresojmë dhe të besojmë që ky nuk do të jetë rasti i këtyre grave.

Referencat

1. Adler A. B., Wright K. M., Bliese P. D., Eckford R. & Hoge C. W.(2008). *A diagnostic criterion for combat-related posttraumatic stress disorder*. Journal of Traumatic Stress, 21, pg. 301-308.
2. Adamson D. M. (2008). *Invisible wounds of war: psychological and cognitive injuries, their consequences, and services to assist recovery*. In: Tanielian T, Jaycox L, editors. RAND Center for Military Health Policy Research. Rand Corporation; Santa Monica.
3. Ahern J., Galea S., Resnick H. & Vlahov D.(2004). Television images and probable posttraumatic stress disorder after September 11: *The role of background characteristics, event exposures, and perievent panic*. Journal of Nervous and Mental Disease, 192, pg. 217- 226.
4. American Psychiatric Association. *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (5th ed.). Washington, DC: Author (2013).
5. American Psychiatric Association. *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (3rd ed.). Washington, DC: Author (1980).
6. American Psychiatric Association. *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (4th ed., text rev.). Washington, DC: Author (2000).
7. American Psychological Association. *Task Force on Promotion and Dissemination of Psychological Procedures*. A Report to the Division 12 Board of the American Psychological Association. Washington, DC: Author (1994).
8. Baekland F. & Lundwall I.(1975). *Dropping out of treatment: A critical review*, *Psychological Bulletin*, 82, pg. 738-783.
9. Ballenger J. C., Davidson J. R., Lecrubier Y., Nutt D. J., Foa E. B., Kessler R. C., McFarlane A. C., Shalev A. Y. (2000). *Consensus statement on posttraumatic stress disorder from the International Consensus Group on Depression and Anxiety*. Journal of Clinical Psychiatry, 61 (supp 15), pg. 60–66.
10. Barbiero G.(1991). *L'asino del nemico. Rinuncia alla vendetta e amore del nemico nella legislazione dell'Antico Testamento*. Rome: Editrice Pontificio IstitutoBiblico.
11. Bejko S. (2000). *Ideja e harmonisë së njerëzve në rrjedhën e qytetërimeve*, Tiranë.

12. Blain L. M., Galovski T. E., Elwood L. S. & Meriac J. P. (2012). *How does the Posttraumatic Cognitions Inventory fit in a four-factor posttraumatic stress disorder world? An initial analysis. Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, & Policy.*
13. Breslau N., Kessler R. C., Chilcoat H. D., Schultz L. R., Davis G. C., Andreski P.(1998). *Trauma and posttraumatic stress disorder in the community: the 1996 Detroit Area Survey of Trauma. Archive of General Psychiatry, 55, pg. 626–632.*
14. Breslau N. & Kessler R. C. (2001). *The stressor criterion in DSM-IV posttraumatic stress disorder: An empirical investigation. Biological Psychiatry, 50, pg.699–704.*
15. Brewin C. R., Lanius R. A., Novac A., Schnyder, U., & Galea S.(2009). *Reformulating PTSD for DSM-V: Life after Criterion A. Journal of TraumaticStress, 22, pg. 366–373.*
16. Breslau N. (1998). *Trauma and posttraumatic stress disorder in the community: the 1996 Detroit area survey of trauma. Archives of General Psychiatry. 1998;55:626–32.*
17. Bryant R. A., O'Donnell M. L., Creamer M., McFarlane A. C. & Silove D.(2011). *4 Posttraumatic intrusive symptoms across psychiatric disorders. Journal of Psychiatric Research, pg. 842-847.*
18. Buscaglia L. *Të jetosh, të dashurosh, të kuptohesh. Çabej, Tirane 1982.*
19. Chang Y. J., Yang C. H., Liang Y. C., Yeh C. M., Huang C.C., Hsu K.S. (2009). *Estrogen modulates sexually dimorphic contextual fear extinction in rats through estrogen receptor beta. Hippocampus. 19: pg. 1142–50.*
20. Cohen L., Manion L., & Morrison K.(2000). *Research Methods in Education (5th Edition), London: Routledge Falmer. 45, Pg. 102-103.*
21. Çomo A., Vyshka G., Totozani D. (2002). *Gjakmarrja, shëndeti mendor dhe roli i organizatave jo qeveritare në luftën kundër kësaj dukurie, Tiranë.*
22. Cozzi E. (1910). *La vendetta del sangue nelle Montagne dell'Alta Albania, Anthropos 5: pg. 654–72.*
23. Corso R. (1930). *Vendetta, pp. 38–9 in Enciclopedia Italiana di scienze, lettere e arti, Vol. 35, ed. Istituto Giovanni Trecciani. Milan: Istituto della Enciclopedia Italiana.*
24. Curtis T., Miller B. C., Berry E. H. (2000). *Changes in reports and incidence of child abuse following natural disasters. Child Abuse and Neglect, 24, pg. 1151–1162.*
25. Dalenberg C. & Carlson E. B.(2012). *Dissociation in posttraumatic stress disorder*

- part II: How theoretical models fit the empirical evidence and recommendations for modifying the diagnostic criteria for PTSD. Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy, pg. 551-559.*
26. Dean T. (1997). *Marriage and Mutilation: Vendetta in Late Medieval Italy, Past and Present* 157: pg. 3–36.
 27. Derogatis L. & Melsavados N. (1983). *The brief symptom inventory, an introductory report. Psychological Medicine, 13, pg. 595- 605.*
 28. Ducros P. (1926). *De la Vendetta à la loi de talion*, Revue d'Histoire et de Philosophie Religieuses 6: pg. 350–65.
 29. Dunning E. (1983). *Social Bonding and Violence in Sport*, Jeffrey. Pg. 129–46.
 30. Durkheim E.(1909). *High Albania: A Victorian traveller's Balkan odyssey*. Phoenix Press, London 2000
 31. Durkheim, É. (1968). *Les Formes élémentaires de la vie religieuse, pp. 143. Le système totémique en Australie*. Paris: Presses Universitaires de France.
 32. Durkheim, É. (1975b) 'L'État, la morale et le militaire', pp. 160–3 in Victor Karady (ed.) *Textes 3. Fonctions sociales et institutions*. Paris: Minuit.
 33. Elezi I. (2000). *Vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje në Shqipëri*. Tiranë: Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut,
 34. Elhai J. D. & Palmieri P. A.(2011). *The factor structure of posttraumatic stress disorder: A literature update, critique of methodology, and agenda for future research. Journal of Anxiety Disorders, 25, pg. 849-854.*
 35. Elhai J. D., Miller M. E., Ford J. D., Biehn T. L., Palmieri P. A. & Frueh B.(2012). *Posttraumatic stress disorder in DSM-5: Estimates of prevalence and symptom structure in a nonclinical sample of college students. Journal of Anxiety Disorders, 26, pg. 58-64.*
 36. Fishta A. Gj. (1933). *Parathenie e Kanunit të Lek Dukagjinit*. Shkodër.
 37. Foa E. & Tolin D. F. (2000). *Comparison of the PTSD Symptom Scale-Interview Version and the Clinician-Administered PTSD Scale. Journal of Traumatic Stress,13,Pg.181-191.*
 38. Foa E. B., Cashman L., Jaycox L. & Perry K.(1992). *The validation of self-report measure of post-traumatic stress disorder: The Post-traumatic Diagnostic Scale. Psychological Assessment, 9, pg. 445-451.*

39. Foa E., Riggs D., Dancu C. & Rothbaum B.(1993). *Reliability and validity of a brief instrument for assessing post-traumatic stress disorder*, *Journal of Traumatic Stress*, 6, pg. 459-474.
40. Foa E. B. & Rothbaum B. O. (1998). *Treating the trauma of rape: Cognitive-behavioral therapy for PTSD*. New York: Guilford Press.
41. Friedman M. J., Resick P. A., Bryant R. A. & Brewin,C. R. (2011). *Considering PTSD for DSM-5*. *Depression and Anxiety*, 28, pg. 750-769.
42. Friedman M. J., Resick P. A., Bryant R. A., Strain J., Horowitz M. & Spiegel D.(2011). *Classification of trauma and stressor-related disorders in DSM-Depression and Anxiety*, 28, pg. 737-749.
43. Fuga A. (2000). *Konfliktet në zonën urbane dhe zgjidhja e tyre me ndërmjetësim*, Tiranë.
44. Gëllçi D. (2005). *Gjakmarrja: Albanian highlander's "blood feud" as social obligation*, Tirana: AllS.
45. Gjeçovi Sh.(1999). *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, Tiranë, f.118-140.
46. Giddens A.(1971). *Capitalism and Modern Social Theory: An Analysis of the Writings of Marx, Durkheim and Max Weber*. London: Cambridge UniversityPress.
47. Girard R. (1972). *La Violence et le sacrée*. Paris: Grasset,
48. Godelier M. (1999). *Chefferies et États, une approche anthropologique*, in *Les Princes de la protohistoire et l'émergence de l'État*. Naples and Rome: École Française de Rome, pp.19–30.
49. Goldstein J. M., Seidman L. J., Horton N. J., Makris N., Kennedy D. N., Caviness V. S. (2001). *Normal sexual dimorphism of the adult human brain assessed by in vivo magnetic resonance imaging*. *Cerebral Cortex*. 11: pg. 490–497.
50. Goscinnny, R. and A. Uderzo (1999). *Astérix en Corse*. Paris: Hachette.
51. Gupta R. R., Sen S., Diepenhorst L. L., Rudick C. N., Maren S.(2001). *Estrogen modulates sexually dimorphic contextual fear conditioning and hippocampal long-term potentiation (LTP) in rats*(1) *Brain Research*.888: pg. 356–65.
52. Harvey A. G., Bryant R. A. (1998). *The relationship between acute stress disorder and posttraumatic stress disorder: a prospective evaluation of motor vehicle accident survivors*. *Journal of Consulting Clinical Psychology*, 66, pg. 507-512.

53. Herman J. L.(1992a). *Complex PTSD: A syndrome in survivors of prolonged and repeated trauma*. Journal of Traumatic Stress, 5, pg. 377–391.
54. Herman J. L.(2011). *Trauma and recovery: The aftermath of violence – from domestic abuse to political terror*. New York: Basic Books, 1992b.
55. Honore de Balzac, H. (1996) *La Vendetta*. Paris: Flammarion, 1996 [1855].
56. Inslicht S. (2011). *Online edition of the Journal of Psychiatric Research*.
57. Jasnow A. M., Schulkin J., Pfaff D. W.(2006). *Estrogen facilitates fear conditioning and increases corticotropin-releasing hormonem RNA expression in the central amygdala in female mice*. Hormones and Behavior. 49: pg. 197–205.
58. Karaj Th. (1997). *Aspekte psikologjike të konflikteve*. Tiranë.
59. Kessler R. C. (2000). *Posttraumatic stress disorder: the burden to the individual and to society*. Journal of Clinical Psychiatry, 61(suppl 5), pg. 4–12.
60. Kessler R. C., Borges G., Walters E. E. (1999). *Prevalence of and risk factors for lifetime suicide attempts in the National Comorbidity Survey*. Archives of General Psychiatry, 56, pg. 617–626.
61. Kessler R. C., Sonnega A., Bromet E., Hughes M., Nelson C. B. (1995). *Posttraumatic stress disorder in the National Comorbidity Survey*. Archives of General Psychiatry, 52, pg. 1048-1060.
62. Kilpatrick D. G., Edmunds C., Seymour A. (1992). *Rape in America: A report to the nation*. Charleston, SC: National Victim Center & the Crime Victims. Research and Treatment Center, Medical University of South Carolina.
63. Klein R. K. & Schermer V. L.(2000). *Group psychotherapy for psychological trauma*. New York: Guilford Press.
64. Kostallari A., Thomaj J. (1988). *Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe*, “Mihal Duri”, Tiranë.
65. Kuschel R., Vengeance I. (1988). *Their Reply: Blood Feuds and Homicides on Bellona Islands*. Copenhagen.
66. Laçi S. (1996). *Situata social ekonomike e zonave malore dhe shkaqet e eksodit të popullsisë*. Studime Albanologjike nr. 2, faqe. 212-215.
67. Lauterbach D., Vora R. & Rakow M. (2005). *The relationship between posttraumatic stress disorder and self-reported health problems*. Psychosomatic Medicine, 67, pg.

939 – 947.

68. Leuner B., Mendolia-Loffredo S., Shors T. J. (2004). *High levels of estrogen enhance associativememory formation in ovariectomized emales*. Psychoneuro - endocrinology, 29: pg.883– 890.
69. Luarasi A. (2002). *Marrëdhëniet familjare, Studime për të drejtën zakonore shqiptare* Tiranë.
70. Mc Kenzie (2014). *The Anatomy of Fear, Understanding the biological underpinnings of anxiety, phobias, and PTSD*, Emory Medicine.
71. Milad M. R., Goldstein J. M., Orr S. P., Wedig M. M., Klibanski A., Pitman R. K. (2006). *Fear conditioning and extinction: influence of sex and menstrual cycle in healthy humans*. Behavioral Neuroscience,120: pg.1196–1203.
72. Milad M. R., Igoe S. A., Lebron-Milad K., Novales J. E. (2009).*Estrous cycle phase and gonadal hormones influence conditioned fear extinction*.Neuroscience,164: 887-895.
73. Milad M. R., Zeidan M. A., Contero A., Pitman R. K., Klibanski A., Rauch S. L.(2010). *The influence of gonadal hormones on conditioned fear extinction in healthy human*. Neuroscience,168: pg. 652–658.
74. Mile K. (2007). *Blood feud: between kanun and state*, Insituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare.
75. Miller M. W., Wolf E. J., Kilpatrick D., Resnick H., Marx B. P., Holowka D. W., Friedman M. J. (2012). *The prevalence and latent structure of proposed DSM-5 posttraumatic stress disorder symptoms in U.S. national and veteran samples*. Psychological Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy.
76. Mischel W. & Shoda Y. (1995). *A cognitive-affective system theory of personality: Reconceptualizing situations, dispositions, dynamics, and invariance in personality structure*. Psychological Review, 102, pg. 246-268.
77. Mullen P. E., Romans-Clarkson S. E., Walton V. A., Herbison G. P. (1988). *Impact of sexual and physical abuse on women's mental health*. The Lancet, 1: pg. 841–845.
78. North C. S., Nixon S. J., Shariat S., Mallonee S., McMillen J. C., Spitznagel E. L., Smith E. M. (1999). *Psychiatric disorders among survivors of the Oklahoma City bombing*. Journal of American Medical Association, 282, PG. 755–762.

79. Oakes R. T. (1997). *The Albanian Blood Feud*, Journal of International Law and Practice 6: pg. 177–98, Operation Dove's report for Blood feud.
80. Pacella M. L., Hruska B. & Delahanty D. L. (2013). *The physical health consequences of PTSD and PTSD symptoms: A meta-analytic review*. Journal of Anxiety Disorders, 27, pg. 33– 46.
81. Pango Y.(2004). *Psikoterapi e njohjes dhe e sjelljes*, ILAR, Tiranë.
82. Pettifer J. and Vickers M. (2000). *Albania: from the anarchy to a Balkan identity*, Hurst, C.: London.
83. Perkonigg A., Kessler R., Storz S. & Wittchen H. (2000). Breslau N. (1998). *Trauma and posttraumatic stress disorder in the community: the 1996 Detroit area survey of trauma*. Archives of General Psychiatry. 1998;55:626–32,
84. Pitman R. K., Shin L. M., Rauch S. L. (2001). *Investigating the pathogenesis of posttraumatic stress disorder with neuroimaging*. Journal of Clinical Psychiatry. No 62, pg. 47–54.
85. Pitman R.K., Shalev A., Orr S. (2000). *Post-traumatic stress disorder, emotion, conditioning and memory*. In: Gazzaniga M, editor. The cognitive neurosciences. Plenum Press; New York: 2000. pp. 1133–48.
86. Plasari A. (2000). *Gjakmarrja midis realitetit dhe retorikës* (Studim). Shekulli, 21-22 shkurt, Qendra shqiptare e studimeve për sigurinë kombëtare.
87. Ronald M., Frank N. Shiromoto. (2010). *The Encyclopedia of Trauma and Traumatic Stress Disorders*, New York.
88. Rosenthal J. (1966). *Marriage and Blood Feud in "Heroic" Europe*, The British Journal of Sociology 17: pg. 133–44.
89. Saunders B. E., Kilpatrick D. G., Hanson R. F., Resnick H. S., Walker M. E.(1999). *Prevalence, case characteristics, and long-term psychological correlates of child rape among women: a national survey*. Child Maltreatment, 4: pg. 187– 200.
90. Schwandner-Sievers S. (1995). *Zur Logik der Blutrache in Nordalbanien. Ehre Symbolik und Gewaltlegitimation*, Sociologus 45(2): 109-129.
91. Sinani F.(2001). *Konfliktet të mos shndërrohen në drama kombëtare*. Tiranë.
92. Sinani Gj. (2002). *Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës*, Tiranë.

93. Stein D. J., Koenen K. C., Friedman M. J., Hill E., McLaughlin K. A., Petukhova M., Kessler R. C. (2013). *Dissociation in posttraumatic stress disorder: Evidence from the World Mental Health Surveys*. Biological Psychiatry, 73, pg. 302-312.
94. Thomas J. L., Wilk J. E., Riviere L. A., McGurk, D. Castro C. A. & Hoge C. W. (2010). *Prevalence of mental health problems and functional impairment among Active Component and National Guard soldiers 3 and 12 months following combat in Iraq*. Archives of General Psychiatry.
95. Tolin D. F., Foa E. B. (2006). *Sex differences in trauma and posttraumatic stress disorder: a quantitative review of 25 years of research*. Psychol. Bull. 132, pg. 959–992.
96. Treska T. (1997). *Ndërmjetësimi –institucion i Kanunit*, Tiranë.
97. Wahl A. (1984). *Chronik einer Blutrache. Ein Beitrag zur Phänomenologie der Ausländerkriminalität, Kriminalistik*. Zeitschrift für die Gesamte Kriminalistische Wissenschaft und Praxis 4: 181–3.
98. Valentini Gj. (2005). *Mendime paraprake dhe të përgjithshme mbi Kanunin e quejtun të Lekë Dukagjinit*, faqe 664-705.
99. Valentini Z. (1945). *La famiglia nel Diritto Tradizionale Albanese*.
100. Williams J. L., Monahan C. J. & McDevitt-Murphy, M. E. (2011). *Factor structure of the PTSD Checklist in a sample of OEF/OIF veterans presenting to primary care: Specific and nonspecific aspects of dysphoria*. Journal of Psychopathology and Behavioral Assessment, pg. 514-522.
101. Zamputi I. (1961). *Pozita shoqnore e gruas malësore shqiptare sipas kanunit*, Buletin i USHT, Seria, shkencat shoqerore, nr. 2.
102. Zeidan M. A., Igoe S. A., Linnman C., Vitalo A., Levine J. B., Klibanski A... (2011). *Estradiol modulates medial prefrontal cortex and amygdala activity during fear extinction in women and female rats*. Biological Psychiatry. 70: pg. 920–927.
103. *Axhenda lokale e zhvillimit të Bathores*, Instituti për zhvillimin e habitatit, Tiranë 2003.
104. Bibla, Albanian Bible Society, nr 36, Tiranë 1993.
105. Bibla, Albanian Bible Society, Levetiku 24:20, Tiranë, 1993,
106. Collins english dictionary - Online version.
107. *E drejta e familjes*, përmbledhje artikujsh, Tiranë 1998.

108. INSTAT, Albania population ne Tiranë 2011, 26 Tetor, 2012.
109. Koha.net, 22 shtator 2012,
<http://ww.archive.koha.net/?id=31&o=116231&autori=156>).
110. *Gazeta Panorama*, 2005
111. *Gazeta Shqiptare*, datë 17 tetor, 2012.
112. Insituti Shqiptar për Çështje Publike, 2013.
113. Kodi Civil i vitit 1929.
114. *Mediation Magazine* 3, 1997; faqe 3-4, 1998; 1, 2, 4, 2000.
115. Raport Vjetor, Instituti për zhvillimin e habitatit, Tiranë 2003.
116. Revista *Pajtimi* 3, viti 1997; faqe 3-4, 1998; 1, 2, 4, viti 2000.
117. Të drejtat e grave në veri të Shqipërisë, Qendra Drejtësi dhe paqe, Shkodër, 2002.
118. Kadare I. Revista “Ligji dhe Jeta”, Tirane, 2001.
119. Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, Maj 2005.
<http://www.acnss.com/html/studime/kanuni.htm>
120. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social, 2004
121. Prroj. E, Nje veshtrim social psikologjik mbi grate e familjeve te ngjuara ne Bathore, UET, Tirane 2015.
122. Të dhënat Zyrtare Rajonale te SHSHS, 2003 dhe SKZHES, 2004.
123. Kushtetuta e Shqiperise
124. *Gazeta Shqiptare*, date 10.07.2012
125. Raport I Avokatit te Popullit, 2012
126. Howell D. C. Statistical Methods for Psychology , 7th Edition, Wadsworth Cengage Learning, USA, 2002.

Shtojcë

Hyrje

Përshëndetje dhe mirësevini në këtë diskutim. Unë quhem_____

Po kryej një studim që do të përfshijë rreth 50 gra të cilat jetojnë nën ndikimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, por që vijnë kryesisht nga Veriu dhe Verilindja e Shqipërisë. Unë do të drejtoj pyetjet dhe do të kërkoja që ju të më jepnit një përgjigje sa më të saktë dhe të sinqertë. Në pyetësor do të ketë pyetje që ju thjesht do të zgjidhni një opsion mes përgjigjeve të dhëna, por edhe pyetje të tjera që do të kërkojnë një përgjigje prej jush. Gjithashtu, unë do të mbaj shënime. Mund të më ndaloni në çdo kohë që nuk ndjeheni mirë dhe kur keni nevojë për pak pushim. Gjithashtu, nëse nuk kuptoni mirë pyetjet e bëra, ndjehuni e lirë të më pyesni për kuptimin e tyre. Ju siguroj për privatësinë e këtyre të dhënave dhe për ruajtjen e konfidencialitetin. Përpara se të fillonim ne do të dëshironim që ju të lexonit këtë ftesë-dokument për pjesmarrje në studim, në të cilën shpjegohet qëllimi i studimit dhe theksohet se pjesmarrja juaj në të është vullnetare. Nëse jeni dakort të merni pjesë në këtë studim lutemi që përpara se të fillojmë të firmosni këtë ftesë.

Pyetësi Nr. 1. Mbledhja e të dhënave demografike dhe sociale

Emri i _____ Data e intervistës _____

1. Të dhënat e përgjithshme :

1.1). Moshë _____

1.2). Niveli i arsimit _____

Fillor _____ 8 vjeçar _____ I mesëm _____ tjetër (specifiko) _____

1.3). Statusi civil

beqare _____ e martuar _____ e divorcuar _____ e rimartuar _____ e ve _____

1.4). Numri i anëtarëve të familjes me të cilët bashkëjetojnë ? _____
(specifiko) _____

1.5). Numri i anëtarëve të familjes që kanë të ardhurat e veta ?

1.6). A keni fëmijë dhe nëse Po sa? _____ PO (sa ? _____) JO _____

1.7). Cili është profesioni juaj (puna që merreni)? _____

1.8). Cili është statusi i tanishëm?

e punësuar e rregullt _____ e papunë _____ punë e rastësishme _____ tjetër (specifiko)

1.9). Nëse je e punësuar e rregullt punoni në: Sektorin privat _____ Sektorin shtetëror _____

1.10). Nëse punoni në sektorin privat a jeni e siguruar ? PO_____ JO_____

2). A mendoni se e përballoni jetesën tuaj dhe të familjes tuaj me të ardhurat që nxirrni nga puna juaj ? PO_____ JO_____ Asnjë mendim _____

Nese Jo si mund ta përballoni jetesën duke - pritur nga shteti _____duke pritur ndihmë nga të tjerët (specifiko)_____

2.1) Çfarë pjesë të ardhurash shpenzoni për veten tuaj ?
(specifiko)_____

2.2). A ka ndryshuar gjëndja juaj ekonomike? dhe pse?

merrni asistencë sociale _____ merrni ndihmë ekonomike nga OJF të ndryshme
_____ merrni ndihmë ekonomike nga shoqata fetare _____ tjetër _____

3). Rrethi nga jeni larguar _____

4). Sa vjet keni qënë në ngujim?_____

5). A vazhdoni të jeni të ngujuar? PO_____ JO_____

Nese Po sa vite keni të ngujuar këtu në ShkodërëBathore ? _____

6). Cili është shkaku i ngujimit ?

7). Fenomeni i gjakmarrjes ka ndikuar në probleme të tilla si ?

gjëndja social-ekonomike _____ psiko-sociale _____

marrëdhëniet brenda ciftit _____ marrëdhëniet me komunitetin _____

marrëdhëniet me fëmijët _____ tjetër (specifiko) _____

8). A ka ndryshuar gjendja juaj sociale me ndryshimin e vendbanimit?

Eshtë përmirësuar _____ Eshtë keqësuar _____ Njësoj _____

8.1). Nese është përmirësuar si?

dilni vetë për të bërë blerjet _____ dilni më shumë për t'u takuar me shoqe _____

merrni pjesë në aktivitete sociale që organizohen _____ bëni pjesë në forume

politike _____ bëni pjesë në shoqata (specifiko) _____ tjetër

(specifiko) _____

8.2). Nese është përkeqësuar mund ta shpjegoni me pak fjalë?

8.3). A ndiqni emisione televizive dhe të radios ? PO _____ JO _____

8.4). Mund të më thoni çfarë lloj emisionesh ndiqni ?

8.5). A jeni takuar ndonjëhere me ndonjë grua të shquar? PO_____ JO_____

Nese po bënte pjesë: në programe që mbështesin gratë _____

në forume politike _____ tjetër (specifiko) _____

9). Gjendja juaj psiko-emocionale e tanishme është :

e stresuar për të përballuar jetesën _____ në ankth për të ardhmen tuaj _____

e pasigurt për të ardhmen e fëmijëve tuaj _____ tjetër _____

10). A e keni ndjerë mbështetjen psiko- emocionale të punonjësit social? PO___ JO___

11). Si rrjedhojë e fenomenit të gjakmarrjes, a mendoni se marrëdhëniet me fëmijët tuaj

kanë ndryshuar ? PO_____ JO_____ Asnjë mendim(ASM) _____

Nëse po si kanë ndryshuar specifiko: me vajzat _____

Me djemtë _____

12). A kane ndryshuar marrëdhëniet në çiftit nga ngujimi? PO_____ JO___ s'di_____

Dhe si kanë ndryshuar? ziheni shpesh _____ është ai xheloz _____ ndjeheni ju

xheloze _____ nuk ndiheni e respektuar _____ tjetër _____

a) Si janë marrëdhëniet tuaja seksuale ? _____

13). A ndjehesh e ngarkuar emocionalisht nga marrëdh. në çift? PO___JO___ASM___

Nëse po si? Jeni e mërzhitur _____ ndiheni në ankth_____

shqetësoheni dhe për gjënë më të vogël_____

jeni e mbyllur në vetevete _____ tjetër_____

14). A mund të më thoni se si e vlerësoni ndryshimin në gjëndjen tuaj emocionale tani?

Më keq _____ Më mirë _____

15). A e ndjeni përkrahjen e Komshijve? PO_____ JO _____

16). Nëse po kush ju ka ndihmuar dhe si?

ju ndihmojnë kur keni nevojë _____

kërkoni ndihmë në momente të vështira_____

tjetër (specifiko)_____

17). Zhvendosja në Shkodërë Bathore ka qënë?

vendim i bashkëshortit_____ vendim i përbashkët i gjithë familjes _____

tjetër (specifiko) _____

18). A u ndjetë e frikësuar për sigurinë tuaj kur u zhvendosët këtu? PO____ JO____

Nëse Po mund ta ma shpjegoni me pak fjalë ? _____

19). A jeni identifikuar nga shteti si një familje në gjakmarrje? PO _____ JO _____

Nëse Po çfarë masash ka ndërmarrë shteti ? _____

20). A mendoni se për fenomenin e gjakmarrjes është e drejtë të zbatohet ?

Ligji _____ kanuni _____ asnjë mendim _____

21). Në zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes mund të ndikojë ?

iniciativa juaj personale (si?) _____

komuniteti ku u zhvendosët _____

shteti _____

OJFëshoqatafetare _____

tjetër (specifiko) _____

22). Si e mendoni të ardhmen tuaj dhe të fëmijve tuaj?

Pyetësi Nr. 2. – PSSI

ID e Pacientit: _____	Data: _____
Emri i Pacientit: _____	Vendi: _____

Intervista matese e simptomave te CSPT (PSSI; Foa, Riggs, Dancu & Rothbaum, 1993)

Përshkruaj Traumën

0	1	2	3
Aspak	Një herë në javë pak	2-4 herë në javëdisi	5 ose me sh. X
në javëshumë			

RIPERJETIMI (nevojitet një): Shqyrto pastaj kualifiko

____ 1. A keni pasur në mënyrë të përsëritur mendime të bezdisshme të dhimbshme, ose kujtime rreth traumës?

____ 2. A keni pasur në mënyrë të përsëritur ëndrra të këqija ose ankth rreth traumës?

____ 3. A keni pasur eksperiencë sikur papritur po rijetoni traumën, parafytyrime, veprime ose ndjenja sikur po rindodh?

____ 4. A keni qënë në mënyrë intensive emocionalisht e mërzhitur kur kujtoni traumën?

____ 5. A keni pasur reagime fizike intensive (p.sh djersitje, rrahje të forta zemre) kur keni kujtuar traumën?

SHMANGJE (Duhet tre): [shqyrto pastaj kualifiko]

____ 6. A jeni përpjekur në mënyrë të vazhueshme për të shmangur mendimet ose ndjenjat që lidhen me traumën?

____ 7. A jeni përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të shmangni aktivitete, situata, ose vende që ju kujtojnë traumën?

____ 8. A ka ndonjë aspekt të rëndësishëm të traumës që ju akoma nuk mund ta tregoni?

____ 9. A keni humbur dukshëm interesin për aktivitetet në kohë të lirë që kur ka ndodhur trauma?

____ 10. A jeni ndjerë të shkëputur apo të ndarë nga të tjerët rreth teje që kur ka ndodhur trauma?

____11. A keni ndjerë që aftësia juaj për të përjetuar të gjitha emocionet është dobësuar (psh. Të paafte për të pasur ndjenja dashurie)?

____12. A keni ndjerë që ndonjë plan ose shpresë për të ardhmen kanë ndryshuar për shkak të ngjarjes? (psh. Jo më karrierë, martesë, fëmijë, ose jetë të gjatë)?

HIPERVIGJILENCE (Nevojiten dy): [shqyrto pastaj kualifiko]

____13. A keni pasur vështirësi të vazhdueshme për të fjetur gjumë?

____14. A keni qenë vazhdimisht të irrituar ose keni pasur shpërthime inati?

____15. A keni pasur vështirësi të vazhdueshme për tu përqëndruar?

____16. A jeni ju tepër alert (psh. kontrollon kush është rreth teje, etj) që nga trauma?

____17. A keni qenë të nevrikosur dhe që trembeni menjëherë, që nga trauma?

Pyetësi Nr. 3. – Pyetësi për historinë e traumës

Në vijim janë një seri pyetjesh rreth ngjarjeve jetësore serioze dhe traumatike. Këto lloj ngjarjesh në fakt ndodhin me një farë rregulli, edhe pse ne do të donim të besonim që ato janë të rralla dhe që ato ndikojnë rreth mënyrës sesi njerëzit u ndjenë, reagues, dhe ëose menduan për gjërat më pas. Duke ditur që gjëra të tilla ndodhin dhe duke njohur reagimin ndaj tyre, do të na ndihmojë të zhvillojmë programe për parandalim, edukimin dhe shërbime të tjera.

Për çdo rast, ju lutem tregoni nëse ajo gjë ju ka ndodhur në një periudhë të caktuar kohe në jetën tuaj dhe në qoftë se Po, specifikoni poshtë pyetjeve në tabelë.

<i>Ngjarje të lidhura me krimin</i>		Qarko njërën	
1	A është përpjekur ndonjëherë dikush që të marrë dicka nga ju direkt me anë të përdorimit të dhunës ose kërcënimit për dhunë, si psh me anë të sulmit ?	J o	P o
2	A është përpjekur ndonjëherë dikush që t'ju vjedhë ju ose realisht ju ka vjedhur p.sh.ju ka vjedhur gjërat tuaja personale)?	J o	P o
3	A është përpjekur ndonjëherë dikush që t'ju hyjë me dhunë në shtëpi ose realisht ka hyrë në shtëpi kur ju <u>nuk ishit</u> të pranishëm?	J o	P o
4	A është përpjekur ndonjëherë dikush që t'ju hyjë me dhunë në shtëpi ose realisht ka hyrë në shtëpi kur ju <u>ishit</u> të pranishëm?	J o	P o

5	A keni pasur ndonjëherë një aksident serjoz në punë, me makinë ose diku tjetër? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë) _____	J o	P o
6	A keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi natyrore si tornado, stuhi, përmytje ose termet të rëndë, etj ku ju ndjetë se ju ose ndonjë nga të dashurit tuaj ishte në rrezik për jetën ose për tu lënduar ? (Nëse po ju lutem specifikoni: _____	J o	P o
7	A keni përjetuar ndonjëherë një fatkeqësi të shkaktuar nga dora e njeriut si psh përplasje treni, shëmbje ndërtese, vjedhje në bankë, zjarr, etj, ku ju ndjetë se ju ose ndonjë nga të dashurit tuaj ishte në rrezik për jetën ose për tu lënduar? (Nëse po ju lutem specifikoni: _____	J o	P o
8	A jeni ekspozuar ndonjëherë ndaj kimikateve të rrezikshme ose radioaktive të cilat mund të kërcënonin shëndetin tuaj ?	J o	P o
9	Keni qënë ndonjëherë në një situatë tjetër gjatë së cilës ju u lënduat rëndë? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë) _____	J o	P o
10	A keni qënë ndonjëherë në një situatë gjatë së cilës ju patët frikë se mund t'ju vrisnin ose mund të lëndoheshit rëndë ? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë)_____	J o	P o
11	A keni parë ndonjëherë dikë të lënduar rëndë ose të vrarë ? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë)_____	J o	P o
12	A keni parë ndonjëherë trupa të vdekur (Përvec rasteve të funeraleve) ose jeni përballur me trupa të vdekur për ndonjë arsye tjetër ? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë)_____	J o	P o
13	A ju është vrarë ndonjëherë një mik i afërt ose anëtar i familjes, ose ju është vrarë nga një shofer i pirë (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë) _____ —	J o	P o

1 4	A keni pasur ndonjëherë një bashkëshort, partner romantic ose fëmijë që ju ka vdekur (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë lidhjen p.sh., mamaja, nipi etj) _____	J o	P o
1 5	A keni pasur ju ndonjëherë një sëmundje të rëndë që ju ka rrezikuar jetën? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë) _____	J o	P o
1 6	A keni marrë ndonjëherë një lajm për një lëndim të rëndë, një sëmundje që ka rrezikuar jetën, ose vdekje e papritur e një të afërmit tuaj ? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë) _____	J o	P o
1 7	A ju është dashur të angazhohen në luftime për shërbimin ushtarak në një luftë të një zone zyrtare ose jozyrtare? (Nëse po ju lutem specifikoni më poshtë se ku) _____	J o	P o

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!